...Duke dhënë këshilla ose udhëzime se si të kryejnë një veprë penale, duke vënë në dispozicion për kryerësin mjetet për të kryer një veprë penale, duke hequr pengesat në kryerjen e një veprë penale, ose premtuar paraprakisht për të fshehur provat e kryerjes së një krimineli kundërvajtje, identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e një veprë penale, ose fitimet që rrjedhin nga kryerja e një veprë penale.

Prandaj, trupi gjykues konsideron se asnjë dispozitë nuk mund të konsiderohet më e favorshme për të akuzuarit dhe ka zbatuar dispozitat e KPPK-së si të akuzuara.

B. E drejta procedurale

67. Kodi i ri i Procedurës Penale i Kosovës, Kodi nr. 04 / L-123 (në tekstin e mëtejshëm: "KPP") ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 (shih nenin 547, KPP); duke zëvendësuar kështu Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (të vjetër), UNMIK/REG/2003/26 ("KPPK"). Në procedurën në fjalë, aktakuza e ndryshuar për MTPT I është ngritur më 05 dhjetor 2012 (nën KPPK) dhe Aktakuza për MTPT II më 19 shkurt 2014 (nën KPP). Është e qartë se ligji procedural i zbatueshëm për këtë procedurë, që nga hyrja e tij në fuqi më 1 janar 2013, KPK i ri³. Ky i fundit, në të vërtetë, është zbatuar gjatë gjithë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor. Sidoqoftë, është e rëndësishme, megjithatë, që të ndërmerren hapa hetimore në përputhje me dispozitat e deritanishme të KPPK-së në të dyja procedurat e origjinës (MTPT I dhe II). Prandaj, trupi gjykues e konsideroi të nevojshme të përcaktojë se cili ligj do të zbatohet lidhur me pranueshmërinë e provave të mbledhura nën KPPK.
68. Ligji i zbatueshëm për pranueshmërinë e provave është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN 577/2013). Në arsyetimin me të cilin trupi gjykues u pajtua, Gjykata e Apelit theksoi së pari se "*çështja e vlerësimit të pranueshmërisë së provave dallon nga vlerësimi i ligjshmërisë së një veprimi hetimor përmes të cilit janë mbledhur provat*"⁴. Në veçanti:

"Vlerësimi nëse veprimi hetimor është kryer në mënyrë të ligjshme është vetëm një hap drejt vendimit për pranueshmërinë e provave. Bazuar në parimet e përgjithshme tempus regit actum, ligjshmëria e një veprimi hetimor

³ Shih gjithashtu Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 24.

⁴ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 28.

duhet gjithmonë të përcaktohet kundër rregullave procedurale në fuqi në kohën kur është ndërmarrë veprimi hetimor. Në rastin aktual [d.m.th. MTPT I], ligjshmëria e veprimeve hetimore do të përcaktohet gjithnjë sipas [KPPP] si ligj procedural në fuqi kur janë kryer veprimet hetimore ”⁵

E njëjta logjikë vlen edhe për veprimet hetimore të ndërmarra nën MTPT II. Megjithatë, trupi gjykues vuri në dukje se disa veprime hetimore të MTPT II u ndërmorën pas hyrjes në fuqi të KPP-së së re dhe ligjshmëria e tyre duhet të vlerësohet sipas dispozitave të reja.

69. Në radhë të dytë, Gjykata e Apelit vazhdoi:

“Vendimi nëse dëshmitë e fituara në mënyrë të ligjshme janë gjithashtu të pranueshme dhe mund të përdoren si dëshmi gjatë shqyrtimit gjyqësor, megjithatë, si rregull i përgjithshëm, do të merren në bazë të klauzolave të pranueshmërisë të diktuar nga KPP si Kod i zbatueshëm për procedurën penale si tërësi . Vetëm në raste të veçanta mund të zbatohen klauzolat e pranueshmërisë [KPPPK]. Një shembull i tillë do të ishte kur veprimi procedural që grumbullon provat dhe klauzolat e pranueshmërisë janë kaq të ndërlidhura që nuk mund të ndahen. Në rrethana të tilla, [KPPPK] do të drejtoj çështjen. ”⁶

70. Përfundimisht, Gjykata e Apelit përmbledhi qëndrimet e saj të përgjithshme si në vijim:

“...ligjshmëria e veprimit hetimor - marrja në pyetje e dëshmitarit - duhet të vlerësohet kundrejt ligjit të procedurës në fuqi, atëherë [KPPP]. Megjithatë, pranueshmëria e provave duhet të vlerësohet në dritën e kodit të procedurës penale të zbatueshme për procedurën në tërësi, gjegjësisht KPP. ”⁷

III. AFATET E PARASHKRIMIT LIGJOR

A. Regjimi ligjor

71. Neni 106(1) i KPK-së e përcakton periudhën e afatit të parashkrimit ligjor, të kalkuluar duke ju referuar ndëshkimit në fuqi për krimin në fjalë. Neni 106(2) i KPK-së e qartëson se aty ku ligji e parashikon një gamë të dënimeve, periudha e parashkrimit përcaktohet mbi bazën e “ndëshkimit më të rëndë”, e kuptuar nga trupi gjykues të jetë kufiri i sipërm i gamës së dënimit. Kështu, aty ku një vepër penale është e ndëshkueshme me dënimin maksimal të burgimit për kohëzgjatjen prej më shumë se një viti, e deri dhe përfshirë tri vjet, periudha pas së cilës ndjekja penale nga autoritetet nuk mund të iniciohet më, është tri vjet (neni 106(1)(1.5) dhe (1.4)). Këto dispozita janë identike për nga substanca me nenet ekuivalente 90(1) dhe 90(2) të KPPK-së.

⁵ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 29.

⁶ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 30.

⁷ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 65.

72. Neni 107 i KPK-së (dhe neni përkatës 91 i KPPK-së) merret me fillimin dhe pezullimin (d.m.th. pauzat) në periudhat e parashkrimit në fuqi. Paragrafi i tij i fundit, neni 107(8) i KPK-së, megjithatë, parashikon që *“ndjekja penale do të ndalohet në çdo rast kur ka kaluar dyfishi i periudhës së parashkrimit.”* E njëjta është konstatuar në nenin 91(6) të KPPK-së, që e ka shtuar përshkrimin në kllapa: *“ndalesa absolute e ndjekjes penale”*. Komenti i KPK-së shpjegon se Neni 107(8) përbën një ndalesë absolute të ndjekjes penale, qëllimi i së cilës është parandalimi i autoriteteve kompetente shtetërore nga abuzimi i ndërprerjeve të lejuara ligjrisht për ta vonuar skadimin e periudhës së parashkrimit në pafundësi.⁸ Ngjashëm, Gjykata e Apelit e sheh dispozitën si *“një ndalesë absolute për ndjekje penale, domethënë që pa marrë parasysh veprimet e autoriteteve, pas një periudhe kohore të tillë është e ndaluar ndjekja penale.”*⁹ Dispozita e KPPK-së së vjetër ka qenë e interpretuar në të njëjtën mënyrë.¹⁰
73. Dhe në fund, neni 363(1)(1.3) i KPP-së përcakton që gjykata duhet (*“do të”*) të nxjerrë një aktgjykim me të cilin e hedh poshtë një akuzë, nëse ka skaduar periudha e parashkrimit.
74. Kështu trupi gjykues konsideroi që ndalesa absolute është kalkuluar drejtpërdrejt nga data e kryerjes së pretenduar të veprës penale e deri më datën e skadimit të dyfishit të periudhës së paraparë për parashkrim. Akuzat për të cilat kjo periudhë ka kaluar, duhet të hidhen poshtë.

B. Refuzimi i Pikës 4 të aktakuzës

75. Pika 4 e Aktakuzës së Konsoliduar e akuzoi të akuzuarin F.Z. me ‘dhënie të ryshfetit’ në shkelje të nenit 344(1) të KPK-së. Siç u diskutua më parë, kjo dispozitë është më e butë sesa neni përkatës 429(2) i KPRK-së, dhe është e dënueshme me burgim për kohëzgjatjen maksimale prej tri vjetësh.¹¹ Duke u mbështetur në nenin 106(1)(1.5) të KPRK-së, afati i parashkrimit për këtë vepër penale është tri vjet. Për këtë, ndalesa absolute për ndjekje penale është gjashtë vjet nga data e kryerjes së veprës penale.

⁸ Pjesa e rëndësishme e Komentarit jep që: *“Paragrafi 8 e rregullon çështjen e afatit absolut të parashkrimit. Ndarja dhe ndërprerja e afatit të parashkrimit praktikisht mund ta parandaloj që afati i parashkrimit të mos ndodhë fare. Posaçërisht ndërprerja mund që gjithmonë ta pengoj afatin e parashkrimit për shkak se autoritetet kompetente shtetërore mund të ndërmarrin veprime të tilla të cilat do ta bënë të pamundur kuptimin dhe qëllimin e afatit të parashkrimit. Për ta shmangur këtë mundësi, ligji penal bashkëkohor e parasheh afatin absolut të parashkrimit.”*

⁹ Gjykata e Apelit, PAKR 161/16, 15 Shtator 2016, pjesa 8.

¹⁰ Gjykata e Apelit, PAKR 359/13, 13 Mars 2014 (*“...Kodi Penal e ndalon ndjekjen penale në çdo lëndë kur dyfishi i periudhës kohore të përcaktuar për afatin e parashkrimit në nenin 90 paragrafi (1) të KPK-së, ka kaluar. Kjo është e ashtuquajtura ndalesë absolute ndaj ndjekjes penale e rregulluar me nenin 91 Paragrafin (6) të KPK-së. Kjo domethënë që pas një periudhe të caktuar kohore, pa marrë parasysh arsyet për vonesë, i pandehuri nuk mund të ndiqet penalisht për një vepër penale.”*)

¹¹ Shih *supra* Pjesën II.A paragrafët 47-52.

76. Më tutje, trupi gjykues rikujtoi që vepra penale e ‘dhënies së ryshfetit’ mund të kryhet ose përmes akordimit ose ofrimit për tu akorduar për një ryshfet.¹² Prokurori pretendon se z. Z. premtoi të akordohet për një ryshfet për shumën prej 250,000 EUR në shkëmbim për dhënien e tenderit 009-004-511 për Mirëmbajtjen Verore dhe Dimërore të Rrugëve Rajonale të Kosovës 2009 – 2010, Rajoni i Gjilanit, Kompanisë T. Më saktësisht, ky ryshfet thuhet të jetë negociuar ndërmjet z. Sh. dhe z. Z. në takimet e mbajtura ndërmjet fundit të janarit dhe fundit të marsit 2009; në mënyrë eksplicite konfirmohet në mesazhet SMS ndërmjet këtyre dyve, të dërguara më 23 dhe 28 mars 2009.¹³ Prokurori nuk pretendoi, as nuk paraqiti ndonjë provë në mbështetje të pretendimit, që ryshfeti i premtuar në të vërtetë u pagua në një datë të mëvonshme. Kështu trupi gjykues konsideroi se data operuese nga e cila duhet të kalkulohet afati i parashkrimit është 28 mars 2009.
77. Për këto arsye, trupi gjykues konstatoi se ndalesa absolute ndaj ndjekjes penale ka skaduar gjashtë vjet pas datës 28 mars 2009 – në mars të vitit 2015 – dhe e refuzoi Pikën 4 të aktakuzës si të parashkruar në mënyrë absolute.

C. Refuzimi i pjesshëm i Pikës 6 të aktakuzës

78. Pika 6 e Aktakuzës së Konsoliduar e akuzoi të akuzuarin F.L. me dy vepra penale të ndryshme. E para ishte pranimi i kontributit politik që e tejkalon shumën prej 1,000 EUR nga një burim i vetëm brenda një dite të vetme, e dënueshme me nenin 5.1 lexuar në lidhje me nenin 10.8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 për Pengimin e Shpëlarjes së Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale. Kjo është e ndëshkueshme me burgim për kohëzgjatjen maksimale prej dy vjetësh; siç u diskutua, ndëshkimi është identik me atë që jepet në Ligjin e ri nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, dhe për këtë aplikohet dispozita akuzuese.¹⁴ Në bazë të nenit 106(1)(1.5) të KPRK-së, afati i parashkrimit për këtë vepër penale është tri vjet. Për këtë, ndalesa absolute për ndjekje penale është gjashtë vjet ndaj data e kryerjes së veprës penale.
79. Prokurori pretendoi se z. L. i pranoi 5,000 EUR nga një I. M. si kontribut për fushatën e tij zgjedhore për tu bërë kryetar i Prishtinës në vitin 2007. Kjo shumë thuhet të jetë pranuar më 18 tetor 2007.¹⁵ Kështu, trupi gjykues konsideroi se ndalesa absolute për ndjekje penale ka skaduar gjashtë vjet pas datës 18 tetor 2007, në tetor të vitit 2013, dhe e hodhi poshtë këtë akuzë si të parashkruar në mënyrë absolute.
80. Trupi gjykues vuri në pah se hedhja poshtë e kësaj akuze e lë të paprekur akuzën e dytë që e përmban Pika 6 e aktakuzës—atë të mos-deklarimit të parave për fushatë,

¹² Shih *supra* Pjesën II.A paragrafët 47-52.

¹³ Shih Aktakuzën e Konsoliduar, f. 11-12, 46 (paragrafët 91-92), 48 (paragrafi 100), 49 (paragrafi 101).

¹⁴ Shih *supra* Pjesën II.A.i paragrafët 59-64.

¹⁵ Shih Aktakuzën e Konsoliduar, f. 14; f. 79, paragrafët 190-192.

në shkelje të nenit 5.6 dhe 10.5(a) të Rregullores së sipërpërmendur të UNMIK-ut. Kjo është shqyrtuar më tutje më poshtë.¹⁶

IV. ÇËSHTJET E TË PROVUARIT

A. Barra dhe standardi i të provuarit

81. Në procedurën penale, parimi i prezumimit të pafajësisë dhe barra të provuarit mbi prokurorinë artikullohet në disa instrumente ndërkombëtare, edhe në nenin 6(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kjo është përsëritur edhe në jurisprudencë e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.¹⁷ Në ligjet e Republikës së Kosovës, prezumimin i pafajësisë në të cilin ka të drejtë i pandehuri inkorporohet në nenin 31(50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 3(1) të KPP-së dhe KPPK-së. Ky prezumim e vendos mbi prokurorinë barrën e vërtetimit të fajësisë për secilin të pandehur, barrë kjo që i mbetet prokurorisë gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor.
82. Në zbatim të këtij parimi trupi gjykues sipas nenit 7(1) të KPK-së dhe KPPK-së “ duhet që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm”, dhe sipas nenit 7 (2) KPP-së dhe KPPK-së “ detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij..”. Prandaj në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm, “gjykata duhet të theksoj në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara ose të pavërtetuara si edhe bazat për këtë sipas nenit 370(7) të KPP-së dhe nenit 396 (7) të KPPK-së.
83. Prandaj, trupi gjykues duhet të vërtetoj për secilën Pikë të aktakuzës me të cilën akuzohet secili i pandehur se a është i bindur në bazë të gjithë provave se është vërtetuar çdo element i krimit. Gjatë rrjedhës së gjykimit, prokurori duhet të citoj prova të mjaftueshme për dënimin e të pandehurve për akuzat që u janë ngritur. Fajësia e të pandehurit nuk mund të prezumohet pa u vërtetuar akuza përtej dyshimit të arsyeshëm.¹⁸ Në përfundim të rastit, çfarëdo dyshimi nëse është vërtetuar vepra penale apo jo duhet të zgjidhet në të mirë të pandehurit në pajtim me nenin 3(2) të KPP-së dhe KPPK-së.

B. Provat që vijnë nga i ndjeri M. Sh.

84. Trupi gjykues e vlerësoi të domosdoshme, si çështje paraprake, të përcaktojë vendimin e tij përfundimtar lidhur me pranueshmërinë e provave të ndryshme që

¹⁶ Shih *infra* Pjesën V.E, paragrafët. 265-273.

¹⁷ Për shembull Telfner kundër Austrisë, 2001, KEDNJ 228, paragrafi 15 dhe Barbera, Messague dhe Jabardo kundër Spanjës, 1988, KEDNJ 25, paragrafi 77.

¹⁸ Një parim i artikuluar në, p.sh, Komitetin e KB për të Drejtat të Njeriut, QDCP Komenti i Përgjithshëm 32, 2007, paragrafin 30 dhe në Sobhraj kundër Nepalit, HRC Komunikimi 1870/2009, Dok.i KB CCPR/C/99/D/1870/2009 (2010), paragrafi 7.3.

vijnë nga i ndjeri M. Sh. dhe peshën provuese që do t'u akordohet atyre në këtë Aktgjykim.

i. Deklarata e M.SH.dhënë Policisë së EULEX-it (12 janar 2010)

85. Kryetari i trupit gjykues e gjeti të pranueshme deklaratën e z. Sh. dhënë Policisë së EULEX-it,¹⁹ dhe ky aktvendim u konfirmua nga Gjykata e Apelit.²⁰ Megjithatë, Gjykata e Apelit vuri në dukje se vlera e saj provuese mbetet të përcaktohet nga trupi gjykues,²¹ dhe bëri këto vërejtje konkrete:²²

“në dritën e ndryshimit të ligjit procedural, trupi gjykues duhet të përcaktojë se cili është statusi i deklaratës së M.SH.në pajtim me KPP-në e re. A i korrespondon deklaratata një dëshmie në procedurën paraprake apo interviste në procedurën paraprake? Ky është një vlerësim dhe vendosje që duhet të bëhet nga trupi gjykues. Nëse ky i fundit konkludon se deklarata duhet të trajtohet si intervistë në procedurën paraprake, do të zbatohen kufizimet lidhur me përdorimin e saj nga Neni 123 (2) i KPP-së. Nëse trupi gjykues konkludon se deklarata duhet të trajtohet si dëshmi në procedurën paraprake, do të zbatohen kufizimet lidhur me përdorimin e saj nga Neni 123 (3) i KPP-së.”

86. Siç është vërejtur nga Gjykata e Apelit, KPP përfshiu një dallim të ri ndërmjet tri llojeve të deklaratave në procedurën paraprake: intervistat në procedurën paraprake; dëshmia në procedurën paraprake; dhe Mundësitë e Veçanta Hetimore (neni 123 i KPP-së). Intervistat në procedurën paraprake janë kryesisht një instrument hetimor, i përdorur për të mbështetur urdhrat hetimorë në procedurën paraprake, paraburgimin dhe aktakuzat. Megjithatë, në shqyrtimin gjyqësor, një intervistë në procedurën paraprake mund të përdoret vetëm në ekzaminimin e tërthortë për të fajësuar dëshmitarin i cili ka dhënë përshkrim kontradiktor të ngjarjeve: në këtë mënyrë, përdorimi i saj lidhet me mundësinë që i jepet mbrojtjes për të kundërshtuar provat. Mundësitë e Veçanta Hetimore (jo qendrore në diskutimin e tanishëm) janë efektivisht një mënyrë për të zhvilluar një shqyrtim gjyqësor në miniaturë në fazën e procedurës paraprake, dhe në këtë mënyrë për të mbledhur prova plotësisht të pranueshme.
87. Dëshmia në procedurën paraprake është një masë e mesme: ajo *“mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes”* (neni 123 (3) i KPP-së). Natyrisht, se dëshmitari në pyetje është i ndjerë jo domosdoshmërisht nënkupton që deklarata e tij si dëshmitar, përbën dëshmi në procedurë paraprake. Megjithatë, KPP parashikon disa parakushte për përdorimin e dëshmisë në procedurën paraprake në këtë mënyrë, që synojnë të shërbejnë si garanci për të drejtat e personave të akuzuar:

¹⁹ P 8/13, datë 01 korrik 2013.

²⁰ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 64.

²¹ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 73.

²² PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 74.

- a. Prova e marrë duhet të *“audio incizohet, audio dhe video incizohet ose transkribohet fjalë për fjalë”* (neni 123 (3) i KPP-së; Neni 133 (1) i KPP-së);
 - b. Prokurorit i kërkohet ta njoftojë të pandehurin me shkrim pesë ditë përpara lidhur me datën, orën dhe vendin e deklaratës në procedurën paraprake (neni 132 (6) i KPP-së) dhe t’i jepet mundësia ta marrë në pyetje dëshmitarin (neni 133 (5) i KPP-së);
 - c. Edhe nëse prova përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit gjyqësor, *“ajo nuk mund të përdoret si provë e vetme ose vendimtare fajësuese për dënimin e të pandehurit”* (Neni 123 (3) i KPP-së).
88. Çështja kryesore në lëndën në fjalë është fakti se deklaratat e zotit M.Sh.u mor pa praninë e asnjë të pandehuri ose avokati mbrojtës. Si pasojë e vdekjes së parakohshme të dëshmitarit, mbrojtja nuk e pati mundësinë t’i testonte këto prova në një kohë të mëvonshme. Prandaj është e pamundur që deklaratat e z. Sh. dhënë EULEX-it të kualifikohet si e barasvlershme me ‘deklaratën në procedurën paraprake’ sipas KPP-së së re dhe si rrjedhojë të mbështetesh në të si dëshmi e drejtpërdrejtë (megjithëse jo e vetme apo vendimtare).
89. Prandaj, me anë të metodës së përjashtimit, trupi gjykues konkludoi se deklaratat e z. Sh. në EULEX duhet të kualifikohet si jo më shumë se e barasvlershme me ‘intervistën në procedurën paraprake’ sipas KPP-së së re. Sidoqoftë, pasi që – përsëri për shkak të vdekjes së dëshmitarit – ajo nuk mund të përdoret në ekzaminimin e tërthortë të tij, efekti praktik është se ajo nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë. Në fund, duket se, megjithëse deklaratat është (sipas arsyesimit të Gjykatës së Apelit) teknikisht ‘e pranueshme’, nuk ekziston asnjë mënyrë që ajo të përdoret si provë e drejtpërdrejtë në shqyrtimin gjyqësor.
90. Një mënyrë tjetër për ta arsyetuar këtë problem do të ishte të demonstrohej se, nëse shqyrtimi gjyqësor do të procedonte sipas KPPP-së (së vjetër), deklaratat e z. Sh. në EULEX mund të ishte përdorur si provë e drejtpërdrejtë në shqyrtimin gjyqësor. Nëse do të ishte kështu, mund të thuhet se *“veprimi procedural që grumbullon provat dhe klauzolat e pranueshmërisë janë kaq të ndërlidhura sa që nuk mund të ndahen”* dhe kështu që duhet të zbatohet KPPP.²³ Kjo linjë argumentimi nuk është e qëndrueshme kur bëhet fjalë për deklaratat e dëshmitarëve. Neni 156 (2) i KPPP parashikon që deklaratat e dëshmitarit *“mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale”*. Kështu, deklaratat e zotit Sh. nuk mund të ishte e mbështetshme në shqyrtimin gjyqësor as në bazë të ligjit të mëparshëm procedural të zbatueshëm.
91. Për këto arsye, trupi gjykues konkludoi se nuk ishte e mundur të mbështetej në deklaratën e z. Sh. në EULEX si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

²³ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 30.

ii. AKK ‘Informacioni në lidhje me pretendimet për korrupsion’ (pa datë, marrë nga PSRK më 20 tetor 2009)

92. Më 06 maj 2009, Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (“AKK”) mori një letër ankese të nënshkruar nga M. Sh., ku pretendohet për korrupsionin nga MTPT në dhënien e kontratave të tenderëve për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Pas kësaj, dy dëshmitarë të Prokurorisë dëshmuar për veprimet e ndërmarra nga AKK, si më poshtë:

a. **H.P.**, Drejtor i AKK-së ndërmjet viteve 2006 dhe 2016,²⁴ përshkroi procedurën e ndjekur nga Agjencia pas marrjes së informacionit (p.sh. në formën e një ankese individuale) të korrupsionit të pretenduar në kohën përkatëse (2009): së pari, informacioni i dhënë u analizua; së dyti, u caktuan oficerë për të kryer një hetim paraprak; dhe, së fundmi, informacioni i plotë iu përcoll autoriteteve kompetente të ndjekjes penale për hetime dhe ndjekje penale të mëtejshme.²⁵

Z. P. dëshmoi se AKK mori një letër ankese nga M. Sh. më 6 maj 2009.²⁶ Dëshmitari hapi një rast dhe caktoi dy oficerë (E. D. dhe B.S.).²⁷ Të dy oficerët morën dy deklaratat nga z. Sh., të cilat ata i audio-incizuan të dyja për shkak të ndjeshmërisë së rastit.²⁸ Ata nuk folën me z. L., z. K. apo ndonjë person tjetër zyrtar, as shqyrtuan dokumentacionin lidhur me tenderët në fjalë, pasi ky ishte një veprim jashtë kompetencës së Agjencisë.²⁹ Z. P. konfirmoi se gjithçka që përmban informacioni i AKK-së bazohet në atë që z. Sh. u tha oficerëve në intervistat e tij.³⁰

AKK i ka përcjellë të gjitha informatat e mbledhura EULEX-it në tetor 2009 dhe, pas një periudhe të gjatë heshtjeje dhe një kërkesë tjetër nga EULEX-i, sërish në vitin 2012.³¹

b. **E. D.**, Oficer i Lartë për Hetimin dhe Zbulimin e Rasteve në AKK që nga mesi i vitit 2008,³² konfirmoi se ankesa e z. Sh. drejtuar AKK-së i ishte caktuar atij.³³ Dëshmitari e ka kontestuar pohimin e z. P. se edhe B. S. ishte caktuar për rastin,³⁴ megjithëse B. S. ishte i pranishëm gjatë intervistës së dytë me z. Sh..³⁵ Siç bënte në të gjitha rastet kur ankuesi është i njohur, z. D. e ftoi z. Sh.

²⁴ Procesverbali, 27 maj 2016, f. 5.

²⁵ Procesverbali, 27 maj 2016, f. 5-7.

²⁶ Procesverbali, 27 maj 2016, f. 7; 12 korrik 2016, f. 3.

²⁷ Procesverbali, 27 maj 2016, f. 7-8; 12 korrik 2016, f. 3.

²⁸ Procesverbali, 12 korrik 2016, f. 4-6.

²⁹ Procesverbali, 12 korrik 2016, f. 4, 6-7, 14-15.

³⁰ Procesverbali, 12 korrik 2016, f. 14.

³¹ Procesverbali, 12 korrik 2016, f. 6.

³² Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 3-4; 11 tetor 2016, f. 4.

³³ Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 4.

³⁴ Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 7, 9.

³⁵ Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 9.

në Agjenci për një diskutim të thelluar.³⁶ Ata u takuan dy ose tre herë, dhe takimet e tyre u incizuan që nga gjysma e dytë e bisedës së tyre të parë e më tutje.³⁷ Z. Sh. gjithashtu paraqiti disa dokumente tenderi, që u shqyrtuan nga dëshmitari.³⁸

Dëshmitari konfirmoi se AKK nuk kreu hetime në këtë rast dhe se gjithçka që përmendet në Informacionin e AKK-së bazohet në deklaratat e pa-verifikuara të z. Sh.³⁹ Megjithatë dëshmitari kontestoi edhe pretendimin e z. P. se AKK nuk i kreu hetimet e veta në kohën përkatëse – duke deklaruar se hetimet u ndalën sepse rasti u kërkua nga EULEX-i. Rrjedhimisht, informacioni që iu përcoll EULEX-it ishte vetëm ai që ishte mbledhur deri në atë fazë, dhe jo si rezultat i një hetimi të plotë.⁴⁰ Më pas në dëshminë e tij, dëshmitari konfirmoi se hetimi i mëtejshëm nga një autoritet tjetër ishte i nevojshëm, pasi disa hapa të caktuar hetimorë mund të urdhëroheshin vetëm nga prokuroria.⁴¹

93. Informacioni që iu përcoll EULEX-it ishte në formën e **“Informacionit lidhur me pretendimet për korrupsion”** (në vijim **“Informacioni i AKK-së”**), i nënshkruar nga z. P. (dokumenti nuk ka datë, por është vuloset si i marrë nga PSRK më 20.10.2009). Ky dokument është një letër ose raport i shkurtër, i cili përmbledh dhe citon pjesë të deklaratave të dhëna nga z. Sh. në AKK gjatë intervistave të tij, dhe ia dërgon këto PSRK-së për hetim të gjithanshëm. Në Informacionin e AKK-së janë bashkangjitur, *ndër të tjera*, letra origjinale e ankesës së z. Sh. dhe deklaratat e audio-incizuara nga AKK.
94. Pas kundërshtimeve të mbrojtjes ndaj provave në MTPT I (përkthyer në Pjesën I.1), kryetari i trupit gjykues i përjashtoi si të papranueshme **deklaratat e audio-incizuara** (dhe të transkriptuara) të M. Sh.⁴² Ky vendim u konfirmua nga Gjykata e Apelit⁴³, e cila më tej vuri në dukje se *“deklarata e M.SH.në AKK nuk përbën provë në këtë procedurë penale ... Këto materiale mund të trajtohen vetëm si informacion që çoi në paraqitjen e kallëzimit penal të AKK-së në PSRK.”*⁴⁴ Përkundër referimit të panevojshëm dhe konfuz të Gjykatës së Apelit në deklaratat e audio-incizuara që u *“trajtohen si informacion”*, trupit gjykues kuptoi se kjo që do të thoshte se këto deklarata janë të papranueshme dhe nuk u shqyrtuan më tutje në vlerësimin e provave nga ana e tij.
95. Më tej, kryetari i trupit gjykues mbajti qëndrimin se **letra origjinale e ankesës** së z. Sh. paraqet provë të pranueshme shkresore (megjithëse jo një deklaratë dëshmitari)

³⁶ Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 6.

³⁷ Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 6.

³⁸ Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 7-8.

³⁹ Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 8, 10-15; 11 tetor 2016, f. 12, 15, 17.

⁴⁰ Procesverbali, 6 tetor 2016, f. 7, 9-10; 11 tetor 2016, f. 7-12.

⁴¹ Procesverbali, 11 tetor 2016, f. 20.

⁴² P 8/13, datë 01 korrik 2013.

⁴³ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 77.

⁴⁴ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 80.

në këtë lëndë.⁴⁵ Ky aktvendim u konfirmua nga Gjykata e Apelit.⁴⁶ Megjithatë, vlera provuese e letër-ankesës mbetet të përcaktohet nga trupi gjykues.⁴⁷ Ndonëse as kryetari i trupit gjykues, as Gjykata e Apelit nuk u deklaruan shprehimisht lidhur me pranueshmërinë e vetë **Informacionit të AKK-së**, trupi gjykues vlerësoi – në të njëjtën logjikë si letrën e ankesës – se kjo ishte gjithashtu provë e pranueshme shkrese, me vlerë provuese do mbetet për t’u përcaktuar.

96. Prandaj, trupi gjykues e ktheu vëmendjen në vlerën provuese të Informacionit të AKK-së dhe letër-ankesës dhe gjeti që kjo ishte e kufizuar në të dyja rastet. Çështja relevante në këtë aspekt është neni 262 (1) i KPP-së i cili parasheh që “*Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.*” Ndërsa asnjëri prej dokumenteve nuk mund të cilësohet si deklaratë dëshmitari, të dy dokumentet përmbajnë pretendimet e ngritura nga M. Sh. se mbrojtja nuk pati mundësinë të kundërshtonte përmes marrjes në pyetje në asnjë fazë të kësaj procedure. Është veçanërisht e rëndësishme që si z. P., ashtu dhe z. D. dëshmuar se Informacioni i AKK-së bazohet tërësisht në deklaratat e pa-verifikuara të z. Sh. dhe se ata nuk kryen ndonjë hetim domethënës lidhur me pretendimet e z. Sh. para se t’ia përcillnin informacionin PSRK-së.
97. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se prokurori ka të drejtë të mbështetet në këto dokumente për të formuar pretendimet e tij kundër të akuzuarit. Sidoqoftë, trupi gjykues nuk u lejua të mbështetej në to ‘vetëm ose në masë vendimtare’ për fajësimin e të akuzuarit, dhe prandaj mbajti qëndrimin se ato duhet të vërtetohen nga prova të tjera të pranueshme. Më tej, trupi gjykues theksoi se pretendimet që dalin nga z. Sh. – çfarëdo forme prove që ato morën në këtë procedurë – nuk mund të përdoren për të vërtetuar njëri-tjetrin: vërtetësia e pretendimeve të z. Sh. nuk përforcohet nëpërmjet përsëritjes së tyre.

C. Kopje të printuara të SMS-ve të konfiskuar gjatë një bastisjeje në shtëpinë e F.L. në XXX.

98. Neni 259(2) i KPP-së parasheh se provat thelbësisht të pambështetshme janë të papranueshme. Neni 19(1)(1.29) e përkufizon ‘thelbësisht të pambështetshme’ si: “*prova ose informata është thelbësisht e pambështetshme nëse origjina e provës ose informatës nuk është e njohur.*” Me vendimin verbal të datës 16 nëntor 2017, trupi gjykues ka konstatuar se kopjet e printuara të SMS-ve të supozuar të konfiskuar gjatë bastisjes së shtëpisë së F.L.t në XXX me 28 prill 2010 kanë qenë të papranueshme se janë thelbësisht të pambështetshme sipas nenit 259(2) në lidhje

⁴⁵ P 8/13, datë 01 korrik 2013.

⁴⁶ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 83.

⁴⁷ Konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit, PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, paragrafi 85.

me nenin 19(1)(1.29) KPP. Trupi gjykues e ka parë të nevojshme t'i zbuloj tërësisht arsyet e veta për këtë vendim që shtjellohen si në vijim:

99. Trupi gjykues përkujton se Gjykata e Apelit ka konstatuar se kopjet e printuara të SMS-ve të supozuar kanë qenë të papranueshme për arsye se kanë qenë thelbësisht të pambështetshme.⁴⁸ Kolegji i Apelit ka pranuar se “*kopjet e printuara të teksteve të mesazheve nuk janë provë e siguruar me urdhër të ligjshëm për përgjim dhe nuk duhet të trajtohen si të tilla. Prova nuk është marrë me masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit por është gjetur si provë e thjeshtë dokumentuese. Për këtë arsye prova duhet të trajtohet si e tillë.*”⁴⁹
100. Megjithatë, sipas Gjykatës së Apelit, prova nuk ka qenë thelbësisht e pambështetshme sepse “*origjina e saj është e ditur, është gjetur në shtëpinë e F.L.t në XXX.*”⁵⁰ Gjykata e Apelit, më tej, ka vazhduar (jo-bindshëm) të bëjë dallime ndërmjet ‘origjinës’ së provave dhe ‘kompania B.t aktual’ të saj, duke thënë se “*kompania B. aktual i provës dhe autenciteti i teksteve të mesazheve duhet të ekzaminohen me kujdes dhe të vlerësohen gjatë shqyrtimit gjyqësor.*”⁵¹
101. Mbrojtja e ka kundërshtuar pranueshmërinë e këtyre kopjeve të printuara të SMS-ve në disa raste dhe trupi gjykues ka përsëritur aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe qëllimin e tij, për zbatimin e tij, për të vlerësuar kompania B.n dhe autencitetin e SMS-ve të supozuar duke u bazuar në të gjitha provat të paraqitura nga prokurori.⁵² Për këtë qëllim, gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues i ka lejuar prokurorit liri të madhe ta eksploroj me dëshmitarët e vet teorinë e tij se kopjet e printuara të SMS-ve janë kopje origjinale të SMS-ve nga Vala të përgjuara ndërmjet E.SH. dhe F. Z., që në një mënyrë janë shlyer nga shënimet zyrtare të Valës dhe prandaj nuk janë paraqitur pas urdhrave të ligjshëm për përgjimit. Kështu, për shembull, prokurorit i është lejuar t’ua bëjë të ditur përmbajtjen e këtyre komunikimeve të supozuara dëshmitarëve të cilët mund të kenë qenë në gjendje ta konfirmojnë se kanë pasur dijeni për to dhe se, në mënyrë indirekte, ato kanë qenë autentike.⁵³
102. Dëshmitari i fundit i prokurorisë ka qenë Detektivja Rreshter M. T.,⁵⁴ që ka shërbyer si hetues në këtë rast.⁵⁵ Një raport policor i EULEX-it i përpiluar nga zn.Toivonen dhe një hetues tjetër, i datës 28 mars 2012,⁵⁶ shpreh pikëpamjen se “*SMS-të e supozuar në kopje të printuara....të gjetur në shtëpinë e F.L.t janë kopje të printuara origjinale nga regjistrimi i thirrjeve ndërmjet E.SH. dhe F.Z. (T.*

⁴⁸ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, f.29, paragrafët 101-106

⁴⁹ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, f.29, paragrafi 102.

⁵⁰ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, f.29, paragrafi 106.

⁵¹ PN 577/2013, 10 dhjetor 2013, f.29, paragrafi 106.

⁵² Shiko, p.sh, Procesverbali, 17 maj 2016, f.4; 19 maj 2016, f. 6-9.

⁵³ Shik, p.sh. dëshmia e A. G., Procesverbali, 15 mars 2017, f. 8-11.

⁵⁴ Procesverbali, 2 nëntor, f.4

⁵⁵ Procesverbali, 2 nëntor 2017, f.5-6

⁵⁶ Raporti i policisë; Eulexit: Njësia e Hetimeve të Krimin të Organizuar NJHKO/12/20120328/3590’, Regjistratori 12B, f. 47-48.

Co)” dhe, kurse, “ *versioni [elektronik] i gjetur në një kartë memorie është version i ‘pastruar’ i regjistrimit*”. Përveç përmbajtjes së mesazheve (që ka një marrëdhënie me procedurat bashkëkohore të tenderimit), baza kryesore për këtë pikëpamje është se SMS-të e gjetur në kopje fizike nuk gjenden edhe në kopjet elektronike (“ *pas krahasimit me kopjet fizike aty mungojnë disa mesazhe.*”)⁵⁷. Kjo ka bërë që hetuesit të dalin me teorinë se “*Mesazhet e L. mungonin nga versioni elektronik që janë shlyer nga sistemi i Valës*”.

103. Megjithatë, raporti nuk ndalet aty. Hetuesit raportues propozojnë hapa tjerë hetuese për të “ *[vërtetuar] nëse mesazhet janë shlyer nga sistemi dhe nëse kanë qenë kur janë shlyer dhe kush ka mundur t’i shlyej*”. Qëllimi i këtyre veprimeve, sipas znj. T. dhe kolegut të saj shërben “ *për t’i dhënë versionit fizik një bazë më të fortë provuese.*” Znj. T. dhe kolegu i saj më tej rekomandojnë, *inter alia*, një bastisje në sistemin Vala, dhe intervista me “Z. G.” (autori i dosjeve në kartën memorie) dhe të tjerët që kanë qasje të autorizuar në sistemin Vala/PTK. Në dëshminë e saj të drejtpërdrejtë, znj. T. ka përsëritur pikëpamjen e saj se duheshin hetimet tjera,⁵⁸ dhe vazhdimisht shprehte zemërim për mënyrën si i ka zhvilluar hetimet prokurori.⁵⁹
104. Trupi gjykues pajtohet se janë dashur hetime tjera për të vërtetuar origjinën e SMS-ve të supozuar. Pasi dëgjimi të të gjitha provat në këtë çështje u krijuar bindja se prokurori nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm teorinë e tij se kopjet e printuara të SMS-ve të supozuar kanë dalë nga Vala – dhe nuk janë, prodhim i shkrimit imagjinar. Trupi gjykues është i mendimit edhe Gjykata e Apelit ka mundur ta nxjerrë një përfundim të tillë në fazën e procedurës paraprak, sepse kurrë nuk ka qenë teori e prokurorit se origjina e kopjeve të printuara të SMS-ve në

⁵⁷ Shiko edhe Procesverbalin, 2 nëntor 2017, f. 14.

⁵⁸ Procesverbalin 2 nëntor 2017, f. 18-19, f. 23 (“ *...gjashtë njerëz.. kanë pasur autorizim në sistemin administrative të PTK-së... Unë doja që ata të intervistohen atëherë por prokurori tha se nuk është e nevojshme sepse nuk do t’ju tregojnë asgjë.*”); 3 nëntor 2017, f. 6-7 (“ *prokurorit ia kemi dërguar të gjitha gjetjet tona me sugjerime se ne, ekipi hetuese, dëshironim të veprojmë. Vetëm t’i intervistonim këta persona që kishin të drejtë në sistemin administrativ të PTK-së gjë për të cilën mendoj se të gjithë në ekipin hetuese e mendonim si të rëndësishme dhe në këtë bazë ia patëm dorëzuar të gjitha raportet z. Pickert dhe jemi shtyrë me fjalë me z. Pickert sepse ia mendonte se nuk kemi nevojë t’i intervistojmë këta persona në PTK dhe thoshte se ata nuk do t’ju tregojnë asgjë disi dhe unë iu përgjigja dhe më pas ia dhashë raportin dhe më pasi ai ishte personi që ka përgatitur hapin tjetër. Unë jam hetues të dal dhe t’i pyes njerëzit*”); p. 11, 13-14.

⁵⁹ Procesverbalin, 2 nëntor 2017, f.5 (“ *në pikëpamjen time të jesh hetues kryesor në Eulex ku prokurori është në krye të hetimeve dallon shumë nga përshtkrimi i punës në vendin tim sepse atje kur policia është në krye të hetimeve do të thotë se unë jam ajo që bëj arsyetime dhe jam ajo që nxjerrë vendime, por këtu nuk kam mundur ta bëjë këtë. Ka qenë prokurori dhe nuk ka qenë gjithnjë e lehtë.*”); f. 20 (*Jam grindur shumë me prokurorin. Kishim dallime, thashë në fillim se në Finlandë, policia është në krye të hetimeve kurse në Gjermani janë prokurorët. Kjo mjafton nganjëherë... kemi mënyra të ndryshme në të menduarit taktik dhe për veprimet që duhet marr dhe Finlandezë mund të jenë kryeneç.*”); 3 nëntor 2017, f.4 (“ *... prokurori është përgjegjës dhe në këtë rast ka qenë Johannes Pickert dhe këshilltari i tij ligjor Bernard Kushnick, informimi ndërmjet ekipit hetues dhe prokurorit nuk ka qenë gjithnjë në nivelin që ka dëshiruar ekipit hetues. Nuk dua ta fajësoj askënd për këtë por herë e herë na është dukur jashtëzakonisht i vështirë.*”)

një mënyrë ishte shtëpia e z. L., por Vala, pyetja relevante ishte nëse ka pasur indikacione se SMS-ët kanë dal nga Vala.

D. Raportet e ekspertëve të L. M., K. G. dhe J. H.

105. Me datën 19 mars 2012, në pajtim me nenet 236 dhe 237 të KPPK-së, PSRK-ja lëshoi një Urdhër të prokurorit publik për dëshmitarin ekspert duke caktuar Dr. J. H., Z. L. M. dhe Z. K.G. Më pas, janë dorëzuar tri raporte të ekspertëve si në vijim:
 - a. Raporti nga Z. M. dhe Z. G i datës 1 qershor 2012;
 - b. Raporti nga Z. M. dhe Z. G. i datës 30 maj 2013;
 - c. Raporti nga Dr. H.i datës 11 tetor 2012.
106. Këto raporte u kundërshtuan nga mbrojtja, veçanërisht në fjalët përfundimtare të bëra me datën 22 nëntor 2017. Një varg çështjesh janë kundërshtimet dhe ato janë përmbledhur si në vijim.
107. Avokati mbrojtës Karim A. Khan parashtroi se K. G., shtetas gjerman, ishte zgjedhur si ekspert i ligjit të prokurimit nga ana e vetë prokurorit në atë kohë, Johannes Pickert, si duket për asnjë arsye tjetër veç asaj se ata ishin 'shokë' dhe të dytë ishin gjermanë. Z. Khan argumentoi se z. G. e mori përgjegjësinë e kolegjit duke ofruar një interpretim të ligjit të prokurimit të Kosovës, si në pjesën e tij të raporteve të ekspertëve e po ashtu edhe në dëshminë e tij të drejtpërdrejt me datën 1 nëntor 2017. Z. Khan gjithashtu parashtroi se Z. G. nuk është avokat i regjistruar në Gjermani, as ekspert i gjykatës në Gjermani dhe se ai nuk posedon një kualifikim të specializuar në prokurim të mjaftueshëm për t'u kualifikuar si ekspert.
108. Disa avokatë mbrojtës shtuan vërejtjet se prokurori nuk ia kishte siguruar Z. G. dokumentet origjinale të tenderit dhe specifikimet teknike. Përkundër kërkesës së Z. G. për dokumente shtesë, prokurori i kishte ofruar atij vetëm dosjen e tenderit. Një komision profesional kishte përpiluar procesverbalin e vlerësimit teknik, por nuk i ishte ofruar ekspertit për shqyrtimin e tij. Avokati mbrojtës gjithashtu parashtroi se Z. G. nuk i njihte detyrat specifike që i caktoheshin nga ana e prokurorisë, sepse këto nuk i ishin ofruar atij. Më tej, Z. Khan parashtroi se raporti i Z. G. është i bazuar në informatat e dhëna nga prokuroria të cilat janë treguar të jenë të mangëta. U theksua gjithashtu se z. G. nuk kishte qenë kurrë në Kosovë para se të vinte për të dhënë dëshminë. Së fundi, ai nuk kishte përdorur një përkthyes të autorizuar, por kishte përdorur Google për të ndihmuar në përkthimin e dokumenteve. Z. Latifaj mbështeti komentet e Z. Khan lidhur me ekspertizën e Z. G. dhe Z. M. dhe gjithashtu parashtroi se z. G. kishte deklaruar në dëshminë e tij se ai nuk ishte një ekspert gjyqësor.
109. Sa i përket Z. M., avokati mbrojtës parashtroi se prokuroria nuk e kishte demonstruar që Z. M. ishte ekspert në çështjet përkatëse të rastit. Më tej, thuhet se vlerësimet në raporte janë të bazuara në standardet gjermane dhe evropiane pasi që ata nuk i dinin standardet e Kosovës për ndërtimin e rrugëve. Blerim Prestreshi,

- avokati mbrojtës i F. Z., ngriti edhe çështjen se nuk është e sigurt se ku janë mbledhur mostrat përkatëse pasi që askush nga Ministria e infrastrukturës ose Komuna ku ndodhet rruga, nuk ishte i pranishëm kur ato mostra ishin marrë.
110. Trupi gjykues pranoi raportet e ekspertëve, për arsyet si në vijim. Edhe nëse prokurori, Johannes Pickert njihej me K.G., trupi gjykues nuk gjeti asnjë shenjë se kjo, ose fakti që ata të ishin gjerman, ishte motivimi i prokurorit në përzgjedhjen e tij për ta caktuar Z. K.G si ekspert në këtë rast.
 111. Trupi gjykues theksoi se prokurori përmendi aftësitë dhe përvojën e të tre ekspertëve në Urdhrin e datës 19 mars 2012 në seksionin B me titull ‘Detyrat dhe përshtatshmëria e ekspertëve’, dhe pranoi që kjo i bën ata të përshtatshëm për këtë detyrë. Më tutje, përvoja e ekspertëve dhe referencat e të dyve Z.G. dhe Dr. H. u adresuan në mënyrë specifike në dëshmitë e tyre përkatëse të datave 1 dhe 7 nëntor 2017. Në veçanti, K.G. deklaroi se në Gjermani të gjithë avokatët janë të arsimuar në të gjitha fushat e ligjit, por që nga viti 1999 ai kishte specializuar në Ligjin evropian të prokurimit. Ai më tutje deklaroi se kishte punuar për disa vite me Komisionin evropian në projektet e binjakëzimit që përfshijnë ligjin e prokurimit me Republikën Çeke, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni dhe Moldavi. Trupi gjykues pranoi se të dy ishin mjaft të kualifikuar për detyrat që ata morën përsipër.
 112. Sa i përket komenteve të K.G. lidhur me Ligjin e prokurimit të Kosovës, trupi gjykues nuk i konsideroi ato si një përpjekje e K.G.për të uzurpuar rolin e tij. Përkundrazi, këto thjesht sigurojnë informata shpjeguese për procesin e prokurimit dhe e krahasojnë këtë me standardet evropiane si një mënyrë për të nxjerrë në pah fushat potenciale problematike të identifikuar dhe të adresuara në nivel evropian. Kolegji vetë ka shqyrtuar me kujdes të gjitha ligjet përkatëse të zbatueshme.
 113. Sa i përket informatave të cilat iu janë vënë në dispozicion ekspertëve nga ana e prokurorisë, trupi gjykues ka vërejtur dhe marrë parasysh të gjitha rastet kur informacioni i dhënë nga prokurori kufizon analizën të cilën eksperti mund të ndërmerret. Konkretisht trupi gjykues konsideron se K.G. nuk ishte në gjendje të bënte vlerësimin e tij të pavarur të pikëve të cilat u jepeshin ofertuesve individualë nga komisionet e vlerësimit të ofertave që kryen një vlerësim ‘ekonomikisht më të favorshëm’ dhe kjo në disa raste e kufizoi dobinë e komentit të tij mbi këto pika. Trupi gjykues gjithashtu konsideroi se J.H. ishte në gjendje ta ndërmerre një vlerësim teknik përkundrejt standardeve relevante të Kosovës, të cilat nuk iu siguruan atij.
 114. Më tej, K.G. i janë bërë pyetje mjaft specifike për t’u përgjigjur. Urdhri i prokurorit i datës 19 mars 2012 është i qartë sa i përket çështjes së caktimit. Trupi gjykues shqyrtoi pjesën e mbetur të çështjeve të ngritura nga avokati mbrojtës siç është mbështetja e pjesshme në Google për përkthimin e disa fjalëve, të jetë i parëndësishëm dhe se çështjet e tilla të vogla nuk e zvogëlojnë përmbajtjen materiale të raporteve të ekspertëve.

115. Megjithatë, trupi gjykues theksoi se raporteve të ekspertëve iu mungojnë disa formalitete të parapara nga KPP. Neni 138 i KPP-së, me titull ‘Raporti i Ekspertit’, përmban kërkesat e një raporti të ekspertit dhe parashikon që raporti të jetë i papranueshëm nëse nuk përputhet me këto kërkesa. Në veçanti, neni 138(1.3) parasheh që një raport i ekspertit duhet të përmbajë përvojën dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime, dhe këto detaje mungojnë në raportet e ekspertëve.
116. Sidoqoftë, trupi gjykues theksoi që Urdhri i prokurorit publik për dëshmitarin ekspert është bërë në pajtim me nenet 236 dhe 237 të KPPPK, i cili ishte Kodi në fuqi në kohën e lëshimit të Urdhrit. KPPPK është më pak specifike se pasardhësi i tij lidhur me kërkesat formale të një raporti të ekspertit. Neni 237 thotë se dispozitat e Kapitujve XX ‘Dëshmitarët’, XXI ‘Mbrojtja e Palëve të Dëmtuara dhe Dëshmitarët’ dhe XXII ‘Dëshmitarët e Ekspertëve’ në lidhje me dëshmitarët ekspertë do të zbatohen *mutatis mutandis*. Neni 183 thjesht thekson se procesverbali i ekspertimit ose rezultati me shkrim i konstatimit dhe i mendimit duhet të përmbajnë emrin e personit që e ka kryer ekspertimin, profesionin e tij apo të saj, përgatitjen profesionale dhe specialitetin e ekspertit. Trupi gjykues është i kënaqur se Urdhri i prokurorit përmban detaje të mjaftueshme të kredencialeve të ekspertëve dhe se përndryshe raportet e ekspertëve i plotësojnë kërkesat formale sa i përket përmbajtjes që ishte në fuqi asaj kohe.

V. KRIMET E NGARKUARA

A. Krim i organizuar (Pika 1 e aktakuzës)

117. Pika 1 e Aktakuzës ngarkon të akuzuarit **F.L., E.SH., N.K.** dhe **SH.T.** si bashkëkryerës të veprës penale të Krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274(3) të KPPK-së, lidhur me paragrafin 1. Neni 274 (1) i KPPK-së e ndëshkon kryerjen e “krimit të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal.” Neni 274(7)(3) thekson se “shprehja ‘krim i rëndë’ do të thotë vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet”. Siç shtjellohet në Pjesën II.A.i (paragrafët 24-28), shumica e trupit gjykues kanë miratuar një interpretim të përpiktë për “krim i rëndë” për të nënkuptuar një vepër penale të dënueshme me burgim prej *minimumi* katër vjet. Shumica e trupit gjykues ka refuzuar interpretimin e gjerë, i cili me fjalët “së paku katër vjet” nënkuptonte se burgimi prej katër vjetësh është në kuadër të kufijve të dënimit për një veprën penale të caktuar.
118. Duke qenë se kërkesat për veprën penale bazë të kryer si Krim i organizuar – “krimi i rëndë” – nga neni 274(7)(3) duhet të jetë një vepër e dënueshme me burgim prej minimumi katër vjet, trupi gjykues aplikoi interpretimin e vet ndaj Pikave 2 deri në 6 të Aktakuzës, si në vijim. Pika 2 e aktakuzës, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 422 (më të butë) të aplikueshëm të KPK-së dënohet me gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim. Pika 3 e aktakuzës, Marrja e ryshfetit në kundërshtim me nenin 343 (1) të KPPK-së dënohet

me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. Pika 4 e aktakuzës, Dhënia e ryshfetit në kundërshtim me nenin 344 (1) të KPPK-së dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. Pika 5 e aktakuzës, Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi në kundërshtim me nenin 236(1)(5) dhe (2) të KPPK-së dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet. Pika 6 e aktakuzës, Mos-deklarimi i parave të marra për fushatë në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/2 është e dënueshme me burgim deri në pesë vjet dhe me gjobë ose me burgim prej dy vjetësh dhe me gjobë.

119. Kështu, asnjëra nga veprat penale bazë të përmendura në Pikat 2 deri në 6 të Aktakuzës nuk përmbush kërkesën për “krim i rëndë” pasi që asnjëra nga to nuk janë të dënueshme me minimumin katër vjet burgim. Prandaj, veprat me të cilat të akuzuarit ngarkohen nuk përbëjnë veprën penale të Krimit të organizuar sipas përkufizimit të nenit 274(7)(3) të KPPK-së. Për këto arsye, trupi gjykues ka liruar të akuzuarit F.L., E.SH., N.K.dhe SH.T. nga Pika 1 e Aktakuzës në përputhje me nenin 364(1)(1.1) të KPP-së.
120. Trupi gjykues gjithashtu theksoi se do të kishte arritur te konstatimi i njëjtë edhe nëse do kishte aplikuar interpretimin e gjerë të “krimi i rëndë”. Siç do shihet në arsyetimin vijues, trupi gjykues konstatoi se prokurori nuk e ka dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshem se të akuzuarit kanë kryer veprat me të cilat ata ngarkoheshin në Pikat 2, 3, 5 dhe 6 të aktakuzës (për: mos-Deklarimin e parasë së pranuar për fushatë). Pikat 4 dhe 6 (për: pranimin e kontributeve politike që tejkalojnë vlerën 1.000 Euro nga një burim i njëjtë brenda ditës së njëjtë) ishin hedhur poshtë si të parashkruara sipas parashkrimit absolut. Prandaj, edhe nëse trupi gjykues do kishte pranuar se veprat e ngarkuara në parim mund të përbënin veprat e rënda penale bazë të Krimit të organizuar, kjo nuk do të ishte vërtetuar në këtë rast.

B. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (Pika 2 e aktakuzës)

ii. Tenderi 08-049-511 - Ndërtimi i rrugës Ponesh-Zhegovc, Gjilan, fituar nga kompania T.

121. Prokurori ka bërë tri pretendime të ndryshme për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar në lidhje me procedurën e tenderit ‘Ndërtimi i rrugës Ponesh-Zhegovc’ në Gjilan (08-049-511). Këto janë: (a) **F.L.** ia ka premtuar tenderin M. Sh., ka këshilluar M. Sh. se çfarë duhet të bëjë për të fituar tenderin dhe ishte ndryshe në mënyrë jo të duhur i përfshirë në dhënien e tenderit; (b) **N.K.**ka nënshkruar kontratën me fituesin eventual, kompaninë T. , pavarësisht që i ka ditur se i. F.Z. ka hy në një marrëveshje të fshehtë për caktimin e çmimeve me vëllain e tij N. Z. Te kompanisë Z.C dhe ii. ka pasur disa shkelje në procesin e prokurimit; dhe (c) ndërkohë që rruga u ndërtua dhe pasi u informua nga F.Z. se kishte defekte në ndërtimin e saj, **E.SH.** e ka udhëzuar Zukën që të vazhdojë.

122. Prokurori nuk ka pretenduar përfshirjen e **SH.T.t** në këtë procedurë të tenderit dhe përgjegjësia e tij penale nuk konsiderohet më tutje në këtë pjesë. Pretendimi se **F.Z.** ka hyrë dhe ka toleruar një marrëveshje për caktimin e çmimeve me vëllain e tij **N. Z.** të kompanisë **Z. K.** në ofertimin për këtë tender përbën gjithashtu bazën e akuzave kundër tij për keqpërdorimin e autorizimeve ekonomike të ngarkuara nën Pikën 5 të aktakuzës. Këto konsiderohen veçmas në Pjesën V.D.i.

A i ka premtuar F.L. M.SH. rrugën Ponesh-Zhegovc?

123. Duke iu kthyer pretendimeve të prokurorit në lidhje me F.L., prokurori pretendon se F.L. personalisht i ka premtuar tenderin për ndërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc M. Sh. F.L. më vonë e theu këtë premtim (rruga iu dha kompanisë **T.**, në pronësi të të bashkë-akuzuarit **F.Z.**), duke i thënë **M.SH.** se nuk e fitoi tenderin sepse ai nuk kishte referenca të duhura pune⁶⁰. Kontakti me SMS mes z. **M.SH.** dhe **F.L.** ndërmjet 6 dhe 16 majit 2008, sipas prokurorit, "vërteton përfshirjen e **F.L.t** në dhënien e këtij tenderi"⁶¹. Më konkretisht, **M.SH.** dhe **F.L.** u takuan personalisht më 12 Maj 2008 dhe në këtë takim "**F.L. i ka dhënë udhëzime M.SH.se çfarë duhet të bëjë për të fituar këtë tender.**"⁶²
124. Duke u kthyer tek provat e udhëhequra në mbështetje të këtyre pretendimeve, trupi gjykues rikujtoi së pari se deklarata e regjistruar – audio, e dhënë nga z. **M.SH.** në **AKK** është shpallur dëshmi e papranueshme nga kryetari i trupit gjykues, me aktvendim të vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Së dyti, trupi gjykues konstatoi se nuk ishte në gjendje të mbështetej në deklaratën e **M.SH.** në Policinë e **EULEX-it** dhe se informacioni i **AKK-së** (dhe letra e ankesës e **M.SH.** i ishte bashkëngjitur asaj) ishte me vlerë të kufizuar provuese pasi përmbajtja e saj nuk mund të testohet nga mbrojtja⁶³. Trupi gjykues shqyrtoi shkresat e lëndës për dëshmi relevante për keqpërdorim të pozitës zyrtare/autoritetit të **F.L.** me anë të një premtimi ndaj **M.SH.** se atij do t'i jepet tenderi për ndërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc (08-049-511) dhe theksoi si vijon:
- a. **Informacioni i AKK-së** i hartuar dhe dërguar nga **H. P.**, Drejtori i **AKK-së**, në **PSRK** (pa datë, por i pranuar nga **PSRK** më 20 tetor 2009)⁶⁴ raporton deklaratat e dhëna nga **M.SH.** në **AKK**, për **PSRK-në** për një hetim më gjithëpërfshirës. Informacioni i **AKK-së** përcakton sfondin që shpuri deri te premtimi i pretenduar i tenderit 08-049-511 nga **F.L.**, duke raportuar se **M.SH..M.Sh.përshkroi perceptimin.**⁶⁵

⁶⁰ Aktakuza e Konsoliduar, f. 8; faqe 34, paragrafët 54-55, 61-62.

⁶¹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 34, paragrafi 56.

⁶² Aktakuza e Konsoliduar, f. 35, paragrafi 58.

⁶³ Shih Seksionin IV.B.

⁶⁴ 'Informacion në lidhje me korrupsionin e supozuar', **H. P.**, Drejtor i **AKK**, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 1-27.

⁶⁵ 'Informacion në lidhje me korrupsionin e supozuar', **H. P.**, Drejtor i **AKK**, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 3.

"Padrejtësia që i është bërë atij kur disa nga referencat e punës, të cilat kishin pasur para luftës dhe për të cilat ai posedon kontrata relevante si dëshmi, nuk u pranuan kur ai bëri një ofertë për disa nga tenderët e shpallur nga...ministra."

Informacioni i AKK-së citon M. SH të thotë:⁶⁶

"Ne si kompani nuk i plotësuam kriteret sipas kërkesës së MTPT-së, kështu që filluam të bashkëpunonim me një firmë tjetër të quajtur 'Planning' (sic), përfaqësuar nga Z. Sh. (sic), pasi që këta të fundit nuk kishin referencat aq relevante dhe pasi që këto kriteret, në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, janë vënë si kriteret për të fituar kontratën publike, duke e bërë kështu të pamundur për kompaninë time (M.SH.) (përkthimin fjalë për fjalë-shënim i përkthyesit) për të fituar kontratë publike".

Ai vazhdon me pohimin e përgjithshëm të M.SH. se kompanisë I.E. /P. I. nuk iu dha kontrata sepse refuzuan të paguajnë ryshfetin e kërkuar:⁶⁷

"M.SH. shpjegon se megjithëse bashkëpunoi me kompaninë 'P.I.', në pronësi të Z.SH., ata nuk mund të fitonin asnjë tender të tillë dhe kjo ishte për shkak se, siç theksoi M.SH., ai nuk u dha atyre përqindjen e kërkuar në tenderët për të cilën ai kishte vendosur një ofertë."

Raporti pastaj ofron, përkatësisht për këtë tender specifik, tekstualisht:⁶⁸

"I pakënaqur me atë që po ndodhte me të, M.SH. deklaroi se ka pasur një takim me z. Z. P., ministër aktual i Punëve të Brendshme, kur ata biseduan për këta tenderë dhe për faktin se kompania" I. E. "nuk ishte në gjendje për të fituar ndonjë prej tyre. Ishte sugjeruar nga Z. P. që M.SH. të takohet me ministrin F.L. pasi që ata e njihnin mirë njëri-tjetrin, dhe më pas Z. P. kishte rregulluar një takim me ministrin F.L."

'Isha në rrugë, duke udhëtuar, në momentin kur jam ftuar në takimin e organizuar nga Z.P. për neve me F.L', thotë M.SH., 'por kam telefonuar djalin tim B.SH. dhe i kam thënë se ai duhet të shkojë dhe të takohet me ministrin F.L, pasi që djali im gjithashtu e njihnte mirë ministrin F.L. Kur B.SH. shkoi në ministri, ai u takua me ministrin F.L dhe pas bisedës që kishin, "vazhdon në deklaratën e tij M.SH." më ka thirrë në telefon djali im B.SH. i cili më tha: - Tani do të bisedosh me ministrin F.L. B.SH. ishte në një takim me të gjatë kësaj kohe. Ky takim u zhvillua në vitin 2007 dhe F.L. na tha: - Rruga Ponesh - Zhegovc është e juaja. B.SH. ishte gjithashtu i pranishëm kur biseduam përmes telefonit të B.SH.. Ka kaluar një muaj dhe tenderi nuk na është dhënë',

⁶⁶ 'Informacion në lidhje me korrupsionin e supozuar', H. P., Drejtor i AKK, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 3.

⁶⁷ 'Informacion në lidhje me korrupsionin e supozuar', H. P., Drejtor i AKK, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 3.

⁶⁸ 'Informacion në lidhje me korrupsionin e supozuar', H.P. , Drejtor i AKK-së, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 3-4.

vazhdon M.SH. 'Një muaj më vonë, F.L më ka telefonuar dhe më ka thënë: - Të mërkurën po vij në Gjilan në Komunë. Kam pritur F.L. dhe kemi pasur një takim me Kryetarin e Gjilanit, Xh. M., dhe më pas ai ka pasur një intervistë me gazetarët; në këtë rast unë nuk mund të flas për atë që kemi rënë dakord për të folur, dhe F.L., pas përfundimit të intervistës me gazetarët, më tha të shkoj një ditë në ministri dhe të pij kafe me të.

Vendosa të shkoj dhe të takohem me ministrin F.L. para shpalljes së tenderit për rrugën Ponesh - Zhegovc, por, para se të shkoj në këtë takim me F.L.. F.Z. ... u takua me F.L. dhe i ka kërkuar që kjo rrugë t'i jepet atij, por atij i është thënë nga F.L. se ata nuk mund t'i jepnin atij këtë rrugë pasi që ajo më ishte premtuar mua (që do të thotë për M.Sh. – shënim i përkthyesit).'

...'Zoti. F.Z. ... më ka telefonuar dhe më ka pyetur se ku isha dhe i thashë se isha rrugës për në Prishtinë, pikërisht në lagjen Veternik, për tu takuar me ministrin F.L., pasi që ky i fundit më kishte ftuar për një kafe. Z. F.Z. më tha ta prisja edhe atë dhe unë e kam pritur. Pasi jemi takuar ai më ka ftuar në zyrën e tij ... Ne kemi shkuar atje dhe jemi takuar me I. Sh., pronar i kompanisë 'E'. Pasi e kemi përshëndetur njëri-tjetrin, I. Sh. më ka thënë këto fjalë: - Ata kanë telefonuar mbrëmë nga ministria, rreth orës 1 (një) në mëngjes dhe më kanë thënë që kompania "I. E." nuk po kalon, edhe pse keni qenë në konsorcium me kompaninë 'P'. Pasi mbaroi takimi me ta dhe pasi më janë thënë këto fjalë nga I.Sh., vendosa të shkoj në ministri dhe të takohem me F.L. për të marrë më shumë informata të detajuara për këtë tender pasi që I. Sh. ishte gjithashtu një ofertues me kompaninë 'E' dhe për të verifikuar se pse I.Sh. më tha këto fjalë.'

Në deklaratën e tij M. Sh. thotë se ai ka shkuar në [MTPT] dhe ka kërkuar një takim me ministrin F.L., ku ai priti një orë e gjysmë dhe më pas u takua me ministrin. Në këtë takim morën pjesë A.G., zëvendësministër i [MTPT], z. N. K., menaxher i prokurimit në [MTPT] dhe këshilltar i ministrit, emri i të cilit nuk kujtohet, dhe ky staf iu prezantua atij nga F.L. i cili tha: - Ky është stafi im me të cilin punoj. "Pasi u njoha me stafin nga F.L ai më tha se nuk i plotësoj kushtet për të fituar këtë tender, po flasim për tenderin rrugor Ponesh-Zhegovc, por ata po ia japin kompanisë T. dhe që unë do ta marr atë prej tij. Më shumë se një muaj kaluan dhe fituesi nuk u shpall apo publikua në gazeta. ...

Informacionin e AKK-së është i bashkangjitur në letrën origjinale të ankesës së M.Sh. (gjithashtu e pa datë, e marrë nga AKK më 6 maj 2009). Pjesët përkatëse të kësaj letrë listojnë projektet për të cilat kompanitë I.-E. dhe P. I. kanë ofertuar: "4. Shtrimi i Asfaltit në rrugën Ponesh - Zhegovc, kjo rrugë më është premtuar nga F.L. dhe ai nuk e mbajti premtimin ".⁶⁹

⁶⁹ 'Informacion në lidhje me korrupsionin e supozuar', H. P., Drejtor i AKK, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 10

- b. **H. P.**, dëshmia e të cilit është përmbledhur në Pjesën IV.B.ii, konfirmoi se 'Informacioni lidhur me korrupsionin e supozuar', i nënshkruar prej tij, është dokumenti që AKK i ka dërguar EULEX-it.⁷⁰
- c. Dëshmia e **E. D.** është përmbledhur më parë në Pjesën IV.B.ii.
- d. **SMS-të e përgjuar gjatë asaj kohe**, duke përfshirë:
- i. SMS-të e përgjuara mes M. Sh. dhe F.L. më 6 maj 2008 lexojnë:⁷¹
M.Sh.: *"Mirëmëngjes Ministër. Jam M. Sh. nga Gjilani, më njoftoni kur keni kohë për të më takuar dhe për të pirë kafe me mua."* (8:20)
F.L.: *"Do të jem në territorin tuaj."* (9:22)
 - ii. SMS-të e përgjuara mes M.Sh. dhe F.L. më 10 maj 2008 lexojnë:⁷²
M.Sh.: *"Mirëmëngjes z. Ministër, jam M. Sh. dhe sot jam në Prishtinë; a mund të takohemi diku dhe të pijmë kafe së bashku dhe më tregoni se në çfarë kohe nëse mundeni?"* (7:39)
F.L.: *"Eja te Ariu"* (11:46)
 - iii. SMS-të e përgjuara nga M.Sh tek F.L. dërguar më 12 maj 2008 lexojnë:⁷³
"Mirëmëngjes, z. Ministër, sot do të vij kah ju; atë ditë kisha një problem dhe nuk kam mundur të qëndrojë më gjatë në Prishtinë. Besoj se do të jem tek ju rreth orës 10" (8:25)
"Jam M.Sh. nga I. E. Në lidhje me atë që kemi biseduar sot, referencat nuk po pranohen për të ardhmen, prandaj nuk mund të punoj në emër të kompanive të tjera, por shpresoj që ju do t'a jepni drejtpërdrejt në emrin tonë kështu që do të kemi referencat për punët e ardhshme . Përshëndetje nga Gjilani " (22:29)
- e. **Z. Q.**, teknik i inxhinierisë civile dhe pronar i kompanisë *P. I.*⁷⁴, ka dëshmuar se e njëjtte M. Sh. qysh prej vitit 1973, pasi që të dy ishin nga Gjilani dhe se kompania e M.Sh., *I.-E.*, *"kryesisht është marrë me shitjen e drurëve dhe ka poseduar kamionë "*.⁷⁵ Dëshmitari dhe M.Sh. kanë rënë dakord që të bëjnë ofertë në konsorcium për tenderin Ponesh-Zhegovc, sepse kompania *P. I.* kishte në dispozicion referencat e nevojshme të punës, ndërsa kompania *I.-E.*

⁷⁰ Procesverbali, 12 korrik 2016, f. 8-9

⁷¹ Transkripti i SMS mes M. Sh. dhe F.L.t, të datës 6 maj 2008: Përmbledhja e të dhënave të përgjimeve 48a dhe 48b, Post-Aktakuza Regjistratori IV-A.

⁷² Transkripti i SMS mes M.Sh. dhe F.L.t, të datës 10 maj 2008: Përmbledhja e të dhënave të përgjimeve 49a dhe 49b, Regjistratori IV-A.

⁷³ Transkripti i SMS mes M. Sh. dhe F.L.t, të datës 12 maj 2008: Përmbledhja e të dhënave të përgjimeve 50a dhe 50b, Post-aktakuza IV-A.

⁷⁴ Procesverbali, 19 korrik 2016, f. 5-6.

⁷⁵ Procesverbali, 19 korrik 2016, f. 14.

kishte pajisje (kamionë) që i nevojiteshin kompanisë P. I.⁷⁶. Sipas dëshmitarit, ndërkohë që M.Sh. ishte forca lëvizëse pas ofertimit për këtë tender, ishte kompania P.I. që do të kryente punët⁷⁷, dhe Z. Q. kishte bërë analiza të nevojshme, llogaritjen e çmimeve dhe ka përpiluar dokumentacionin e ofertës⁷⁸. Z.Q. mohoi se M. Sh. ishte një ekspert i kualifikuar në ndërtimin e rrugëve; dëshmitari e përshkroi M .Sh. si një shofer dhe shprehu *"dyshime se ai kishte përfunduar arsimin e mesëm"*.⁷⁹

Dëshmitari konfirmoi se ai kishte diskutuar perspektivën e përpjekjes së tyre për të qenë të suksesshëm dhe shpjegoi se zoti M.Sh. *"gjithnjë kishte thënë se kishte njerëz që ai i njihje në qeveri"*.⁸⁰ Prokurori nuk ka pyetur dhe dëshmitari nuk ka thënë vullnetarisht, se kënd M. Sh. kishte thënë se e njihje në qeveri. Z. Q. mohoi se M. Sh. i kishte folur ndonjëherë për komunikimet e këtij të fundit me F.L. më 10 dhe 12 maj 2008.⁸¹ Dëshmitari deklaroi se, sipas tij, B. Sh. nuk ishte përfshirë në këtë ofertë.⁸²

Z. Q. mohoi të ketë diskutuar me M. Sh. për kompanitë e tjera të cilat kanë ofertuar për projektin.⁸³ Ai shtoi: *"deri në pikën kur kanë hapur ofertat, ne nuk e dinim se kush ka dorëzuar ofertat e tenderit për kontratën"*.⁸⁴ Megjithatë, dëshmitari e pranoi deklaratën e tij të mëparshme në EULEX, ku ai ka deklaruar se pas dorëzimit të ofertës:⁸⁵

"Unë e di se M.Sh. më ka thënë se janë tri kompani që janë duke dhënë çmime më të ulëta se ne, por siç më ka thënë ai nuk po kërkojnë çmimin më të lirë, por për çmimin më të favorshëm ekonomik, ai shpreson të marrë punën."

Ai shpjegoi se *"në vitin 2012 kujtesa e tij ishte shumë më e freskuar sepse tani shumë gjëra mund të jenë harruar"*.⁸⁶

- f. **B. Sh.**, djali i M.Sh.dhe pronar i I.-E. që nga vdekja e këtij të fundit, dëshmoi se ai ka punuar në kompani që nga viti 1993 duke menaxhuar një pompë benzine dhe dy salla dasmash dhe që merret me dru në dimër.⁸⁷ Dëshmitari konfirmoi që kompania I.-E. ka ofertuar për tender qeveritarë, duke përfshirë furnizimin me dru për shkolla dhe ndërtimin e rrugëve, por deklaroi se ai nuk

⁷⁶ Procesverbali, 19 korrik 2016, f. 13-16.

⁷⁷ Procesverbali, 19 korrik 2016, f. 14-15, 17; Z.M.Sh.mori dosjen e tenderit dhe dorëzoi ofertën: Procesverbali 20 korrik 2016, f. 6-7.

⁷⁸ Procesverbali, 20 korrik 2016, f. 7.

⁷⁹ Procesverbali, 19 korrik 2016, f. 16-17.

⁸⁰ Procesverbali, 20 korrik 2016, f. 7, 14.

⁸¹ Procesverbali, 20 korrik 2016, f. 12-13.

⁸² Procesverbali, 20 korrik 2016, f. 13.

⁸³ Procesverbali, 20 korrik 2016, f. 7, 10.

⁸⁴ Procesverbali, 20 korrik 2016, f. 10.

⁸⁵ Procesverbali, 20 korrik 2016, f. 11, duke iu referuar deklaratës së dëshmitarit të 17 korrikut 2012, Regjistratori 19B, f. 452.

⁸⁶ Procesverbali, 20 korrik 2016, f. 11.

⁸⁷ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 10-11; 26 tetor 2016, f. 5-6.

ka marrë pjesë në përgatitjen e këtyre ofertave,⁸⁸ duke përfshirë ofertën për rrugën Ponesh-Zhegovc.⁸⁹ B.Sh. ka marrë vesh për ankesën e babait të tij në AKK nga një transmetim televiziv pas vdekjes së z. M. Sh.⁹⁰

Dëshmitari dëshmoi se ai nuk e ka njohur F.L. personalisht dhe nuk e dinte nëse babai i tij e ka njohur F.L..⁹¹ Ai ka mohuar pretendimin e babait të tij, siç u paraqit në Informacionin e AKK-së, se *'unë [M.Sh.] kam qenë rrugës, duke udhëtuar, në momentin kur jam ftuar në takimin e organizuar nga Z.P për ne me F.L. ... por kam telefonuar djalin tim B.Sh. dhe i kam thënë atij se ai duhet të shkojë dhe të takohet me ministrin F.L., pasi që djali im gjithashtu e njihet mirë ministrin F.L. '*⁹²

Dëshmitari nuk mund të rikujtonte marrjen e një dosjeje të tenderit në MTPT për babain e tij.⁹³ Megjithatë, ai e pranoi si të vërtetë deklaratën e tij në EULEX, ku ai ka deklaruar:⁹⁴

"Më besoni se kurrë nuk e kam hapur atë, por kam disa gjëra personale për të bërë në Prishtinë, pasi që kam qenë atje për të kryer ekzaminimin mjekësor për vajzën time sepse ajo nuk ndihej shumë mirë dhe babai im më pyeti nëse mund të shkoj dhe të marr dosjen e tenderit për rrugën Ponesh-Zhegovc, nuk mbaj mend shumë mirë, por kam folur në telefon me babanë tim."

Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, dëshmitari konfirmoi se ai nënkuptonte se ai ishte atje për të marrë dosjen e tenderit për tenderin Ponesh-Zhegovc (dmth. jo të paraqiste ofertën).⁹⁵ B.Sh. rikujtoi se derisa ishte në MTPT, ai u takua me F.L. në korridor dhe i ka dhënë F.L. telefonin e tij në mënyrë që të fliste me babanë e tij.⁹⁶ Ky takim ka qenë i rastësishëm, pasi ai nuk kishte pasur kontakte të mëparshme me F.L.⁹⁷ Babai i tij kurrë nuk i tha atij se për çfarë kishin biseduar.⁹⁸

Dëshmitari nuk mundi të mbante mend dërgimin e një SMS tek babai i tij duke thënë se ai kishte folur me ministrin dhe do të shkonte për të parë se çfarë kishte ministri për të thënë.⁹⁹ Prokurori i ka paraqitur dëshmitarit SMS të përgjuar të datës 19 maj 2008 nga vetë babai i tij (*"Unë fola me ministrin, ai më thirri kështu që unë do të shkoj dhe të shoh se çfarë do të thotë"*). B. Sh. deklaroi: *"Nuk di asgjë. Unë nuk kam folur asgjë në lidhje me ministrin. Nuk*

⁸⁸ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 11-13.

⁸⁹ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 19.

⁹⁰ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 13.

⁹¹ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 13-14, 16.

⁹² Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 14, 16.

⁹³ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 17.

⁹⁴ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 18-19, duke iu referuar Regjistrorit 19A, fashikull 2, f. 28 e tutje; 26 tetor 2016, f. 5.

⁹⁵ Procesverbali, 26 Tetor 2016, f. 3-4.

⁹⁶ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 19.

⁹⁷ Procesverbali, 26 tetor 2016, f. 4-5.

⁹⁸ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 19.

⁹⁹ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 16-17.

më kujtohet asgjë."¹⁰⁰ Më vonë, dëshmitari dëshmoi se ai ka kërkuar ndihmën e Ministrisë së Shëndetësisë për sëmundjen e vajzës së tij dhe një herë ai u takua me Ministrin e Shëndetësisë në atë ministri.¹⁰¹ Ai nuk mund të kujtojë SMS-të specifike, por supozonte se ishte për vajzën e tij dhe jo për F.L.¹⁰²

g. **Q.M.** ka qenë kryetar i Gjilanit dhe Zëvendëskryetar i Partisë Demokratike të Kosovës ("PDK") (dega e Gjilanit) nga fillimi i vitit 2008 deri në fund të vitit 2013¹⁰³ dhe e ka njohur M.Sh. që nga viti 1990.¹⁰⁴ Q.M. deklaroi se M. Sh. kurrë nuk i ka thënë atij, ose nuk e mban mend .M.Sh. duke i thënë atij, se F.L. i premtoi atij rrugën Ponesh-Zhegovc, por më vonë në vend të saj ia ka dhënë kompanisë *T*, me sqarimin se kompania *I.E* nuk i plotësonte kërkesat.¹⁰⁵

h. **A. G.** i cili përveç mbajtjes së një numri të posteve në PDK ka qenë Zëvendësministri i MTPT-së në 2008-2009,¹⁰⁶ dëshmoi se ai nuk kishte asnjë rol në dhënien e tenderëve¹⁰⁷ për ndërtimin e rrugëve dhe nuk e njeh dhe nuk e ka takuar kurrë M.Sh.¹⁰⁸

125. Trupi gjykues konsideroi se prokurori nuk ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L. i ka premtuar tenderin për ndërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc M. Sh., për arsyet e mëposhtme. Llogaria e M.Sh. e premtimit të F.L. për dhënien e tenderit - që pretendohet se e ka bërë gjatë një takimi mes F.L. dhe B. Sh. në MTPT - nuk u vërtetua nga djali i tij, B. Sh. B.Sh.i riu, i vetmi person në gjendje të japë konfirmimin e dorës së parë për këto akuza, në fillim kundërshtoi pohimin e babait të tij se e njihje mirë F.L. duke thënë se ai kurrë nuk e kishte takuar atë personalisht. Në të vërtetë, Trupi gjykues konsideron se llogaria e B. Sh. është e besueshme: është e paqartë se pse ndihma e Z. P. për të organizuar një takim mes M.Sh.dhe F.L. do të ishte e nevojshme nëse të dy B.Sh dhe M.Sh. vërtet e njihnin F.L. ashtu siç është pohuar nga M. Sh.

126. Së dyti, të dyja ndryshojnë në atë që ndodhi në ditën në fjalë. B.Sh.mohoi që babai i tij e dërgoi atë për të takuar F.L sepse vetë M.Sh. ishte në rrugë në kohën kur erdhi thirrja për t'u takuar. Në vend të kësaj, sipas B.Sh., babai i tij e dërgoi atë për të marrë dosjen e tenderit për rrugën Ponesh-Zhegovc sepse ai ishte në qytet gjithsesi për punë të tjera është takuar me F.L në korridor rastësisht. Në të dyja rastet, M.Sh. ka biseduar me F.L. përmes telefonit të B.Sh. M.Sh.i ka thënë AKK-së se, pas një bisede mes djalit të tij dhe F.L. para thirrjes telefonike, F.L. i ka premtuar atij (M.Sh.) tenderin. B. Sh., megjithatë, nuk ka folur për ndonjë negociim të tillë më parë dhe tha se nuk kishte dëgjuar atë që thuhej në mes të dy të tjerëve gjatë telefonatës.

¹⁰⁰ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 17.

¹⁰¹ Procesverbali, 26 tetor 2016, f. 6.

¹⁰² Procesverbali, 26 tetor 2016, f. 7.

¹⁰³ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 10; 19 prill 2016, f. 5.

¹⁰⁴ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 22; 19 prill 2016, f. 8; 20 prill 2016, f. 10.

¹⁰⁵ Procesverbal, 20 prill 2016, f. 11-12.

¹⁰⁶ Procesverbali, 14 mars 2017, f. 13, 15, 18-19, 32.

¹⁰⁷ Procesverbali, 14 mars 2017, f. 24.

¹⁰⁸ Procesverbali, 15 mars 2017, f. 13-15, 17.

127. Së treti, koha e këtij premtimi të supozuar të bërë nga F.L. tek .M. Sh. mbetet e paqartë. M. Sh. i përshkroi AKK-së tri takime të ndara me F.L. i pari, gjatë të cilës premtimi thuhet se është bërë, ndodhi ose në vitin 2007 ose një muaj përpara shpalljes së tenderit. I dyti, sipas M.Sh., u mbajt në Gjilan në prani të Q. M. (dëshmia e të cilit nuk ofroi mbështetje për ekzistencën e një takimi të tillë). Takimi i tretë thuhet se ka ndodhur në MTPT, në praninë e A. G., N. K.t dhe një këshilltari tjetër, më shumë se një muaj përpara se fituesi të ishte shpallur publikisht.
128. Për sa më sipër, trupi gjykues konsideroi se premtimi i zotit F.L. për tenderin u pretendua se ishte bërë më së voni një muaj para se njoftimi për kontratë për Ponesh-Zhegovin të ishte lëshuar më 23 mars 2008. B.Sh. dëshmoi se ai ishte dërguar nga babai i tij në MTPT për të marrë dosjen e tenderit. Ndërkohë që afati i dy llogarive është brenda katër ose pesë javëve nga njëri-tjetri, pretendimi i B. Sh. zvogëlohet nga 'Procesverbali i dosjes së tenderit të pranuar MTPT/08/049/511', që tregon se sipas të gjitha gjasave ka qenë M. Sh. vetë dhe jo B. Sh., i cili ka marrë dosjen e tenderit më 27 mars 2008.¹⁰⁹
129. Më tej, SMS të përgjuar nga B.Sh. për M.Sh. se ministri "më thirri kështu që unë do të shkoj dhe të shoh se çfarë do të thotë" (i paraqitur dëshmitarit në mbështetje të këtij pretendimi) u dërgua më 19 maj 2008. Kjo është një muaj pasi ofertat e kompanive u hapën, një javë para se kompania T. të shpallet fitues dhe, me të vërtetë, javë pas takimit të tretë të z.M.Sh.me F.L. (në të cilin B.Sh. nuk u pretendua të ketë luajtur ndonjë rol). Prandaj, dëshmia e B. Sh. nuk siguroi asnjë vërtetim të rrethanave, përmbajtjes apo kohës së takimit në fjalë.
130. Së katërti, trupi gjykues nuk ka konsideruar se dëshmia e Z. Q. se .M. Sh.kishte shprehur besim në fitimin e tenderit sepse "*ai kishte njerëz të qeverisë që i njihin*" tregoi qartë se .M. Sh.i tha atij se F.L. kishte premtuar atë tender për Ponesh-Zhegovc. Në mënyrë të ngjashme, Q.M. mohoi se z.M.Sh.i ka thënë atij se F.L. i kishte premtuar atij rrugën Ponesh-Zhegovc. Trupi gjykues theksoi se edhe nëse të dy e kishin treguar M.Sh. duke u thënë atyre një premtim të tillë, vetë dyshimi do të mbetet i paprovuar nga pyetja e kompania B.t të tij origjinal (M. Sh.) dhe nuk mund të ofrojë bazë për gjatjen e F.L. fajtor, sipas nenit 262 (1) të KPP-së.¹¹⁰
131. M.Sh.i tha AKK-së për një takim të tretë mes atij dhe F.L. i cili u zhvillua në MTPT në prani të N.K., A.G. dhe një këshilltari. Prokurori pohoi se në këtë takim "*F.L. ka dhënë udhëzime për M. Sh. rreth asaj se çfarë duhet të bëjë për të fituar këtë tender*". Më tej, sipas prokurorit, ky takim dhe SMS-të që i paraprijnë atij "*[vërtetojnë] përfshirjen e F.L.t në dhënien e këtij tenderi.*" Të dy këto pretendime janë konsideruar nga trupi gjykues.
132. Ndërsa kompanitë dorëzuan ofertat e tyre më 17 prill dhe kompania T. u shpall fitues i tenderit më 26 maj, afati kohor i .M.Sh. vendosi këtë takim në gjysmën e dytë të muajit prill ose fillim të majit. SMS-të e përgjuara tregojnë se z. M.Sh. bëri përpjekje

¹⁰⁹ Regjistratori 48B, f. 139.

¹¹⁰ Për këtë pikë, shih diskutimin e mëparshëm në Pjesën IV.B.

- të pasuksesshme për të takuar F.L. më 6 maj dhe 10 maj. Një SMS nga .M.Sh.më 12 maj (22:29), megjithatë, me të vërtetë i referohet një takimi mes të dyve në atë ditë. Për leximin e këtij SMS nga trupi gjykues, M.Sh. është i pakënaqur me një propozim ose sugjerim të F.L. për kompaninë *I. E.* për të punuar (ose të bëjë përpjekje për të punuar) për kompani të tjera, sepse në një marrëveshje të tillë kompania *I. E.* nuk do të merrte referenca që do të mundësonin që ajo të shpërblehet në mënyrë të drejtpërdrejtë në të ardhmen. Prandaj, ai shpreson të fitojë tenderin.
133. Ky SMS është në përputhje me deklaratën e .M.Sh. në AKK se F.L. i tha atij se ai nuk i plotësonte kushtet për të fituar këtë tender, por që ai mund të nënkontraktohej nga nga kompania *T.* Në anën tjetër, A.G., i cili thuhet se ka qenë i pranishëm për këtë mbledhje, mohoi të ketë takuar ndonjëherë .M.Sh. dhe që ka ndodhur kështu ndonjëherë.
134. Sidoqoftë, trupi gjykues nuk e konsideroi se, edhe nëse pranohet, ky takim vërtetoi ekzistencën e një premtimi të mëparshëm nga F.L. (takimi i pretenduar), pasi SMS nuk bën referencë për një premtimin të mëparshëm, por vetëm "shpresën" e autorit që mund t'i jepet atij. Prandaj, trupi gjykues refuzoi si të pabazuar parashtresën e prokurorit se *"edhe M.SH.iu premtua tenderi nga F.L., pasi që M.Sh.i ka dërguar mesazh SMS F.L.t për shpresën e tij 'se ju [F.L.] na jepni [tenderin] direkt në emrin tonë"*.¹¹¹
135. Trupi gjykues gjithashtu nuk ishte i bindur se SMS-ja demonstroi përfshirjen e F.L. në dhënien e tenderit. Ndërsa kontaktet mes z. F.L.dhe .M.Sh.në këtë kohë ishin të pahijshme, SMS nuk sugjeron që F.L. bëri asgjë më shumë sesa shpjegojë kërkesat ligjore që do të zbatoheshin. Më tej, trupi gjykues nuk e pranoi që F.L. *"i ka dhënë udhëzime M.SH.se çfarë duhet të bëjë për të fituar tenderin"*. Përkundrazi, SMS duket të tregojë se F.L. i ka thënë M.Sh, se ai nuk do të fitonte pasi oferta e tij nuk u kualifikua pasi që i mungonin referencat e duhura. Së fundi, nuk është e qartë me sa duket nga SMS-të se F.L. i ka thënë M.Sh. se *T. kompania* do të nënkontraktonte ekzekutimin e punës se kompanisë *I-E.* Vetë SMS nuk e thotë këtë, dhe një pohim i tillë është dëmtuar nga fakti se *T. kompania* nuk e bëri këtë dhe nga dëshmia e Z.Q. se kompania *I. E.* nuk do të kishte kapacitetin për të ekzekutuar projektin.
136. Prandaj, trupi gjykues konsideron se prokurori nuk ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se z.F.L. ia premtoi tenderin për ndërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc (08-049-511) M. Sh.; se ai i ka thënë M.Sh. çfarë të bënte për të fituar tenderin; ose se ai ishte i përfshirë në dhënien e saj. Prandaj, elementi material i veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare nuk u vërtetua.
137. Për më tepër, trupi gjykues rikujtoi se prokurori ishte i obliguar, sipas nenit 422 të KPK-së, të tregonte se F.L. kishte për qëllim të merrte një 'përfitim material' për vete ose për një person tjetër; shkaktojë dëme një personi tjetër; ose shkel seriozisht të drejtat e një personi tjetër. Trupi gjykues konstatoi se prokurori nuk ka pohuar - as nuk ka udhëheqë dëshmi të mjaftueshme në mbështetje të - fakteve që mund të kenë

¹¹¹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 38, paragrafi 61.

krijuar këtë element mendor në lidhje me tenderin 08-049-511. Ky element i veprës nuk është i domosdoshëm dhe vetëm mungesa e tij ka qenë fatale ndaj akuzës.

138. Për këto arsye, trupi gjykues konkludoi se prokurori nuk ka dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L. ka keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij zyrtar si Ministër i MTPT-së në shpalljen e tenderit 08-049-511 për ndërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc.

A ka qenë nënshkrimi i kontratës nga N.K.me kompaninë T. e pajustificuar?

139. Prokurori parashtroi se ka pasur disa shkelje në procesin e prokurimit për tenderin 08-049-511. Së pari, projekti ishte një rrugë lokale e cila sipas legjislacionit përkatës duhej të ishte financuar dhe drejtuar nën kujdesin e Komunës së Gjilanit, në vend të MTPT-së.¹¹² Në vend të kësaj, një marrëveshje bashkëfinancimi ndërmjet MTPT-së dhe Kuvendit Komunal të Gjilanit e zhvendosi këtë përgjegjësi në MTPT. Prokurori nuk pushon së bëri ndonjë pretendim të qartë për këtë çështje, duke vënë në dukje vetëm se "[arsyetimi dhe dyshimi i nevojshëm përse MTPT-ja pësoi një marrëveshje bashkëfinancimi ... mbetet pa shpjegime të duhura, kur vlerëson dosjet e tenderit".¹¹³
140. Së dyti, afati ligjor për dorëzimin e ofertave është shkurtuar nga 40 në 23 ditë kalendarike në një mënyrë që është "e paligjshme dhe [tregon] një interes për të kufizuar konkurrencën vetëm për operatorët ekonomikë të përgatitur mirë".¹¹⁴ Së treti, prokurori identifikon mangësitë dhe paqartësitë në vlerësimet e ofertave individuale, siç mund të sugjerojnë që "kërkesat e dosjes dhe/ose peshimi i kriterëve qëllimisht të çojnë në kompaninë T. si rezultat i favorizuar".¹¹⁵ Së fundi, ekzistonte një marrëveshje për caktimin e çmimeve nga kompanitë ofertuese T. (në pronësi të F. Z.) dhe Z. C. Kompanie (në pronësi të vëllait të tij N. Z.).¹¹⁶
141. Sipas prokurorit, z. Krasniqi, si shef i prokurimit në MTPT dhe nënshkrues i kontratës me kompaninë T., ka abuzuar me pozitën e tij/saj zyrtare duke nënshkruar kontratën me kompaninë T., kur shkeljet e ligjit të prokurimit publik të lartpërmendura e bënë këtë të pajustificuar,¹¹⁷ dhe në këtë mënyrë favorizoi qëllimisht kompaninë T.¹¹⁸ Përgjegjësia për dhënien e paligjshme të kontratës i atribuohet nga prokurori edhe F.L.¹¹⁹ Prokurori pretendon se F.L. "mban përgjegjësi penale për mungesën e mbikëqyrjes së duhur në projekt".¹²⁰
142. Trupi gjykues konsideroi se sjellja e pretenduar e F.L. (dështimi për të ushtruar mbikëqyrje të duhur mbi këtë projekt) nuk mund të përbëjë elementin material të

¹¹² Aktakuza e Konsoliduar, f. 29, paragrafi 43; faqe 33, paragrafi 53.

¹¹³ Aktakuza e Konsoliduar, f. 29, paragrafi 43.

¹¹⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f. 31, paragrafi 51.

¹¹⁵ Aktakuza e konsoliduar, f. 32-33, paragrafi 51.

¹¹⁶ Aktakuza e Konsoliduar, f. 31-32, paragrafët 49, 51.

¹¹⁷ Aktakuza e konsoliduar, faqe 8; faqe 31, paragrafi 51.

¹¹⁸ Aktakuza e Konsoliduar, f. 33, paragrafët 53-54.

¹¹⁹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 33, paragrafi 53.

¹²⁰ Aktakuza e Konsoliduar, f. 33, paragrafi 54.

veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare/autoritetit. Trupi gjykues pranoi se F.L. mund të keqpërdorte pozitën e tij politike me ndikim si Ministri i MTPT-së, nëse ai do të ndërhynte padrejtësisht në procesin e prokurimit. Në këtë dritë janë shqyrtuar procedurat e tjera të kontestuar të tenderit. Sidoqoftë, trupi gjykues nuk e pranoi se F.L. kishte ndonjë rol formal në procesin e prokurimit dhe kështu ai kishte ndonjë detyrë mbikëqyrëse në lidhje me procedurat specifike të prokurimit.¹²¹ Për këtë arsye, trupi gjykues ka konstatuar se prokurori nuk ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L. ka keqpërdorur me pozitën zyrtare të tij/saj në lidhje me tenderin 08-049-511, Ndërtimi i rrugës Ponesh-Zhegovc në Gjilan.

143. Sa i përket përgjegjësisë së N. K., trupi gjykues bëri këto vërejtje paraprake. Trupi gjykues nuk e ka konsideruar të domosdoshme që prokurori të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm shkeljet e supozuara themelore ose parregullsitë në procesin e prokurimit (megjithëse ka gjetur se prokurori nuk ka arritur të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se ekziston një marrëveshje për caktimin e çmimeve të kompanive T. dhe Z. C. në lidhje me akuzat kundër F.Z.¹²²). Përkundrazi, ishte detyrë e prokurorit të tregonte ose i. sjellje të pahijshme nga ana e N.K. (d.m.th. se çdo shkelje i atribuohet atij), ose ii. se N.K. ishte i vetëdijshëm për shkeljet e mundshme siç do të kishte shkaktuar përgjegjësinë e tij për të ndaluar procesin dhe për të nxjerrë hetime të mëtejshme përpara se të nënshkruante ndonjë kontratë me kompaninë fituese.
144. Trupi gjykues shqyrtoi shkresat e lëndës për dëshmi relevante për keqpërdorim të pozitës zyrtare/autorizimeve nga N.K. me nënshkrimin e kontratës me kompaninë T. në emër të MTPT-së dhe theksoi mes tyre në vijim:
- a. **B. R.**, Zyrtar i Prokurimit në MTPT në kohën përkatëse,¹²³ i cili i ka raportuar N.K.¹²⁴ dhe ka shërbyer në komisionet e vlerësimit për tenderët për ndërtimin e rrugëve,¹²⁵ ka dhënë një pasqyrë të përgjithshme të procesit të tenderit. Me rëndësi për pyetjen në fjalë, ai deklaroi se ofertat për tenderët për ndërtimin e rrugëve janë vlerësuar nga një komision¹²⁶ i përbërë nga dy anëtarë dhe një kryetar¹²⁷ dhe i emëruar me vendim të Sekretarit të Përhershëm të MTPT-së, me rekomandim të Drejtorit të Prokurimit.¹²⁸ Detyra e komisionit ishte që të vlerësojë ofertat në lidhje me kriteret e paracaktuara dhe të rekomandojë një fitues. Raporti i tij do të shqyrtohej dhe rekomandimet e aprovuara nga Drejtori i Prokurimit, pas së cilës do të publikohet një njoftim për dhënien e

¹²¹ Shih 'Raporti i ekspertit lidhur me procedurat e dhënies së kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16 dhe dëshmitë e B. R., V. K., A. G.

¹²² Kjo është shqyrtuar në detaje në Pika 5 e aktakuzës, Pjesa V.D.i.

¹²³ Procesverbali, 11 dhjetor 2015, f. 8; 6 janar 2016, f. 10.

¹²⁴ Procesverbali, 11 dhjetor 2015, f. 10, 15.

¹²⁵ Procesverbali, 11 dhjetor 2015, f. 9-10; 6 janar 2016, f. 10.

¹²⁶ Procesverbali, 11 dhjetor 2015, f. 14.

¹²⁷ Procesverbali, 6 janar 2016, f. 15.

¹²⁸ Procesverbali, 11 janar 2016, f. 24-25; 13 janar 2016, f. 10.

kontratës që shpall fituesin dhe - zakonisht pas skadimit të afatit për ankesa dhe ankimime - Drejtori i Prokurimit do të nënshkruante kontratën me fituesin.¹²⁹

B.R. dëshmoi se anëtarët e komisionit të vlerësimit nënshkruan një betim të pavarësisë në kryerjen e detyrave të tyre para fillimit të vlerësimit.¹³⁰ Nëse, gjatë punës së tij, komisioni ka vërejtur ndonjë parregullsi në ofertat e tenderit, kjo do të përfshihet në raportin e saj të vlerësimit.¹³¹ Çdo shkelje penale do t'i raportohet Ministrisë së Punëve të Brendshme nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të MTPT-së.¹³²

- b. **V. K.** ishte, në kohën përkatëse, një zyrtare e lartë ligjore e prokurimit në MTPT, e cila i ka raportuar N.K. dhe ka shërbyer në komisionet e vlerësimit për tenderët për ndërtimin e rrugëve.¹³³ V.K. dëshmoi se shefi i prokurimit do të rekomandonte se kush duhet të emërohet në komisionet e vlerësimit dhe kjo do të ndikohej nga vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm.¹³⁴ Komisioni do të vlerësojë ofertat e tenderit në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MTPT,¹³⁵ dhe do të lëshojë një raport që përmban rekomandimet e tij.¹³⁶ Në përvojën e dëshmitares, vlerësimi u krye në mënyrë të pavarur dhe Shefi i Prokurimit asnjëherë nuk ka ndërhyrë për të ndikuar në komision në favor të ndonjë operatori ekonomik.¹³⁷

Dëshmitarja e mohoi që është konsultuar ndonjëherë me N.K. në vlerësimin e ofertave dhe deklaroi se betimi i nënshkruar nga anëtarët e komisionit i ka penguar ata të konsultoheshin me ndonjë person që nuk është anëtar i komisionit.¹³⁸ Trupi gjyqës vuri në dukje se kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë kundërshtoi deklaratën e saj të mëparshme dhënë Prokurorit të PSRK-së, ku ajo pohoi se komisioni do të konsultohet me N.K. nëse ata nuk ishin të sigurt për ndonjë dokument:

“sepse donte të informohej për gjithçka. Ai ishte mbikëqyrës. Pra, ne ishim komision rekomandues, por nuk ishim komisioni vendimmarrës. Ai kishte autoritetin për kontrata, ose autoritetin kontraktues. Pra, ai ishte përgjegjës për gjithçka, prandaj obligimi ynë ishte të konsultoheshim me të.”¹³⁹

¹²⁹ Procesverbali, 11 dhjetor 2015, f. 16, 17, 20-22; 6 janar 2016, f. 15, 17; 11 janar 2016, f. 25; 13 janar 2016, f. 6-7, 11.

¹³⁰ Procesverbali, 6 janar 2016, f. 15.

¹³¹ Procesverbali, 13 janar 2016, f. 8-9.

¹³² Procesverbali, 13 janar 2016, f. 8-11.

¹³³ Procesverbal, 8 mars 2016, f. 4-7, 22-23.

¹³⁴ Procesverbali, 8 mars 2016, f. 5-6.

¹³⁵ Procesverbali, 8 mars 2016, f. 7.

¹³⁶ Procesverbali, 8 mars 2016, f. 25.

¹³⁷ Procesverbal, 8 mars 2016, f. 25, 29.

¹³⁸ Procesverbal, 8 mars 2016, f. 10, 12.

¹³⁹ Procesverbali i seancës së dëshmitarit – V. K., 24 gusht 2011, Regjistratori 19B, f. 41-42.

Në marrjen në pyetje të tërthortë, V.K. shpjegoi se "*Komisioni bën punën e tij në mënyrë të pavarur dhe me ligjin për prokurimin në jemi të detyruar të raportojmë tek menaxheri i prokurimit sepse ai është autoriteti kontraktues për punën tonë*".¹⁴⁰

Më tej, edhe pse V.K. mohoi se N.K. ka kërkuar ndonjëherë ndonjë dokument, duke sugjeruar se ai nuk kishte nevojë ta bënte këtë pasi që ato mbaheshin në zyrën e tyre të përbashkët,¹⁴¹ ajo gjithashtu pohoi se ajo nuk mund të kujtohej nëse N.K. kishte qasje në të gjithë dosjen e rastit.¹⁴² Kjo përsëri e kundërshtoi deklaratën e saj të mëhershme të dëshmitarit, në të cilën ajo konfirmoi se "*natyrisht*" N.K. kishte qasje në të gjithë dosjen e lëndës "*nëse donte të kishte qasje*", duke shtuar se "*ai do të pyeste, 'a mund të më japësh dosjen e lëndës për këtë tender për ndërtimin e rrugës' dhe ju do t'ia jepni atij*".¹⁴³ Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, dëshmitarja deklaroi se N.K. nuk ka kërkuar qasje të tillë sa i përket procedurave të tenderit që janë subjekt i kësaj aktakuze.¹⁴⁴

- c. **Raporti i komisionit të vlerësimit të ofertave**¹⁴⁵ së pari rendit vlerën e ofertave të dorëzuara nga shtatë kompani ofertuese.¹⁴⁶ Kjo pasohet nga një ekzaminim paraprak' në formën e një tabele në të cilën komisioni vlerësues tregon (me 'po'/'jo') nëse kompanitë ofertuese përmbushin kërkesa të ndryshme për t'u konsideruar të përgjegjshëm.¹⁴⁷ Në bazë të këtij vlerësimi, komisioni vlerësues pastaj vazhdon me arsye të shkurtra për të përjashtuar ofertat të cilat janë përcaktuar të jenë të papërgjegjshme,¹⁴⁸ si dhe të ofrojë një përmbledhje të ofertave të mbetura dhe ofertave të tyre.¹⁴⁹ Së fundi, raporti, përsëri në formë tabelore, paraqet 'vlerësimin më të favorshëm ekonomikisht' të komisionit ku pikat jepen për secilën ofertë në kritere të ndryshme 'të buta'.¹⁵⁰ Asnjë shpjegim me shkrim nuk ofrohet për pikët e dhëna. Ajo përfundon duke

¹⁴⁰ Procesverbali, 8 mars 2016, f. 24.

¹⁴¹ Procesverbali, 8 mars 2016, f. 13.

¹⁴² Procesverbali, 8 mars 2016, f. 14.

¹⁴³ Procesverbali i seancës së dëshmitarit – V. K., 24 gusht 2011, Regjistratori 19B, f. 42.

¹⁴⁴ Procesverbal, 8 mars 2016, f. 23-24.

¹⁴⁵ Raporti i Vlerësimit të Tenderit dhe Rekomandimi për Kontratën e Shitjes: 'Rikonstruksioni i rrugës lokale Ponesh-Zhegovc' (MTPT 08/049/511, maj 2008, Regjistratori 48B, f. 163-177.

¹⁴⁶ Raporti i Vlerësimit të Tenderit dhe Rekomandimi për Kontratën e Shitjes: 'Rikonstruksioni i rrugës lokale Ponesh-Zhegovc' (MTPT 08/049/511, maj 2008, Regjistratori 48B, f.165.

¹⁴⁷ Raporti i Vlerësimit të Tenderit dhe Rekomandimi për Kontratën e Shitjes: 'Rikonstruksioni i rrugës lokale Ponesh-Zhegovc' (MTPT 08/049/511, maj 2008, Regjistratori 48B, f. 166-172.

¹⁴⁸ Raporti i Vlerësimit të Tenderit dhe Rekomandimi për Kontratën e Shitjes: 'Rindërtimi i rrugës lokale Ponesh-Zhegovc' (MTPT 08/049/511, maj 2008, Regjistratori 48B, f. 173-174.

¹⁴⁹ Raporti i Vlerësimit të Tenderit dhe Rekomandimi për Kontratën e Shitjes: 'Rikonstruksioni i rrugës lokale Ponesh-Zhegovc' (MTPT 08/049/511, maj 2008, Regjistratori 48B, f. 175.

¹⁵⁰ Raporti i Vlerësimit të Tenderit dhe Rekomandimi për Kontratën e Shitjes: 'Rindërtimi i rrugës lokale Ponesh-Zhegovc' (MTPT 08/049/511, maj 2008, Regjistratori 48B, f. 176-177.

siguruar një rezultat final nga 100, me kompaninë T. të renditur si fitues me një rezultat prej 88.6.¹⁵¹

- d. Në **'Raportin e ekspertit lidhur me procedurën e dhënies së kontratës'**¹⁵², eksperti ndërkombëtar i prokurimit K. G. bëri këto vërejtje relevante për marrëveshjen e bashkëfinancimit nga MTPT-Gjilan:

"Meqenëse rruga Ponesh-Zhegovc është lokale, kompetenca për mirëmbajtjen dhe kontratat e saj është me komunat ... Nuk është e qartë pse, nëse jo për shkak të kufizimit, Ministria (MTPT) ka marrë përsipër".¹⁵³ Prandaj, sipas K.G: "duhet shpjeguar pse ka pasur arsye për ndryshimin e kompetencave në MTPT në marrëveshjen e sipërpërmendur të bashkëfinancimit, duke qenë se lënda ishte një Rrugë Lokale ..."¹⁵⁴

Sa i përket shkurtimeve të afatit për pranimin e ofertave, K. G. vuri në dukje: *"Nëse nuk ka pasur njoftim paraprak sipas nenit 43 të Ligjit për PP që lejon shkurtimeve të afatit kohor deri në 24 ditë kalendarike do të ishte e paligjshme dhe do të tregonte interes për të kufizuar konkurrencën vetëm për operatorët ekonomikë të përgatitur mirë".¹⁵⁵*

K.G bëri vërejtjen e përgjithshme se: *"Kur dallimet e tenderëve pritet të jenë të vogla, një autoritet kontraktues mund të ndikojë në konkurrencë ose duke përshtatur kushtet e dosjes së tenderit në një ndërmarrje të njohur ose peshëojë (sic) pikat për rezultatin e favorizuar ose të dyja këto (sic)."¹⁵⁶*

Për më tepër, K.G. vazhdoi të krijojë një lidhje midis marrëveshjes së bashkëfinancimit, përshtatjes së kushteve dhe shkurtimeve të afateve, si më poshtë:

"Mund të supozohet se MTPT ka pasur për qëllim të drejtojë procedurën e prokurimit, përndryshe me sa duket nuk do të kishte qenë marrëveshja e bashkëfinancimit me Komunën. Nëse po, një gjë mund të jetë e drejtë duke menduar se MTPT-ja ishte njohur me ndërmarrjet konkurruese dhe aftësitë e tyre paraprakisht. Sa i përket eksperiencës së ofertuesve ishte e lidhur me 'vlerën 1/2 të ofertës', duhet të keni parasysh se MTPT me sa duket i dinte ndërmarrjet dhe gjendjen e tyre ekonomike duke përfshirë kontratat e dhëna më herët dhe vlerat e tyre. Nëse po, MTPT mund të përshtatë kërkesat e dosjes

¹⁵¹ Raporti i Vlerësimit të Tenderit dhe Rekomandimi për Kontratën e Shitjes: 'Rindërtimi i rrugës lokale Ponesh-Zhegovc' (MTPT 08/049/511, maj 2008, Regjistratori 48B, fq. 177.

¹⁵² Raporti i Vlerësimit të Tenderit dhe Rekomandimi për Kontratën e Shitjes: 'Rikonstruksioni i rrugës lokale Ponesh-Zhegovc' (MTPT 08/049/511, maj 2008, Regjistratori 48B, f. 177.

¹⁵³ 'Sigurimi i raportit të ekspertëve lidhur me procedurën e dhënies së kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16.

¹⁵⁴ 'Sigurimi i raportit të ekspertëve lidhur me procedurën e dhënies së kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, f. 343.

¹⁵⁵ 'Sigurimi i raportit të ekspertëve lidhur me procedurën e dhënies së kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, f. 344.

¹⁵⁶ 'Sigurimi i raportit të ekspertëve lidhur me procedurën e dhënies së kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, f. 344.

së tenderit dhe me këtë përjashton disa nga konkurrentët. Siç u përmend më lart, shkurtimi i afateve - në një procedurë të hapur - tregon vullnetin për të kufizuar konkurrencën gjithashtu. → Sugjeron që kërkesat e dosjes së tenderit dhe / ose peshimi i kritereve qëllimisht të çojnë tek kompania T. si një rezultat i favorizuar.¹⁵⁷

- e. **Q. M.**, dëshmia e të cilit më parë ishte përmbledhur më larë në paragrafin 124, dëshmoi se komuna kishte dy burime kryesore të të ardhurave për projektet e ndërtimit të rrugëve: grantet qeveritare (shumica) dhe të hyrat komunale.¹⁵⁸ Megjithëse disa projekte janë bashkë-financuar në mes të Komunës dhe MTPT-së, pjesa e kontribuar nga ana e komunës ka qenë simbolike (5%, 7%, 10% ose madje 0%).¹⁵⁹ Shumica e projekteve të nivelit komunal të cilat u bashkë-financuan nga Komuna dhe MTPT-ja u zhvilluan plotësisht dhe në mënyrë të pavarur nga komuna; megjithatë, projektet që kërkonin fonde të mëdha dhe që i përkisnin nivelit kombëtar dhe rajonal, u proceduan nga MTPT.¹⁶⁰
- f. **K. G.** dëshmoi si vijon lidhur me këtë tender:

*“Ka pasur pyetje të hapura sa i përket kompetencës për këtë procedurë. Normalisht kompetenca për këtë procedurë do të ishte me komunën, por procedurat në të vërtetë janë kryer nga ministria dhe ne kemi pyetur se cila ishte arsyeja për këtë. Dhe pastaj ka pasur edhe pyetje lidhur me procedurën si të tillë, përkatësisht në lidhje me afatet kohore ... Unë e di nga vende të tjera, dhe gjithashtu nga Gjermania, se kjo është një lloj metode për ta përshtatur këtë me nevojat e kompanive që janë të gatshme për të ofertuar me njoftim të shkurtër dhe janë më të shpejtë për ta bërë këtë. Ju duhet të kuptoni se tashmë afati 40 ditor është mjaft i shkurtër për inxhinierët që të përgatisin dhe të kryejnë planifikimin e tyre dhe nëse ky afat është shkurtuar deri në 24, atëherë ky është një stres i madh për kompaninë ”.*¹⁶¹

“...Duke shkurtuar afatin prej 40 deri në 24 ditë ju duhet të dini, ju duhet të kuptoni se shumë nga kompanitë për arsye thjesht teknike nuk janë në gjendje të dorëzojnë një tender brenda këtij afati. Kjo krijon së paku dyshime për parregullsi e cila nuk është provuar tashmë si e tillë, por është një tregues që ju duhet të keni një vështrim më të afërt. Ju mund të thoni se të gjithë procedurat në bazë të kësaj të jenë të paligjshme, por siç themi në Gjermani

¹⁵⁷ 'Sigurimi i raportit të ekspertëve lidhur me procedurën e dhënies së kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, f. 346.

¹⁵⁸ 'Sigurimi i raportit të ekspertëve lidhur me procedurën e dhënies së kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, f. 347-348.

¹⁵⁹ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 14.

¹⁶⁰ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 15.

¹⁶¹ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 16.

dhe ndoshta ju bëni po aq mirë këtu në Kosovë "Kur nuk ka pretendues nuk ka gjyqtar".¹⁶²

"...Ne kemi vërejtur se ka pasur një trajtim mjaft liberal të kriterëve në lidhje me komponentët teknike dhe ekonomike të cilat duhet të shqyrtohen në detaje ... Matrica me të cilën administrata e tenderit duhet të paraqitet në lidhje me kriteret ekonomike dhe teknike, ne i quajmë ato të ashtuquajturat pikat e buta cilës ofertë i jepen 5, 6 ose 10 pikë, që administrata e dhënies së tenderit mund të luajë me to. Sidoqoftë, duhet të dokumentohet se cila kompani i ka marrë këto pikë, por nuk kemi gjetur një dokumentar të tillë. Kështu që mund të arrini në përfundimin se ka të paktën një dyshim për parregullsi dhe këtu ishte rezultati si i tillë që normalisht një kompani tjetër duhet të ishte dhënë oferta kompanisë "B." K. me çmimin më të ulët, por bazuar në luajtjen me këto pikë papritmas Kompania "T." ka fituar tenderin."¹⁶³

"...Pra, duke përfunduar mund të thuhet se administrata e tenderit në dy rastet mund të luajë me materialin e tenderit. Unë ose mund të përjashtoj kualifikimet ose pikat e fitimit për kualifikim për të ardhur në rezultatin që një kompani është përjashtuar. Në të njëjtin drejtim shkon shkurtimi i afateve dhe alternativa e dytë është trajtimi i ofertave në atë mënyrë që një ofertues i veçantë tenderues duhet të marrë kontratën."¹⁶⁴

"...mund të luash me dhënien e pikave këtu dhe pse një kompanie i është dhënë numri i plotë i pikëve dhe një kompanie tjetër nuk i është dhënë. Kjo duhet të dokumentohet dhe një dokumentacion të tillë nuk kemi mundur të gjejmë."¹⁶⁵

145. Në fillim, trupi gjykues theksoi se prokurori nuk ka argumentuar se ndonjë nga parregullsitë e supozuara në procedurën e tenderit (p.sh. marrëveshja e bashkëfinancimit, shkurtimi i afatit të ofertimit, vlerësimi i drejtuar i ofertave individuale) i atribuohet sjelljes së vetë N.K. Pretendimet e prokurorit (siç është cituar më lartë) janë përshtatur në zërin pasiv. Ky është një pasqyrim i natyrshëm i kompania B.t të këtyre pohimeve, analizës së ekspertëve të K.G., i cili gjithashtu flet pasivisht (p.sh. "një interes për të kufizuar konkurrencën"; "një trajtim mjaft liberal i kriterëve") ose të sjelljes së "autoriteti kontraktues" ose "MTPT" në përgjithësi. Veçanërisht, fjalimi i K. G. është tërësisht logjik: gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të tenderit, ai identifikoi parregullsi të dyshuara, të cilat kërkonin konfirmim të mëtejshëm nga prova shtesë. Prokurori, megjithatë, nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme shtesë, të cilat do të kishin mundur të vërtetonin parregullsitë e mundshme përfundimisht ose në të vërtetë të lidhura me N.K.
146. Rrjedhimisht, trupi gjykues më pas shqyrtoi nëse kishte prova të mjaftueshme për të vërtetuar se N.K. ishte në dijeni për shkeljet e mundshme siç do të shkaktonte

¹⁶² Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 6.

¹⁶³ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 7.

¹⁶⁴ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 7.

¹⁶⁵ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 8.

- përgjegjësinë e tij për të ndaluar procesin dhe për të nxjerrë hetime të mëtejshme përpara se të nënshkruante ndonjë kontratë me kompaninë fituese. Në veçanti, sipas dëshmive të B. R. dhe V. K., trupi gjykues pranoi se N.K. ishte i obliguar që të shqyrtojë raportin e komisionit të vlerësimit të ofertave para nënshkrimit të kontratës me kompaninë fituese dhe kështu që ai ishte i vetëdijshëm për përmbajtjen e tij. Raporti, megjithatë, nuk nënvizon ndonjë parregullsi në procedurë dhe nuk ofron arsyetim të mjaftueshëm, që do të mund të nxirrte në pah një vlerësim të drejtuar ndaj kompanisë *T.* si rezultat i favorizuar.
147. Sa i përket pretendimeve të prokurorit për ndarjen e çmimeve ndërmjet kompanisë *T.* dhe *Z.C.*, trupi gjykues konsideroi se nëse N.K. ishte i vetëdijshëm për ngjashmërinë e madhe të ofertave përkatëse, kjo do të nxiste detyrën e tij që të ndërhyjë për të ndaluar procedurën e tenderit. Megjithatë, raporti i komisionit të vlerësimit të ofertave nuk është informativ në këtë drejtim: ai rendit vetëm ofertat përfundimtare të të dy kompanive, përkatësisht 576,345.50 Euro dhe 579,499.26 Euro. Kjo afërsi nuk ishte e mjaftueshme për të paralajmëruar N.K për keqbërje; me të vërtetë llogaritja (para zbritjes) e kompanisë *I. E* (575,855.64 Euro) ishte më afër vlerës së kompanisë *T.* se sa ajo e kompanisë *Z. C.*
148. Së fundmi, trupi gjykues pranoi se ishte e arsyeshme që N.K të mbështetej në këshillën e komisionit vlerësues dhe anasjelltas refuzoi nocionin se atij ose iu kërkohet ose në fakt e shqyrtonte personalisht secilën ofertë të tenderit individual. Në këtë pikë, trupi gjykues dyshoi vërtetësinë e dëshmisë së drejtpërdrejt të V.K. duke vënë në dukje se ajo ishte në mëdyshje për t'iu përgjigjur pyetjeve të prokurorit dhe vazhdimisht kundërshtoi deklaratat e saj të mëparshme tek prokurori i PSRK-së. Megjithatë, edhe sikur të pranonin pohimet e dëshmitarit (më herët) se N.K. kishte qasje në të gjithë dosjen e lëndës dhe "*donte të informohej për gjithçka*", këto nuk kanë specifikat e nevojshme për të gjetur përtej dyshimit të arsyeshëm se N.K. kishte njohuri aktuale për parregullsitë ose ofertat individuale të tenderit të bëra nga kompania *T.* dhe *Z. C.* Ky përfundim u forcua nga fakti se V.K. nuk ishte në gjendje të komentonte mbi përfshirjen e N.K. me këtë tender të veçantë, për të cilin ajo nuk shërbeu në komisionin e vlerësimit.
149. Për këto arsye, trupi gjykues gjeti se prokurori nuk arriti të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se N.K. ka drejtuar manipulimin e procedurës së tenderit për rindërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc (08-049-511) ose ishte i vetëdijshëm për një manipulim të tillë që do të nxiste detyrën e tij që të ndërhyjë për të ndaluar procesin.
150. Së fundi, trupi gjykues rikujtoi se prokurori ishte i obliguar, sipas nenit 422 të KPK-së, të tregonte se N.K. duke vepruar ose duke mos vepruar me qëllim që të fitonte një 'përfitim material' për vete ose për një person tjetër; shkaktojnë dëme një personi tjetër;¹⁶⁶ ose shkelin seriozisht të drejtat e një personi tjetër. Prokurori pohoi se parregullsitë "*qëllimisht çojnë në kompaninë T. si rezultat të favorizuar*",

¹⁶⁶ Shih *supra* Pjesën II.A.i.

duke mos specifikuar as qëllimin e të cilit ishte në pyetje apo atë që ata kishin për të fituar. Vetë mungesa e këtij përbërësi të rëndësishëm të veprës ishte, sipas trupi gjykues, fatale për këtë akuzë.

151. Për të gjitha këto arsye trupi gjykues arriti në përfundimin se prokurori nuk provoi përtej dyshimit të arsyeshëm se N.K.ka keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij zyrtar si Shef i Prokurimit të MTPT-së kur nënshkroi kontratën për tenderin 08-049-551 për rindërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc në Gjilian me kompaninë T.

A ka ndihmuar E.SH. keqpërdorimin e pozitës zyrtare apo autoritetit?

152. Përfundimisht, prokurori pretendoi se *"E.SH. dyshohet të jetë i përfshirë në procedurën e tenderit dhe ekzekutimin e ndërtimit të rrugës po ashtu"*¹⁶⁷ dhe *"ka qenë i përfshirë në procedurën e prokurimit që përfshin T. Company dhe ka shërbyer si pikë kontakti për MTPT-në që të mbulojë punën e dëmtuar të kompanisë për rrugën "*.¹⁶⁸ Në mënyrë të veçantë, prokurori vë në pah një seri SMS të përgjuara mes F.Z dhe E.Sh. më 18 korrik dhe 22 gusht 2009. Në të dyja bisedat F.Z informon E.Sh. për defektet në ndërtimin e rrugës dhe shpreh shqetësimin e tij se ai do të gjobitet ose komisioni nuk do të pranojë rrugën. E. Sh. e siguron F.Z., e këshillon atë të vazhdojë dhe sugjeron justifikime për defektet nëse këto janë të nevojshme.¹⁶⁹
153. Trupi gjykues përkujton se Pika 2 akuzon E.Sh. si asistent në pajtim me nenin 25 të KPPK-së.¹⁷⁰ Përgjegjësia penale e një asistenti varet nga kontributi i tij i vetëdijshëm ndaj kryerësit kryesor. Kështu, ishte detyrë e prokurorit të provonte se E.Sh. i. ndihmoi një personi zyrtar në keqpërdorim me zyrën ose autoritetin e tij, duke tejkuluar kufijtë e autorizimeve të tij ose duke mos kryer ekzekutimin e detyrave të tij zyrtare dhe ii. ishte i vetëdijshëm për qëllimin e kryerësit kryesor për të përfituar një përfitim material për vete ose për një person tjetër ose për të shkaktuar dëme materiale për një person tjetër ose për të shkelur seriozisht të drejtat e një personi tjetër.
154. Pretendimet e prokurorit nuk u drejtuan, as nuk vërtetuan provat e paraqitura, këto elemente të nevojshme të veprës penale të ngarkuar. Për këto arsye, trupi gjykues konstatoi se prokurori nuk arriti të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se E.SH. asistoi keqpërdorimin e pozitës zyrtare ose autoritetit duke siguruar dhe inkurajuar F. Z. në konstruksion me defekte për tenderin 08-049-511 për rindërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc.

¹⁶⁷ Aktakuza e Konsoliduar, f. 35, paragrafi 59

¹⁶⁸ Aktakuza e Konsoliduar, f. 39, paragrafi 62.

¹⁶⁹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 36, paragrafi 60, referuar transkriptit të SMS në mes F. Z. dhe E. Sh. e datës 18 korrik dhe 22 gusht 2008: Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 52a-52g, Post-Aktakuza Regjistratori IV-A

¹⁷⁰ Aktakuza e Konsoliduar, f. 3, 6; Shih gjithashtu Pjesën II.A.ii.

ii. Tenderi 08-006-511 - Mirëmbajtja verore për rrugët rajonale të Kosovës, Rajoni i Gjilanit (2008), i fituar nga Kompania M.

155. Prokurori argumenton se F. Z. nga T. kompani hyri në një marrëveshje për rregullimin e çmimeve me kompaninë E., të cilën ai u përpoq të fsheh duke përfshirë ndryshime të vogla midis dy ofertave të tenderit.¹⁷¹ Si rezultat, të dyja kompanitë është dashur të diskualifikohen nga tenderi – diskualifikim ky që kërkon që i gjithë procesi të anulohet dhe të ri përsëritet.¹⁷² Ky pretendim gjithashtu krijon bazën për **Piken 5**, duke pretenduar keqpërdorimin e autorizimeve ekonomike kundër **F. Z.** dhe shqyrtohet më tej në Pjesën V.D.ii.¹⁷³
156. Prokurori pretendon se **N.K.e** ka keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij zyrtar, sepse ai ka ditur për rregullimin e lartpërmendur të çmimeve dhe megjithatë ka lejuar vazhdimin e procedurës së tenderit (domethënë nuk ka arritur të ndërhyjë për ta ndaluar atë), nuk ka raportuar për rregullimin e çmimeve tek autoritetet e nevojshme, dhe përfundimisht nënshkroi kontratën me kompaninë fituese (M).¹⁷⁴ Më tej, sipas prokurorit, zoti N.K. e favorizoi qëllimisht kompaninë M.¹⁷⁵
157. Prokurori nuk pretendon për ndonjë përfshirje të **F.L.t**, **E.SH.** apo **Sh. T.** në tenderin 08-006-511 dhe kështu përgjegjësia e tyre nuk shqyrtohet më tutje në këtë pjesë. Prandaj, trupi gjykues shqyrtoi nëse pretendimet kundër N.K. ishin vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm, si më poshtë.
158. Trupi gjykues ishte i bindur që N.K. nuk ndërhyri për të ndaluar procedurën për Tenderin 08-006-511 ose për të raportuar ndonjë parregullsi autoriteteve. Kjo është e qartë pasi që procesi i prokurimit publik ka avancuar pa pengesa në të gjitha fazat përkatëse deri në përfundimin e tij,¹⁷⁶ gjatë të cilës kohë N.K. natyrisht nënshkroi në emër të MTPT kontratën me kompaninë M.¹⁷⁷ Ndërsa prokurori nuk arriti të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se kishte marrëveshje për rregullimin e

¹⁷¹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 8 (“... F. Z. Nga kompania T. u fut në marrëveshje për caktimin e çmimeve me kompaninë E. ... F. Z. fshehu marrëveshjen e çmimeve dhe manipulonte çmimet me E. fshehurazi.”); faqe 13 (“F. Z ... duke kryer, dhe toleruar marrëveshjeje për caktimin e çmimeve me kompaninë E..”); faqe 40 (“Dallimi i vogël në çmim vjen nga variacionet e vogla që janë përfshirë për të fshehur marrëveshjen e caktimit të çmimeve.”)

¹⁷² Aktakuza e Konsoliduar, f. 8 (“... të dyja kompanitë është dashur të përjashtohen nga tenderi. Përjashtimi i tillë do të kërkonte ri përsëritjen e tërë procesit.”)

¹⁷³ Aktakuza e konsoliduar, f. 13, 40 (paragrafi 68).

¹⁷⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f. 8 (“... N.K.e ka nënshkruar tenderin për kompaninë M. pavarësisht se dinte” për caktimin e çmimeve dhe se procesi duhej të ri përsëritej”); faqe 9 (“N. K., edhe pse dinte për marrëveshjen për caktimin e çmimeve, megjithatë pranoi vazhdimin e procesit të tenderimit. Ai gjithashtu nuk u ka raportuar autoriteteve të kërkuara për marrëveshjen për caktimin e çmimeve në mes të dy kompanive dhe e ka nënshkruar kontratën me kompaninë fituese M. edhe pse ka ditur për paligjshmërinë e përfshirë për vazhdimin e këtij procesi.”); faqe 40 paragrafi 67 (“N. K., si Shef i Prokurimit i MTPT-së dhe më 24 prill 2008 nënshkruet i kontratës ... me kompaninë T. mban përgjegjësi ligjore ...”)

¹⁷⁵ Aktakuza e Konsoliduar, f. 40 paragrafi 67 (“N.K.... mban përgjegjësi ligjore për favorizimin me dashje të kompanisë M.-s. Shkeljet e ligjit u bënë me qëllim për të favorizuar kompaninë M-n.”).

¹⁷⁶ Kjo është përshkruar në Aktakuzën e Konsoliduar, paragrafët 63-67.

¹⁷⁷ Kontrata - Mirëmbajtja Verore e Rrugëve Kombëtare dhe Rajonale 2008, Rajoni i Gjilanit ndërmjet MTPT dhe Magjistrale datë 24 Prill 2008: Regjistratori 47U, f. 3; Regjistratori 47X, f. 2.

çmimeve midis kompanisë *T.* dhe *E.*,¹⁷⁸ Trupi gjykues nuk e konsideroi këtë si thelbësore për të vendosur përgjegjësinë penale të N.K. në këtë Pikë të Aktakuzës. Me parë, ngjashmëria e dukshme e ofertave të tenderit, të cilat ishin identike në 54 nga 56 artikuj-po të kishte qenë N.K. në dijeni për këtë- do ta kishte nxit detyrimin e tij për të ndaluar procesin dhe për të ngritur hetime të mëtejshme përpara nënshkrimit të kontratës.

159. Prandaj, ishte e nevojshme të shqyrtohej nëse prokurori vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se N.K. ishte në dijeni për ngjashmërinë e ofertave, në atë mënyrë që duke lejuar që procedura e tenderit të vazhdojë pa hetimin e ofertave, dhe duke nënshkruar kontratën me kompaninë fituese, do të përbënte keqpërdorim të autoritetit të tij si Shef i Prokurimit i MTPT. Trupi gjykues e shqyrtoi tërësinë e dosjes së lëndës dhe theksoi provat e rëndësishme në vijim:

- a. Dëshmitë e **B. R.**, dhe të **V. K.**, të përmbledhura në Pjesën V.B (paragrafi 144), më sipër.
- b. **Raporti i komisionit vlerësues të ofertave**¹⁷⁹ i liston të gjitha (tokompania T.n) ofertat e paraqitura për rajonet që formojnë një pjesë të këtij tenderi, përfshirë ato të kompanisë *E-it.* dhe *T-t.* për rajonin e Gjilanit.¹⁸⁰ Kjo pasohet nga një tabelë në të cilën komisioni vlerësues tregon - me 'po'/'jo' - nëse kompanitë ofertuese plotësojnë kushtet administrative/formale dhe të sigurisë;¹⁸¹ kushtet e përshtatshmërisë ligjore;¹⁸² kushtet e përshtatshmërisë profesionale;¹⁸³ kushtet e gjendjes ekonomike dhe financiare;¹⁸⁴ dhe kushtet e aftësive teknike dhe profesionale.¹⁸⁵ Në bazë të këtij vlerësimi, raporti pastaj vazhdon, me arsye të shkurtra, për të përjashtuar ofertat që nuk ishin të përgjegjshme,¹⁸⁶ si dhe të ofrojë një përmbledhje të ofertave të mbetura, ofertave të përgjegjshme dhe shumat e ofertës se tyre të përgjithshme.¹⁸⁷ I njëjti informacion paraqitet përsëri në një tabelë tjetër.¹⁸⁸ Në fund, për secilin rajon që është pjesë e kësaj procedure të tenderit, raporti i rendit ofertat e përgjegjshme me çmimin e ofruar, me çmimit më të ulët të ofruar që rekomandohet për dhënien e tenderit.¹⁸⁹

¹⁷⁸ Kjo është shqyrtuar në detaje në Piken 5 të aktakuzës, Pjesa V.D.ii.

¹⁷⁹ Raporti për vlerësimin e ofertave dhe rekomandimin për dhënien e kontratës: Mirëmbajtja verore e rrugëve kombëtare dhe rajonale për vitin 2008 (MTPT 08/006/511), prill 2008, Regjistratori 47D, f. 48-107.

¹⁸⁰ Regjistratori 47D, f. 51-52.

¹⁸¹ Regjistratori 47D, f. 57-62.

¹⁸² Regjistratori 47D, f. 63-68.

¹⁸³ Regjistratori 47D, f. 69-76.

¹⁸⁴ Regjistratori 47D, f. 77-82.

¹⁸⁵ Regjistratori 47D, f. 83-88.

¹⁸⁶ Regjistratori 47D, f. 89-92.

¹⁸⁷ Regjistratori 47D, f. 93-94.

¹⁸⁸ Regjistratori 47D, f. 95-98.

¹⁸⁹ Regjistratori 47D, f. 99-107.

160. Trupi gjykues rikujton se më parë ka pranuar se: i. N.K ishte i obliguar të kontrolloj raportin e komisionit vlerësues të ofertave para nënshkrimit të kontratave me ofertuesit fitues, dhe kështu ai ishte në dijeni për përmbajtjen e raportit; ii. ishte e arsyeshme që N.K. të përgjigjet pas këshillës së komisionit vlerësues; dhe iii. N.K nuk është kërkuar të kontrolloj çdo ofertë individuale të tenderit, dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar se ai e ka bërë këtë.
161. Raporti i komisionit askund nuk tregon se dyshonte për rregullimin e çmimeve në mes kompanisë *T*. dhe *E*. ose që ofertat e kompanive përputheshin në 54 nga 56 artikujt. Me shumë, ai përfshin vetëm ofertat e tyre përfundimtare, përkatësisht 799,488.63 dhe 801,386.15 Euro. Trupi gjykues nuk ka marr parasysh se kjo afërsi e ofertave përfundimtare ishte, vetvetiu, e mjaftueshme për të paralajmëruar N.K. për shkelje të mundshme. Në këtë aspekt, trupi gjykues vërejtë se një numër i kompanive bëri oferta që ishin jashtëzakonisht të ngushta në vlerë, në lidhje me të cilat asnjë keqbërje nuk është pretenduar nga prokurori,¹⁹⁰ në mes tyre oferta e kompanisë *I*. prej 804,146.13 për rajonin e Gjilanit.¹⁹¹ Për këto arsye, trupi gjykues gjeti se prokurori nuk arriti të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se N.K. ishte i vetëdijshëm se ofertat e kompanive *T-t*. dhe *E-it*. ishin aq të ngjashme sa të kërkonin hetim të mëtejshëm.
162. Në fund, trupi gjykues rikujtoi se prokurori ishte i obliguar, sipas nenit të zbatueshëm 422 të KPK-së, të tregonte se N.K. duke mos e ndaluar procedurën ose duke nxitur hetime të mëtejshme ose duke nënshkruar kontratën me kompaninë *M.*, kishte për qëllim ose të fitonte një ‘dobi pasurore’ për vete ose për një person tjetër; shkaktonte dëm një personi tjetër; ose shkelte seriozisht të drejtat e një personi tjetër.¹⁹² Prokurori pohoi se N.K. veprroi me synimin për të favorizuar kompaninë fituese, *M*. Ai as nuk e mbështeti këtë pohim, as nuk krijoi prova të mjaftueshme në mbështetje të saj (siç janë, për shembull, provat e ndonjë takimi në mes të N.K. dhe ndonjë përfaqësuesi të kompanisë *M-s*, *T-t* ose *E-it*; ose ofertën ose pagesën e ndonjë ryshfeti në këmbim të dhënies së këtij tenderi). Mungesa e këtij përbërësi të rëndësishëm të veprës ishte, sipas trupit gjykues, vetëm fatale për këtë akuzë.
163. Për të gjitha këto arsye, trupi gjykues arriti në përfundimin se prokurori nuk ka dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se N.K.ka keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij zyrtar si Shef i Prokurimit i MTPT kur nënshkroi kontratën për tenderin 08-006-551 për rajonin e Gjilanit me kompaninë *M.-n*.

iii. Tenderi 009-004-511 – Mirëmbajtja verore dhe dimërore për rrugët rajonale të Kosovës (2009-2010), i fituar nga kompania T.

¹⁹⁰ Shih, për shembull, ofertat e kompanisë *I-it* (983,468.50) dhe *E-it* (987,321.00) për rajonin e Prishtinës (Regjistratori 47D, f.99); *T*. (631,097.00) dhe *E-i* (631,528.25) për rajonin I të Mitrovicës (f.105).

¹⁹¹ Regjistratori 47D, f. 101.

¹⁹² Shih Pjesën II.A.i, paragrafët 34-40.

164. Prokurori pretendoi për dy raste të ndryshme të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit në lidhje me këtë tender. Së pari ai pretendon se **F.L.** dhe **N.K.** i kishin premtuar M.SH.së se kompania *I-E* se ata do t'ia 'rregullonin' dokumentet e tij të ofertës në tender ashtu që atij t'i jepej tenderi, në shkëmbim të heshtjes së tij lidhur me atë që nuk i ishin dhënë tenderët e mëparshëm, dhe nëse ai paguante 20% të vlerës totale të tenderit si ryshfet.¹⁹³ M.Sh.i refuzoi këto kushte, dhe i akuzuari u kthye te F. Z.
165. Kështu që, pretendimi i dytë i prokurorit ishte se **E.SH.**, duke vepruar në emër të **F.L.t**, ishte pajtuar me F. Z. që t'i 'rregullonte' dokumentet ofertuese të kompanisë *T*. Në atë mënyrë që të bënte që kjo kompani ta fitonte tenderin. Në shkëmbim të kësaj, F.Z. do të paguante ryshfet prej 250,000 EUR (që sërish paraqet 20% të vlerës totale të tenderit). Kjo marrëveshje ishte realizuar gjatë rrjedhës së marsit 2009, dhe kompanisë *T* i ishte dhënë kontrata për Tenderin 009-004-511 (Gjilan).
166. Marrëveshja me të dy me M. Sh. dhe F. Z. po ashtu krijoi bazën për **Pikën 3 të Aktakuzës** kundër **F.L.t**, **N. K.t** dhe **E.SH.** për marrjen e ryshfetit. Kjo është shqyrtuar në Pjesën V.C. Më tej, përfshirja e pretenduar e **F.Z.** në negociimin me E.Sh. dhe në premtimin e ryshfetit për E.Sh. po ashtu ishte pikë e akuzës për keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi në **Pikën 5 të Aktakuzës**, e shqyrtuar në Pjesën V.D.ii. Në fund, pasi që prokurori nuk kishte pretenduar për përfshirjen e **SH.T.** në asnjërën prej rasteve, trupi gjykues nuk e shqyrtoi përgjegjësinë e tij më tej në këtë pjesë.
167. Trupi gjykues e ka shqyrtuar secilin pretendim me radhë, siç është paraqitur më poshtë.

Marrëveshja me M. Sh.

168. Hollësitë e pretendimeve të prokurorit në lidhje me M.Sh. kanë qenë si më poshtë. Sipas prokurorit, në tetor ose nëntor të vitit 2008, I. Z., kryetar i degës së PDK-së Dega në Gjilan aranzhoi një takim ndërmjet M.Sh. dhe zëvendësministrit të MTPT-së, A. G., që u zhvillua në zyrën e këtij të fundit.¹⁹⁴ F.L.u paraqit në këtë takim dhe i tha M.Sh. "Mos fol, dhe tenderi i mirëmbajtjes verore të rrugëve për 2009 është i yti"¹⁹⁵ dhe premtoi se ai do ta 'rregullonte' dokumentacionin e tij të tenderit.¹⁹⁶
169. Pas marsit 2009, pasi dështoi ta bindte Kryetarin e Gjilanit, Q. M. që t'i bashkohej atij, M.Sh. pa sukses u përpoq të takohej me F.L. vetëm.¹⁹⁷ Prokurori pretendon se F.L. nuk ia kishte 'rregulluar' dokumentet M.Sh. ashtu siç kishte premtuar, por në

¹⁹³ Aktakuza e Konsoliduar, f. 9; f. 41, paragrafët 69-71; f. 44-46, paragrafët 85-90; f. 49-50, paragrafët 104-107; f. 51-52, paragrafët 109-111; f. 53-55, paragrafët 114-117.

¹⁹⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f. 41, paragrafi 69

¹⁹⁵ Aktakuza e Konsoliduar, f. 9; f. 41, paragrafi 70.

¹⁹⁶ Aktakuza e Konsoliduar, f. 41, paragrafi 71.

¹⁹⁷ Aktakuza e Konsoliduar, f. 44, paragrafi 85 ("Pasi që Q. M. nuk kishte kohë, M.Sh. me gjasë kishte shkuar në takim me F.L.N pa të."); f. 45, paragrafi 86 ("F.L. e kishte shtyrë këtë takim ...").

vend të kësaj ai e kishte udhëzuar atë që ta kontaktonte N.K.¹⁹⁸ Sipas prokurorit, .M.Sh .shkoi siç ishte udhëzuar te N.K. dhe i tha atij “Dëgjo, e di që po kërkon të merrni 10% mirëpo nuk kam para”, të cilës N.K. thuhet se i ishte përgjigjur: “Ne do t’ju depozitojmë 20 % të shumës së përgjithshme si avans dhe pastaj ju do të na jepni ato para neve.”¹⁹⁹ .M.Sh. i refuzoi këto kushte dhe N.K. e dërgoi prapa te F.L i cili i sugjeroi M.Sh. që ai ta kompletonte dokumentin me kompaninë me kompaninë me të cilën ai kishte bërë oferta të pasuksesshme për tender.²⁰⁰

170. Më 23 mars 2009, M.Sh., “në mënyrë që të sigurohet se a ia vlente të bëjë përpjekje për të përgatitur vet dokumentacionin ... provoi të sigurohet edhe një herë nga A.G...”²⁰¹ mes datave 28 mars dhe 1 prill, M. Sh .ishte përpjekur të siguronte tenderin përmes kontaktimit në mënyrë të përsëritur të F.L., N.K, dhe Q.M.²⁰² Prokurori pretendon se F.L. i ishte përgjigjur një SMS-i që i ishte dërguar atij.²⁰³
171. Pasi dëgjoi që kompania T-t i ishte dhënë tenderi, M. Sh. fillimisht kishte kërkuar që ta konfirmonte këtë me F.L.,²⁰⁴ pastaj ai u zemërua, duke akuzuar atë se ishte “blerë” dhe se nuk e mbante “fjalën e dhënë”.²⁰⁵ Në maj të vitit 2009, .M. Sh .kishte pasur një bisedë me Q.M. ku ky i pari e akuzonte sërish F.M. për shkelje të premtimeve të tij dhe kërcënoi se do të “publikojë çdo gjë” nëse nuk anulohet tenderi.²⁰⁶ Pas përpjekjes përfundimtare për të siguruar një tender tjetër,²⁰⁷ M.Sh.i shkroi një letër ankese AKK-së, i ka nxitur hetimet të cilat kulmuan me këtë procedurë penale.
172. Duke iu kthyer provave në mbështetje të këtyre pretendimeve, trupi gjykues rikujtoi, së pari, se deklarata e incizuar në audio e dhënë nga M.Sh.për AKK-në ishte shpallur provë e papranueshme nga kryetarja e trupit gjykues në një aktvendim të vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Së dyti, trupi gjykues konstatoi se deklarata e M.Sh. për Policinë e EULEX-it nuk do të mund të përdorej si provë e drejtpërdrejtë në këtë shqyrtim dhe se Informatat e AKK-së dhe letra e ankesës e M. Sh.që ishte bashkëngjitur aty kishin vlerë provuese të kufizuar.²⁰⁸ Trupi gjykues i shqyrtoi shkresat e lëndës për prova relevante për shpërdorim të pozitës zyrtare/autorizimit të F.L. dhe N.K.me anë të premtimeve dhe marrëveshjeve me z.M.Sh.dhe nënvizoi si më poshtë:

¹⁹⁸ Aktakuza e Konsoliduar, f. 9; f. 45, paragrafi 86.

¹⁹⁹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 9; f. 45, paragrafët 86-87.

²⁰⁰ Aktakuza e Konsoliduar, f. 9; f. 45, paragrafët 88-89.

²⁰¹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 45, paragrafi 89.

²⁰² Aktakuza e Konsoliduar, f. 49-50, paragrafët 104-107; f. 51, paragrafët 109-110.

²⁰³ Aktakuza e Konsoliduar, f. 50, paragrafi 106 (“Përgjigja e F.L.T nuk është nxjerrë nga hetuesit. Logjikisht ka pasur në fakt një përgjigje nga F.L. sepse menjëherë pasi M.Sh.kishte kërkuar një takim, M.Sh.në orën 11:29 i ishte përgjigjur F.L.t duke thënë [si vijon]: ‘Këtu në Prishtinë.’”)

²⁰⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f. 51, paragrafët 110-111.

²⁰⁵ Aktakuza e Konsoliduar, f. 51, paragrafi 111.

²⁰⁶ Aktakuza e Konsoliduar, f. 53, paragrafi 114.

²⁰⁷ Aktakuza e Konsoliduar, f. 54-55, paragrafët 115-116.

²⁰⁸ Shih Pjesën IV.B. më lart.

a. **SMS-të e përgjuara gjatë asaj kohe**, duke përfshirë:

- i. Një SMS i përgjuar i dërguar nga M.Sh.për Q.M më 19 mars 2009 ku thuhet: *“Kryetar neser ditën e premte ka than F.L.me shkue te aj a po shkojm bashk konfirmo pershendetje.”* Q.M. iu përgjigj M.Sh.: *“Nesër nuk kam kohë. Javën tjetër.”*²⁰⁹
- ii. Dy SMS të përgjuar të dërguar nga M.Sh.për F.L. më 20 mars 2009 ku thuhet: *“M.Sh., jam tu ardh ne sa ora me ardh ka ju?”* (7:30) dhe *“Jam tu prit.”* (10:15).²¹⁰ Nuk ka përgjigje të regjistruar nga F.L. për M.Sh.në asnjërin SMS.
- iii. Tre SMS nga M.Sh.për F.L. të përgjuara më 23 mars 2009 ku thuhet: *“Mirëmëngjesi, M.Sh. jam; Po pres këtu në Ministri”* (9:01); *“Jam në zyrën tënde”* (13:54); *“Po pres, por mundet me kanë shumë vonë!”* (14:24).²¹¹ Nuk ka përgjigje të regjistruar nga F.L për M.Sh.
- iv. Një SMS i përgjuar i dërguar nga M.Sh.për A.G më 23 mars 2009 në orën 17:15 ku thuhet: *“Zotri zavens a jan fjalt qysh mikini than ne Nandor per mirëmbajtjen verore? M.Sh..GJILAN.”*²¹² Nuk ka përgjigje të regjistruar nga A.G. për M.Sh.
- v. Dy SMS të përgjuar të dërguar nga M.Sh.për F.L. më 28 mars 2009 ku thuhet *“Ju lutem mosum anashkaloni M.Sh.Gjilan”* (14:47) dhe *“Mos i harro fjalt qe i kemi pas ne tetor të vitit kalum”* (15:12).²¹³ Nuk ka përgjigje të regjistruar nga F.L. për M.Sh.
- vi. Një SMS i përgjuar nga M.Sh.për I. Z. më 29 mars 2009 (18:30) ku thuhet: *“I.Z. nëse nuk të pengon çoja një SMS A.G. para se mu ba shumë vonë nëse ata dështojnë edhe këtë herë unë do t'i hapi kartat e mia, M.Sh.”*²¹⁴
- vii. Dy SMS të përgjuar të dërguar nga M.Sh.për F.L. më 30 mars 2009 ku thuhet *“Ministër, a mujm me u takue sot”* (11:27) dhe *“Këtu në*

²⁰⁹ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe Q. M. datë 19 mars 2009 në orën 17:46 dhe 19:52: Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 79a dhe 79b, Regjistratori post-Aktakuzë IV-A.

²¹⁰ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe F.L.t datë 20 mars 2009 në ora 07:30 dhe 10:15, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 79c dhe 79d, Regjistratori post-Aktakuzë IV-A.

²¹¹ Transkripti i SMS ndërmjet M.Sh. dhe F.L.t datë 23 mars 2009 në ora 09:01, 13:54, 14:24, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 82a dhe 82c, Regjistratori post-Aktakuzë IV-A.

²¹² Transkripti e SMS ndërmjet M.Sh. dhe A. G. datë 23 mars 2009 në ora 17:15, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 83, Regjistratori post-Aktakuzë IV-A.

²¹³ Transkriptet e SMS ndërmjet M.Sh. dhe F.L.t datë 28 mars 2009 në ora 14:47 dhe 15:12: Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 99a dhe 99b, Regjistratori post-Aktakuzë IV-A.

²¹⁴ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe I. Z. datë 29 mars 2009 në orën 18:30: Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 197, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B.

Prishtinë” (11:29).²¹⁵ Nuk ka përgjigje të regjistruar nga F.L. për M.Sh.

viii. Më 30 mars 2009, ishte përgjuar ky shkëmbim i SMS-ve ndërmjet M.Sh.dhe Q.M.²¹⁶

M.Sh.: “*Kryetar a ke fol me F.L.? M.Sh.*” (18:54)

Q.M.: “*me F.L.*” (19:07)

M.Sh.: “*Po, me F.L.*” (19:09)

Q.M.: “*Masneser shok. Jam i zene deri pasneser.*” (19:25)

M.Sh.: “*mos po na bahet von*” (19:25)

Q.M.: “*Vallahi nuk e dij shok. Ne tel nuk bahet pune.*” (19:26).

Trupi gjykues vëren se përkthyesi i gjykatës nuk pajtohet me përkthimin e prokurorisë të këtij SMS-i, duke e përkthyer atë në vend të tij si “*Më beso shok, nuk e di, nuk mund të bëjmë asgjë me telefon.*” Trupi gjykues bëri me dije se do ta pranojë përkthimin autoritativ të përkthyesit të caktuar nga gjykata.²¹⁷

ix. Një SMS i përgjuar nga M. Sh .për N.K. më 31 mars 2009 ku thuhet: “*Mirmrama N.K. aka tre nejsen kah ju?M.Sh..*”²¹⁸

x. Një SMS nga M.Sh.për A.G. më 31 mars 2009 ku thuhet: “*Mirmrama z. A.G. a ka naj imyt që ajo punë të kryhet? M.Sh. Gjilan.*”

xi. Në një SMS të përgjuar nga M.Sh.për F.L. nga 1 prilli 2009 thuhet: “*Ministër, a ka imyt a jo?*”²¹⁹

xii. Më 16 prill 2009, në SMS nga M.Sh.për F.L. thuhet: “*Ministër kompania T. e ka shpall vehten fitus te tenderit per mirmbajtjen verore ne bisedë me I. H. para një jave, a asht e vërtet kjo? Kompania I-E. Gjilan*” (21:06).²²⁰

²¹⁵ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe F.L. datë 30 mars 2009 në orën 11:27 dhe 11:29: Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr.100a dhe 100b, Regjistratori post-Aktakuzë IV-A.

²¹⁶ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe Q. M. datë 30 mars 2009 në orën 18:54, 19:07, 19:09, 19:25, 19:26, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr.100c-100h, Regjistratori post-Aktakuzë IV-A.

²¹⁷ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 28-29.

²¹⁸ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe N. K. datë 31 mars 2009 në orën 19:32: Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 102, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B.

²¹⁹ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe F.L.t datë 1 prill 2009 në orën 11:58, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 103a, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B.

²²⁰ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe F.L.t datë 16 prill 2009 në orën 21:06, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 103b, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B.

xiii. Në dy SMS të përgjuar të datës 29 prill 2009 nga .M.Sh.për F.L. thuhet:²²¹

“Zotri, qka foli qarshija e Gilanit kokakan e vertet te kan ble te kan pshtet per stene e ti ske qare pa lujt qysh te fyshllon taki²²².” (18:37)

“I harrove 150 vota qe i ke mar prej qytyne 30 puntorve qe kan prit qe10 vjet per pun e ti nuk i rrespektove. As sani sha koke i pa fjal i pa bes krejt qka te kan than qashtu koka kan kurr ma syt zdu me ti pa.” (18:51)

xiv. Biseda e mëposhtme me SMS ndërmjet M.Sh.dhe Q.M. e 20 majit 2009 ishte përgjuar:²²³

M.Sh: *“Pershendetje nese nuk anulohet mirmbajtja verore ditën e hanë i publikoj te gjitha.”*

Q.M: *“I ban dem vehtes me shume se F.L.. Shok mos e tepro se bahet mire. Krejt cka ben me tej ta prish punen ty e krejt PDK-se. E dij qe ke ba do investime po une kam investue qindra mija edhe ne kesh edhe ne humbje. Klm shume shok.”*

M.Sh.: *“E din qe ajo lami u kput shejo me fajin tim. F.L. e ka dit ket pun dhe i shkeli premtimet qe vet i ka i ka tan. Aj njeri nuk e qan koken as per parti as për kërkan. Dhe e shkeli rrespektin voten dh krejt ate qe e banem per te vetem per perfitim persanal. Sod krejt punojn ne rrim fun.”*

Q.M: *“Veç me durim se na vet ne komune ia dalim.”*

M.Sh: *“F.L. N.K.dhe I.Z. e kan ditë për këtë unë e tash të mos ankohen.”*

“Ishalla nat dunja nreqet se per kta u bitis.”

Q.M.: *“Ë cili I.Z, cka ka lyp I.Z. ne kete pune? Mos vet ...”*

“Jo more M.Sh. mos u dorezo se dynjaja eshte e gjate.”

M.Sh.: *“Vete I. Z. aj te tregon ma mir.”*

Q.M.: *“Po cka lypi I.Z. ne ate pune? A e ka ni qe ka lyp ryshfet a?”²²⁴*

M.Sh.: *“Pse po ban hajgare? Se e din edhe ti ket pun po i mer vesh prej te hanës e tanej te gjitha.”*

²²¹ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe F.L.t datë 29 prill 2009 në orën 18:37 dhe 18:51, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 104a dhe 104b, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B.

²²² “Taki” supozohet të jetë një gabim në shkrim nga .M.Sh.i emrit te kompanise “Kompania T.”.

²²³ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe Q. M. datë 20 maj 2009 në orën 11:58-21:23, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 107a-107 f, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B.

²²⁴ Për korrigjim të përkthimit shih Procesverbalin, 22 mars 2016, f.34; Shih po ashtu Procesverbalin, 23 mars 2016, f. 3, 6 (“Po cka lypi I.Z. në atë punë, a e ka ni qe ka lyp ryshfet a.”)

Q.M: “Nuk e dij shok pse ke komunikue me I.Z. per kete pune?”

M.Sh: “O njeri kjo pun ju ka dhan kompanise T. ne janar te ktij viti krejt ato fjale qe i thojke F.L. kur kem bashk aj rrejte.”²²⁵

Q.M.: “Merre ftofte kete pune. A po vjen ne ngushellime te F.L. te shtunen?”

M.Sh: “Zoti e past que ngenet M. me vjen keq po sun vi .”

Q.M.: “Ok. Shihemi shok.”

xv. Në tre SMS ndërmjet M.Sh.dhe .Q.M. datë 26 maj 2009 thuhet si më poshtë:²²⁶

Q.M.: “Shok, provo me ata ne prokurim me N.K. mos po te ben qare.”

M.Sh: “Nuk um ban qare veq nese eka urrnue dikush”²²⁷

Q.M.: “Shok, une nuk po mundem me komunikue me ta.”

xvi. Në një SMS të dërguar nga M.Sh.për E. K. më 10 qershor 2009 thuhet “Përhëndetje, a ke kontaktuar me kryetarin. Çka tha ai për atë që kam kërku Ponesh-Gadime M.Sh.Gjilan.”

xvii. Në një SMS të dërguar nga M.Sh.për E. K. më 13 qershor 2009 thuhet “Z. E.K. insisto qe te ma japin rrugen Bresalc Gadime se zban me met pa pun apet Q.M. po thot sun po takohna me ta.”²²⁸

xviii. Në një SMS tjetër të dërguar nga M.Sh.për E. K. më 7 gusht 2009 thuhet “Zotri E.K. at Tenderin qe kemi bisedue ja kan dhan qeter kuj. Kjo pun ka mar fun une nuk shuj ma dhe ska tedrejt kerkush mem than shuj kur punen nuk ma kryen.”²²⁹

- b. **“Informata në lidhje me korrupsionin e pretenduar”** e dërguar nga H. P., Drejtor i AKK-së, në PSRK (nuk ka datë, por është pranuar nga PSRK më 20 tetor 2009) (më tej “Informata e AKK-së”).²³⁰ Në këtë dokument raportohen deklaratat e dhëna nga M.Sh.për AKK-në, të përcjella në PSRK për hetim më

²²⁵ Një korigjim i vogël i përkthimit të Prokurorisë u bë nga përkthyesi i gjykatës, Procesverbali, 22 mars 2016, f 30-31.

²²⁶ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe Q. M. datë 26 maj 2009 në orën 10:55, 10:58, 14:25, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr.108a-108c, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B.

²²⁷ Përkthimi i Prokurorisë është korigjuar në Procesverbal, 23 mars 2016, f. 16-17.

²²⁸ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe E. K. datë 13 qershor 2009 në orën 7:34, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr. 108d, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B.

²²⁹ Transkripti i SMS ndërmjet M. Sh. dhe E. K. datë 7 gusht 2009 në orën 10:21, Përmbledhje e të dhënave të përgjimeve nr.108e, Regjistratori post-Aktakuzë IV-B; Përkthim i Prokurorisë është ndryshuar në Procesverbal, 26 janar 2017, f. 16.

²³⁰ ‘Informatat në lidhje me korrupsionin e pretenduar’, H. P., Drejtor i AKK-së, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 1-27.

të gjithanshëm. Informata e AKK-së jep, në mënyrë relevante për këtë tender, fjalë për fjalë.²³¹

“Pastaj, vazhdoi .M.Sh., ‘Më thirri Z. I. Z., Kryetar i degës së Partisë Demokratike në Gjilan, dhe e aranzhoi një takim për mua me zëvendësministrin A.G., dhe gjatë bisedës me A.G, erdhi F.L. dhe mendoj se ky takim u zhvillua në tetor të vitit 2008, dhe ne përsëri e filluam bisedën me Z. F.L dhe ai më tha mua: - Ti nuk duhet të flasësh më tej sepse Mirëmbajtja Verore (-si në shënimet origjinale të përkthyesit) për vitin 2009 do të jetë e jotja dhe mos oferto me kompaninë ‘S’. Unë i thashë se nuk mund ta kompletoj dokumentacionin vetë ku F.L. u përgjigj duke thënë se ata do të ma kompletojnë dokumentacionin. Pastaj në bisedë ndërhyri A.G. duke i thënë F.L. : - Si mund t’ia kompletojmë dokumentacionin atij. F.L.u përgjigj: - Do ta bëjmë përmes kompanisë RSM.”

“Sapo u shpall tenderi për Mirëmbajtjen Verore për vitin 2009, unë i mora dokumentet dhe e takova F.L. përsëri dhe i thashë atij: - Nuk kam ofertuar me askë tjetër pasi që ju më premtuat se do të ma kompletoni dokumentacionin.”

“Duke e parë që ata nuk mund të ma plotësonin dokumentacionin tim F.L.: - Ne nuk mund ta plotësojmë dokumentacionin tënd, por, plotësoje prapë atë me kompaninë ‘S’.”

“Pastaj unë shkova te menaxheri i prokurimit i MTT-së, N. K., dhe hyra në bisedë me të, gjatë kësaj bisede ai më kërkoi 20% të shumës totale të këtij tenderi dhe unë i thashë: - Nuk kam pare me ju dhanë. Ai më tha: - Ne do t’i qesim 20% të vlerës së tenderit si parapagim dhe ti do na i japësh këto neve (pra këto ishin fjalët e menaxherit, N. K., deklaroi M.Sh.). Kur unë i thashë se nuk kisha pare dhe nuk pranova atë çka më tha ai, ai mandej më tha: - Shko te F.L, ai të ka premtu dhe ai ka me e ba këtë për ty.”

“Më tej M.Sh.deklaroi, ‘Unë shkova prapë te F.L. dhe ai më tha që ta kompletoja dokumentacionin sërish me kompaninë ‘S.’ sepse nuk kishte mundësi që të kompletohej dokumentacioni.”

Në Informatën e AKK-së është e bashkëngjitur **letra** origjinale e **ankesës** së M.Sh.(po ashtu pa datë, e pranuar nga AKK më 6 maj 2009). Në pjesët relevante të kësaj letre thuhet:

“Mirëmbajtja e rrugës gjatë stinës së verës në rajonin e Gjilanit për vitin 2009, ne prisnim që njëri nga këto projekte të punës do të na takonte neve, madje edhe F.L. kishte premtuar, por nuk ndodhi, ne mbetëm pa punë.”²³²

“...Pasi që ne i kompletuam të gjitha dokumentet me saktësi ata caktuan një takim për mua me A.G. dhe F.L. Unë e ceka se çfarë më thanë: mos thuaj

²³¹ ‘Informatat në lidhje me korrupsionin e pretenduar’, H. P., Drejtor i AKK-së, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 4-5.

²³² ‘Informatat në lidhje me korrupsionin e pretenduar’, H. P., Drejtor i AKK-së, Regjistratori 19A, fashikull 1, f 9.

asgjë dhe me siguri gjatë verës ti do të kujdesesh për mirëmbajtjen e rrugës në rajonin e Gjilanit. Unë mendova se ju do të më thoni përsëri se dokumentet e mia nuk janë të kompletuara F.L., menjëherë A. G. veptoi, ti mos thuaj asgjë, F.L. tha se ne do t'i rregullojmë dokumentet me një kompani të quajtur RSM, dhe në lidhje me S. ai tha: Ai është më i keq se serbi dhe ai nuk mundet me marrë punë këtu. Stina e verës 2009 erdhi dhe përsëri mirëmbajtja e rrugës iu dha Kompanisë T., si zakonisht ...”²³³

“I kam 30 punëtorë dhe ne t'i kemi dhanë 150 vota dhe ju po na trajtoni më keq se serb, ju i jepni serbit të Zubin Potok shumë punë çdo vit por kurrë neve”²³⁴

- c. Dëshmia e **B. Sh.** është përmbledhur më parë në paragrafin 124 më lart. Në lidhje me këtë tender, dëshmitarit nuk i kujtohet ta ketë dëgjuar babain e tij ndonjëherë t'i kishte thënë atij se: F.L., në prani të A.G., i kishte thënë M.Sh.se nëse ai do të rrinte i qetë mirëmbajtja verore për vitin 2009 do të ishte e tij;²³⁵ N.K. kishte kërkuar ryshfet prej 20% të vlerës së tenderit;²³⁶ .M.Sh.u takua me E.K.²³⁷
- d. **Q.M.**, dëshmia e të cilit është diskutuar më parë në paragrafët 124 dhe 144, nuk ishte në gjendje t'i kujtojë SMS-ët specifike të ndërguar ndërmjet tij personalisht dhe .M.Sh., por konfirmoi se atij i kujtohej përmbajtja dhe fryma e komunikimeve të tyre dhe pranoi se mesazhet që iu prezantuan atij ishin të saktë.²³⁸

Në lidhje me përgjimet e SMS të 19 marsit 2009, dëshmitari konfirmoi se M.Sh. kishte kërkuar nga ai që të merrte pjesë në takimet me F.L. “vazhdimisht”²³⁹ dhe i kishte dërguar mesazhe të ngjashme nga “3-4 herë në ditë”.²⁴⁰ .M.Sh.i kishte kërkuar Q.M. që të fliste me F.L dhe ai ishte pajtuar.²⁴¹ Atij nuk i kujtohet nëse .M.Sh.i kishte kërkuar atij që të fliste me F.L. në mënyrë specifike në lidhje me Tenderin 009-004-511, por supozoi se ai e kishte bërë.²⁴² Dëshmitari në të vërtetë i kishte kërkuar F.L. që ta takonte M.Sh.disa herë për shkak se ky i fundit “ishte militant partiak i partisë sime, ai ishte aktivist i mirë, ai ishte punëtor i madh, ai ishte një person familjar.”²⁴³ Megjithatë, dëshmitari nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në ndonjë takim

²³³ ‘Informatat në lidhje me korrupsionin e pretenduar’, H. P., Drejtor i AKK-së, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 11.

²³⁴ ‘Informatat në lidhje me korrupsionin e pretenduar’, H. P., Drejtor i AKK-së, Regjistratori 19A, fashikull 1, f. 12.

²³⁵ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 20.

²³⁶ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 20-21.

²³⁷ Procesverbali, 25 tetor 2016, f. 21-22.

²³⁸ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 24, 32-35; 23 mars 2016, f. 5, 7; 19 prill 2016, f. 17.

²³⁹ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 23.

²⁴⁰ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 24.

²⁴¹ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 24-25; 19 prill 2016, f. 15-16.

²⁴² Procesverbali, 22 mars 2016, f. 25.

²⁴³ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 24, 26; 19 prill 2016, f. 8.

me .M.Sh.dhe F.L..²⁴⁴ Ai e sqaroi se ai nuk foli në emër të .M.Sh., por kishte ndërmend që vetëm t'ia jepte atij mundësinë që të takohej me F.L. si dhe, para se gjithash, ta hiqte nga shpina .M.Sh..²⁴⁵

Q.M. i kujtohet ose pranoi disa SMS-ë ndërmjet tij dhe M.Sh.të dërguar më 30 mars²⁴⁶ dhe 20 maj 2009.²⁴⁷ Ai dy herë e konfirmoi se ankesa e .M.Sh.në këtë datën e dytë lidhej me Tenderin 009-004-511,²⁴⁸ para se ky i dyti të mohonte se ai e dinte se për çfarë ishin ato.²⁴⁹ Dëshmitari u mor në pyetje gjerësisht në lidhje me relacionin e tij me SMS-in e tij të datës 20 maj 2009: "*Po cka lypj I.Z. ne ate pune? A e ka ni qe ka lyp ryshfet a?*" Atij i kujtohet ta ketë pyetur M.Sh.lidhur me përfshirjen e I. Z. gjë që, sipas dëshmitarit, kërkonte shpjegim pasi që ky i fundit më shumë ishte kryetar i degës së PDK-së në Gjilan se sa asambleist i komunës ose anëtar i MTPT-së dhe kështu nuk do të duhej të kishte asnjë përfshirje në tendera.²⁵⁰ Q.M. pohoi se ai e kishte pyetur .M.Sh.për ndonjë ryshfet për shkak se posti i tij politik e bënte atë të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe, i shtyrë nga kërcënimi i .M.Sh.se do të "*bëjë publike çdo gjë*", .Q.M. ishte i interesuar të zbulonte nëse ndonjëri kishte kërkuar ose pranuar ryshfet, d.m.th., çfarë do të publikonte .M.Sh..²⁵¹ Sipas dëshmitarit, përkthimi do të duhej të ishte: "*A kishte dëgjuar ai se dikush po kërkonte ryshfet?*"²⁵² Përkundrazi, dëshmitari e mohoi se ai e dinte se dikush kishte kërkuar ryshfet ose se ai po i referohej F.L.²⁵³

Në fund, Q.M. nuk i kujtohej nëse M.Sh.i kishte thënë ndonjëherë atij se F.L.i kishte premtuar atij mirëmbajtjen verore në rajonin e Gjilanit në vitin 2009 por që nuk ia kishte dhënë atë atij;²⁵⁴ nëse .M.Sh.i kishte thënë atij se qoftë z. F.M. ose N.K. dëshironin një ryshfet prej 20% të vlerës totale të tenderit që do të jepej për mirëmbajtjen verore dhe dimërore për rajonin e Gjilanit për vitin 2009 dhe 2010;²⁵⁵ ose që mirëmbajtja në fund i ishte dhënë kompanisë T.-t.²⁵⁶

Në lidhje me shkëmbimin e SMS-ve të 26 majit 2009 nga ana e tyre, në të cilin .Q.M. sugjeroi që .M.Sh.të fliste me N.K. për të parë nëse "*ai mund të bënte diçka*", dëshmitari dëshmoi se ai nuk e njihte N.K. në atë kohë por vetëm postin e tij si Drejtor i Prokurimit i MTPT-së.²⁵⁷ Dëshmitari e shpjegoi

²⁴⁴ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 24; 19 prill 2016, f. 16.

²⁴⁵ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 25; 19 prill 2016, f. 16.

²⁴⁶ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 27-29.

²⁴⁷ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 30, 32-35.

²⁴⁸ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 31-32, 35.

²⁴⁹ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 13.

²⁵⁰ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 34-35, 37; Shih po ashtu 23 mars 2016, f. 7.

²⁵¹ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 35-36; 23 mars 2016, f. 3, 11-13.

²⁵² Procesverbali, 23 mars 2016, f. 11.

²⁵³ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 8, 14.

²⁵⁴ Procesverbali, 20 prill 2016, f. 10.

²⁵⁵ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 26-27; 20 prill 2016, f. 14.

²⁵⁶ Procesverbali, 20 prill 2016, f. 10.

²⁵⁷ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 15-16; 19 prill 2016, f. 18, 22.

sërisht ndërhyrjen e tij duke qenë i motivuar nga fakti se z.M.Sh. *“ishte një aktivist i mirë i PDK-së, dhe natyrisht unë e doja atë afër vetes si aktivist i partisë, dhe se kjo ishte arsyeja që unë vazhdimisht komunikoja me të.”*²⁵⁸ Ai e kishte drejtuar M.Sh.për te N.K., gjersa pohon se ai vetë *“nuk mund të komunikojë me ta”*, sepse ai donte që ai të hiqte dorë nga tenderët e rrugëve pa i prishur komunikimet e tyre,²⁵⁹ dhe supozonte se N.K. do t’ia shpjegonte .M.Sh. kriteret ligjore dhe teknike që ai duhet t’i përmbushte për t’iu dhënë çfarëdo tenderi për ndërtim të rrugës.²⁶⁰

.Q.M. e përshkroi .M.Sh.si *“i frustruar”*²⁶¹ dhe mendonte se ky frustrim ishte burim i kërcënimeve të tij.²⁶² Ai dëshmoi se kompania e .M.Sh., I-E., nuk merrej me ndërtim rrugësh po më shumë me dru, karburante dhe furnizim me ushqime .²⁶³ Si rezultat, ai nuk ishte i kualifikuar, i mungonte ekspertiza teknike dhe profesionale që t’i jepeshin tenderë për ndërtim të rrugëve.²⁶⁴ .Q.M. deklaroi se .M.Sh.:

*“gjithnjë shprehte pakënaqësi me mua, me të tjerët, sepse vazhdimisht po kërkonte projekte të mëdha dhe punë të mëdha, pavarësisht faktit se ai nuk i kishte as minimumin e kapaciteteve, as profesionale e as teknologjike për të kryer detyrat ... ai mori pjesë në shumë tenderë dhe ai shprehte pakënaqësinë e tij atje. Ai gjithmonë mendonte se dikush ishte i padrejtë ndaj tij, por në fakt ai nuk ishte i përgatitur as teknologjikisht ose profesionalisht ... ai ishte një person shumë punëtor, por vendi i tij ishte diçka tjetër; ajo ishte në prerjen e druve të zjarrit dhe gjithashtu në biznesin e hoteleve që shfrytëzoheshin për dasma, por jo infrastruktura”*²⁶⁵

Në fund, .Q.M. e përsëriti se akuzat që ndodheshin në SMS-ët e M.Sh.e përfaqësonin vetëm *“opinionin”*²⁶⁶ personal të .M.Sh.me të cilin z.Q.M. nuk mund të pajtohej pasi që ai nuk ishte në posedim të fakteve për ta mbështetur atë.²⁶⁷ .Q.M. e mohoi se kishte çfarëdo dijenie që F.L. ose E.Sh. të kishin kërkuar ryshfet gjersa ishin të punësuar në MTPT.²⁶⁸

- e. **I. Z.**, kryetar i degës së PDK-së Gjilan mes viteve 2008 dhe 2012,²⁶⁹ dëshmoi se në këtë rol ai kishte kontakte me shumë anëtarë të PDK-së, përfshirë Q. M., F.L.n dhe A. G..²⁷⁰ Ndonëse shumë ngurrues për ta konfirmuar se ai kishte

²⁵⁸ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 15.

²⁵⁹ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 17-18; 19 prill 2016, f. 19, 21.

²⁶⁰ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 15-16; 19 prill 2016, f. 21.

²⁶¹ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 24.

²⁶² Procesverbali, 22 mars 2016, f. 27.

²⁶³ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 14-15; 19 prill 2016, f. 9; 20 prill 2016, f. 10.

²⁶⁴ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 15, 17; 19 prill 2016, f. 8-9, 19; 20 prill 2016, f. 8-10.

²⁶⁵ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 25.

²⁶⁶ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 32-33; 23 mars 2016, f. 17.

²⁶⁷ Procesverbali, 22 mars 2016, f. 36

²⁶⁸ Procesverbali, 23 mars 2016, f. 9-10; 19 prill 2016, f. 16-17, 21; 20 prill 2016, f. 14.

²⁶⁹ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 5-6.

²⁷⁰ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 6-7.

diskutuar për projektet e ndërtimit të rrugëve në Gjilan me zyrtarë të tjerë të PDK-së, ai e pranoi se diskutimet e tilla ishin vetëm në kontekst të diskutimit të programit zhvillimor të PDK-së për atë komunë.²⁷¹ Dëshmitari fuqishëm e mohoi të kishte diskutuar ndonjëherë procedura të ndonjë tenderi të caktuar me z.Q.M. ose të kishte diskutuar procedurat e tenderit vetëm me z.Q.M., por refuzoi t'i jepte emrat e personave të tjerë të pranishëm në takimet në fjalë.²⁷² I.Z. e mohoi të kishte diskutuar ndonjëherë qoftë çështjen e ryshfetit në dhënën e tenderëve për ndërtimin e rrugëve, ose të ankesave të .M.Sh., me .Q.M..²⁷³ Ai deklaroi se ai nuk kishte folur me F.L. në lidhje me projektet e ndërtimit të rrugëve në Gjilan.²⁷⁴

I.Z. pretendonte se ai asnjëherë nuk kishte dëgjuar për dikë në MTPT që jepte tendera për ndërtim rrugësh në shkëmbim të ryshfetit,²⁷⁵ por nëse ai do të merrte informacion të tillë ai do ta kishte raportuar tek autoritetet gjegjëse.²⁷⁶ Ai dëshmoi se, duke qenë nga Gjilani, ai e njihte 'F.Z.' që ishte pronar i T.-t (ndonëse nga ai nuk u kërkuar që ta identifikonte atë në sallën e gjyqimit)²⁷⁷ si dhe .M.Sh.e I-E.²⁷⁸ dhe e pranoi vërtetësinë e deklaratës së tij të mëhershme dhënë EULEX-it se .M.Sh.:

*"gjithmonë ka insistuar të takohemi në ministri dhe të bisedojmë. Përshtypja e tij ishte se ai ishte i diskriminuar... për sa i përket tenderëve, dhe ai donte të bisedonte me ta pse kjo i kishte ndodhur atij. Pas luftës, M Sh, në të vërtetë nuk ishte marrë me asfaltimin e rrugëve, ai kishte biznese të tjera. Por, para luftës ai ishte marrë dhe kishte pajisje më të mira se të tjerët. Pas luftës ai merrej me furnizim ushqimi dhe biznes të hotelarisë dhe kishte një pompë të benzinës."*²⁷⁹

I.Z. e konfirmoi se M.Sh.i kishte kërkuar atij që të organizonte takim me zyrtarët e MTPT-së, duke përfshirë F.L A.G. dhe të tjerët, dhe se ai në të vërtetë kishte kërkuar nga A.G. të takohet me M.Sh..²⁸⁰ Ai shtoi:

"M.Sh.nuk ishte i kënaqur me PDK-në në Gjilan dhe për gjitha projektet për të cilat ai konkurroi dhe nuk u shpërblye ai ishte i pakënaqur për këtë edhe pse ai asnjëherë nuk i plotësonte kushtet sepse kushtet janë të nxjerra në mënyrë të prerë në Ligjin e Prokurimit. Qëllimi i tij ishte që me çdo kusht të takohet me ndokënd nga qeveria, duke filluar nga Kryeministri dhe teposhtë dhe unë si udhëheqës i partisë e ndjeja si obligim që t'ia arranzhoja atë takim

²⁷¹ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 7-8, 11-13; 16 maj 2016, f. 22-23.

²⁷² Procesverbali, 28 prill 2016, f. 12-14; 16 maj 2016, f. 23.

²⁷³ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 23-24.

²⁷⁴ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 10.

²⁷⁵ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 14.

²⁷⁶ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 14-15; 16 maj 2016, f. 16.

²⁷⁷ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 8.

²⁷⁸ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 8-9; 16 maj 2016, f. 3.

²⁷⁹ Procesverbali, 28 prill 2016, f. 9-10.

²⁸⁰ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 18-19.

nëse ai donte që të takohej me anëtarë të lartë të partisë apo ndokënd në nivel më të ultë sepse ai ishte anëtar i partisë dhe këtu çdo gjë përfundoi me mua.”

I.Z. tha se .M.Sh. asnjëherë nuk i ishte ankuar atij personalisht se nuk po merrte tenderë për ndërtim të rrugëve.²⁸¹ Megjithatë, .M.Sh. kishte një *“personalitet agresiv”* dhe rëndom ankohej se *“ai nuk po trajtohej si duhet”* në dhënien e tenderëve nga MTPT dhe të tjerët.²⁸²

I.Z. mori një kopje të, dhe e lexoi, letër ankesa e .M.Sh. por nuk i kujtoheshin pretendimet që përmbante ajo.²⁸³ Ai shpjegoi se ai nuk e kishte marrë seriozisht përmbajtjen e saj ose që ta raportonte atë tek autoritetet, pasi që çdo qytetar kishte të drejtë të ankohej (ajo ishte *“vetëm një copë letër”*, e pambështetur në prova) dhe se tashmë ajo u ishte dërguar të gjitha institucioneve relevante nga vetë .M.Sh..²⁸⁴ Më tej, dëshmitari pohon se .M.Sh.asnjëherë nuk ia kishte treguar atij ndonjërin nga këto: se F.L. ia kishte premtuar atij tenderin për ndërtimin e rrugës Phonesh-Zhegovc në prani të z. N.K, A. G. dhe të tjerëve;²⁸⁵ se F.L. i kishte thënë .M.Sh.se mirëmbajtja verore (Gjilan 2009) do të ishte e tij nëse ai to të heshtte;²⁸⁶ se atij i ishte kërkuar ryshfet;²⁸⁷ se F.L. i kishte thënë se ai mund t’ia ‘rregullonte’ dokumentet e tij të tenderit përmes kompanisë ‘RMS’;²⁸⁸ se F.L. më vonë e kishte shmangur ta takonte M.Sh., para se ta drejtonte atë të fliste me N.K.;²⁸⁹ se N.K. i kishte thënë .M.Sh.se ata prisnin që ai të paguante 10% të vlerës së tenderit;²⁹⁰ se kur .M.Sh.i tregoi N.K. se ai nuk kishte para, N.K. e këshilloi atë që *“ne do të depozitojmë tek ti 20% të shumës totale paraprakisht dhe ti pastaj do të na i japësh neve këto të holla”*.²⁹¹ Kur prokurori ia paraqiti dëshmitarit SMS-in e dërguar atij nga z.M.Sh.më 29 mars 2009 (*“I.Z. nëse nuk të pengon çoja një SMS A.G. para se mu ba shumë vonë nëse ata dështojnë edhe këtë herë unë do t’i hapi kartat e mia, M.Sh.”*), I.Z. pretendon se ai *“nuk kishte ide”* se çfarë po mendonte .M.Sh. dhe nuk i kishte marrë mesazhet e tij seriozisht sepse M.Sh.ishte i *“revoltuar për çdo gjë”* dhe *“ishte i interesuar të takohej me çdo anëtar të qeverisë së Kosovës.”*²⁹²

²⁸¹ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 9.

²⁸² Procesverbali, 16 maj 2016, f. 9-10.

²⁸³ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 10-16, 26.

²⁸⁴ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 10-17.

²⁸⁵ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 17-18.

²⁸⁶ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 19.

²⁸⁷ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 19-20.

²⁸⁸ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 20.

²⁸⁹ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 21.

²⁹⁰ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 21.

²⁹¹ Procesverbali, 16 maj 2016, f. 21.

²⁹² Procesverbali, 20 maj 2016, f. 15, 17-18.

- f. **A. G.**, dëshmia e të cilit më parë është trajtuar në paragrafin 124, dëshmoi se ai asnjëherë nuk e kishte diskutuar për ndonjë projekt specifik të ndërtimit të rrugës me N.K.,²⁹³ dhe se nuk kishte autoritet që t'i jepte udhëzime z. N.K.²⁹⁴

A.G. e konfirmoi se ai e njeh I. Z., komunikonte me të përmes telefonit dhe SMS-it, dhe – bazuar në raportet e tij me familjen I.Z. – ishte i prirë të lexonte dhe t'i përgjigjej SMS-ve të tij.²⁹⁵ Prokurori ia paraqiti dëshmitarit dy SMS-ë që i ishin dërguar atij nga z. I.Z., ku thuhej:²⁹⁶

“Z. Zëvendësministër, në çfarë kohe mundesh me pritë M. Sh., ai është në Prishtinë, Shëndet (përshëndetje) I.Z..” (11 mars 2009)

dhe

“Zëvendësministër merre parasysh .M.Sh.. Ju faleminderit për mirëkuptim. I.Z.” (24 mars 2009)

Përveç tjerash, prokuroria ia paraqiti z. A.G. SMS-ët e dërguar nga .M.Sh.për dëshmitarin:²⁹⁷

““Zotri zavens a jan fjalt qysh mikini than ne Nandor per mirëmbajtjen verore?M.Sh.Gjilan.” (23 mars 2009)

dhe

“Mirmrama z. A.G. a ka naj imyt që ajo punë të kryhet? M.Sh., Gjilan.” (31 mars 2009)

Dëshmitari dëshmoi se atij nuk i kujtohet t'i ketë marrë këta SMS-ë,²⁹⁸ ose se . I.Z. të kishte kërkuar nga ai që të takohej me M. Sh.²⁹⁹ Ai nuk e njihte dhe nuk e kishte takuar asnjëherë z.M.Sh.,³⁰⁰ dhe i shpjegoi SMS-ët nga M.Sh.për të si *“provokim i dobët”*.³⁰¹

- g. **E. K.** ishte anëtar i kryesisë së PDK-së që nga themelimi i saj në vitin 1999,³⁰² i cili kishte shërbyer si zëvendësministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor prej janarit 2008 deri në qershor 2010, dhe zëvendësministër i MTPT-së prej qershorit të vitit 2010 deri në vitin 2013.³⁰³ Dëshmitari dëshmoi se ai e njihte z.M.Sh.pasi që ata ishin nga komuna e njëjtë

²⁹³ Procesverbali, 14 mars 2017, f. 25-26.

²⁹⁴ Procesverbali, 14 mars 2017, f. 26.

²⁹⁵ Procesverbali, 15 mars 2017, f. 12.

²⁹⁶ Procesverbali, 15 mars 2017, f. 12-13.

²⁹⁷ Procesverbali, 15 mars 2017, f. 14-15.

²⁹⁸ Procesverbali, 15 mars 2017, f. 13, 16.

²⁹⁹ Procesverbali, 15 mars 2017, f. 14.

³⁰⁰ Procesverbali, 15 mars 2017, f. 13-15, 17.

³⁰¹ Procesverbali, 15 mars 2017, f. 15.

³⁰² Procesverbali, 26 janar 2017, f. 6-7.

³⁰³ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 7, 18.

dhe kishin një raport familjar.³⁰⁴ E.K. besonte se biznesi i .M.Sh.ishte me zallë dhe transport, por nuk ishte i sigurt.³⁰⁵

.M.Sh. shpesh i ka telefonuar ose i ka dërguar mesazhe dëshmitarit, “*por kishte aq shumë kërkesa sa që edhe po të isha SHBA nuk do të kisha mundur të ia plotësojë kërkesat e tij*” dhe dëshmitari shpeshherë ka qenë shumë i zënë për t’iu përgjigjur atij.³⁰⁶ Kjo është konfirmuar në lidhje me dy SMS-të e dërguara nga E.K. tek .M.Sh., ku shkruante “*M.Sh.jemi në një konferencë. Do t’ju telefonojmë më vonë, përshëndetje EK*” (12 qershor 2009, 17:44) dhe “*I nderuari .M.Sh., jam në një konferencë për decentralizim. Përshëndetje.*” (17 qershor 2009, 15:15). Dëshmitarit nuk i kujtohej saktësisht se për çfarë e merrte në telefon .M.Sh.në secilin rast, por sugjeroi se mund të kishte kërkuar punë.³⁰⁷

E.K.t i kujtohet se .M.Sh.kishte kërkuar ndihmën e tij për marrjen e kontratave për ndërtimin e rrugëve me MTPT-në.³⁰⁸ Dëshmitari ka dëshmuar se ai e ka këshilluar .M.Sh.që të ofertoj/konkurroj dhe që rezultati do të përcaktohej në bazë të ligjit në fuqi.³⁰⁹ Ai nuk e dinte nëse .M.Sh.ka ofertuar ndonjë herë për kontrata të tilla apo çfarë ka ndodhur më pastaj.³¹⁰

Prokurori ia paraqiti dëshmitarit SMS-të e dërguara nga .M.Sh. tek dëshmitari më 10 qershor 2009 (“*Përshëndetje, a ke kontaktuar me kryetarin. Çfarë tha për atë që kam pyetur Ponesh-Gadime M.Sh.Gjilan*”). E.K. konfirmoi se është një segment i rrugës Ponesh-Gadime; se .M.Sh.sigurisht ka pyetur për atë; dhe se me ‘kryetarin’ ai ka mundur të nënkuptojë kryetarin e PDK-së, H. Th.³¹¹ Ai më tutje ka sqaruar përsëri se .M.Sh.“*ka kërkuar ndihmën time dhe unë i kam thënë që mund të konkurrosh dhe se ekzistojnë rregulla dhe rregullore të cilat duhet t’i përmbushësh*” dhe se ai nuk ka biseduar me H. Th. në emër të z. M.Sh.³¹²

Prokurori ia paraqiti E.K.t një SMS i cili i ishte dërguar atij nga z.M.Sh.më 13 qershor 2009, ku thuhej “*. E.K. insistoni që të më jepet mua rruga Bresalc Gadime sepse nuk mund të mbetem përsëri pa punë. Q.M. po thotë se nuk po mund të takohem me ata. Pse nuk erdhi ai/ajo me kryetarin?*”³¹³ Dëshmitari konfirmoi se ‘Q.M.’ ka qenë Q.M.; se me ‘ata’ sigurisht ka nënkuptuar kryesia

³⁰⁴ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 10.

³⁰⁵ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 12.

³⁰⁶ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 10-13.

³⁰⁷ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 12-13.

³⁰⁸ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 13-14.

³⁰⁹ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 13-14.

³¹⁰ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 13-14.

³¹¹ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 14.

³¹² Procesverbali, 26 janar 2017, f. 14.

³¹³ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 14-15.

e PDK-së; dhe se .M.Sh.sigurisht ka kërkuar ndihmën e tij për shkak të marrëdhënieve të tyre familjare.³¹⁴

E.K.t nuk i kujtohej nëse .M.Sh.i ka diskutuar ndonjëherë me atë përpjekjet e tij për ta fituar tenderin për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve rajonale të rajonit të Gjilanit 2009-2010, duke shtuar se “*edhe nëse e ka diskutuar këtë ka qenë e parëndësishme për mua.*”³¹⁵ Atij nuk i kujtohej nëse .M.Sh.e ka kërcënuar ndonjëherë që t’i bëjë publike si rezultat i mos fitimit të tenderit, por e ka përshkruar M.Sh. me temperament.³¹⁶ Prokurori ia paraqiti E.K.t SMS-të që i ishin dërguar atij nga z.M.Sh.më 7 gusht 2009 (“*E.K. atë tenderin për të cilin kemi biseduar ata ia kanë dhënë diku tjetër kjo punë ka përfunduar unë nuk do të mbetem i heshtur apo nuk do ta mbylli gojën më dhe askush nuk ka të drejtë që të më thotë që të heshti kur ata nuk e kryejnë punën për mua*”). Dëshmitari ka dëshmuar se nuk e ka ditur: cilit tender po i referohej .M.Sh.; kush i kishte thënë M.Sh. që të heshtë; ose që .M.Sh.është ankuar në AKK.³¹⁷

A ia ka premtuar F.L. mirëmbajtjen për vitin 2009 M.Sh.?

173. Trupi gjykues më pas shqyrtoi nëse prokurori ka kryer barrën e të provuarit në lidhje me pretendimin se, në tetor ose nëntor 2008, F.L. ka premtuar M.Sh. mirëmbajtjen verore të vitit 2009 në prani të A.G.
174. Në dëshminë e tij para gjykatës z. I.Z. ka konfirmuar se i kishte kërkuar A.G. që të takohet me M.Sh, por nuk e dinte se çfarë ka ndodhur më pas. Trupi gjykues ka vërejtur se SMS-të e dërguara nga z. I.Z. te A.G. që përmbajnë këtë kërkesë (siç i është paraqitur nga prokurori A.G.) janë të datës 11 dhe 24 mars 2009, domethënë rreth gjashtë muaj pas pretendimit të mbajtjes së takimit - një fakt në mospërputhje me narracionin e prokurorit për ngjarjet. Sidoqoftë, edhe me pranimin se z. I.Z. ia ka bërë një kërkesë të pa dokumentuar A.G., nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar se një takim i tillë në të vërtetë ka ndodhur, e lëre më të dihet se kush ka marrë pjesë apo çfarë është thënë.
175. Në veçanti, A.G, i cili pretendohet nga prokurori se ka qenë i pranishëm në takim, ka deklaruar se nuk i kujtohet pranimi i këtyre SMS-ve ose që z. I.Z. i ka kërkuar atij që të takohet me M.Sh ndonjëherë tjetër. Ai gjithashtu ka mohuar se ishte takuar ndonjëherë me M.Sh. Sinqeriteti i pohimit të A.G. se ai kurrë nuk i ka lexuar SMS-të e I.Z lidhur me M.Sh mund të jetë i dyshimtë, duke u bazuar në dëshminë e tij të mëparshme se ai kishte respekt të lartë për I.Z dhe familjen e tij dhe prandaj i lexonte dhe i përgjigjej SMS-ve të tij. Edhe nëse do ta pranonte trupi gjykues se z. A.G. i lexonte SMS-të, sidoqoftë, kjo nuk do të tregonte asgjë lidhur me atë nëse ai

³¹⁴ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 15.

³¹⁵ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 15-17.

³¹⁶ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 16.

³¹⁷ Procesverbali, 26 janar 2017, f. 16-17.

- ka vepruar sipas kërkesë dhe është takuar me M.Sh. apo çfarë ka ndodhur në ndonjë takim të tillë.
176. Prandaj, prova se z. F.L. i ka premtuar M.Sh. dhënien e mirëmbajtjes verore për vitin 2009, dhe 'rregullimin' e dokumentacionit të tij për tender për këtë qëllim, e ka origjinën nga vetë M.Sh.. Kryesisht është në formën e SMS-ve të dërguar nga .M.Sh. tek individë të ndryshëm që aludojnë se i është premtuar ky tender nga z. F.L. në tetor/nëntor 2008 (shin në veçanti: SMS-të tek A.G. të 23 marsit 2009; SMS-të te z. I.Z. më 29 mars 2009; dy SMS-të te F.L më 30 mars 2009; SMS-të e dërguar F.L. më 29 prill 2009 në ora 18:51; SMS bisedat me Q.M. të 20 majit 2009). Këto pretendime janë shtjelluar në letër ankesën e Q.M. dhe informatën e AKK-së.
177. Trupi gjykues thekson se, sipas kushteve të qarta të nenit 262 (1) të KPP-së, nuk është në gjendje ta gjejë të akuzuarin fajtor "*vetëm, ose në një masë vendimtare, mbi ... provat të cilat nuk kanë mundur të kundërshtohen nga i pandehuri ose avokati mbrojtës përmes marrjes në pyetje gjatë fazës së procedurës penale*". Në rastin konkret, të gjitha provat fajësuese vijnë nga .M.Sh., tregimin e të cilit për ngjarjet, mbrojtja nuk ka pasur kurrë mundësi ta vërtetojë. Se pretendimet e M.Sh. paraqiten në forma të ndryshme (SMS, letër ankesa, informata e AKK-së), apo se .M.Sh.ka qenë konsekuent në pretendimet e tij, nuk e tejkalon këtë kufizim. Thënë ndryshe, provat e ndryshme që vijnë nga .M.Sh.nuk mund të përdoren për ta vërtetuar njëra-tjetrën.
178. Trupi gjykues vëren se dëshmitarët e Prokurorisë - Q.M.,I.Z.,A.G.,E.K. - vazhdimisht kanë tentuar ta minimizojnë seriozitetin dhe vërtetësinë e pretendimeve të M.Sh dhe kanë përsëritur, gati fjalë për fjalë, tema kyçe të teorisë së mbrojtjes z.M.Sh .nuk i kishte kualifikimet e duhura për t'iu dhënë tenderët në fjalë, se biznesi i tij ishte një pompë e derivateve, furnizimi me ushqim dhe dru, se ai ankohej vazhdimisht dhe gjerësisht, se ishte agresiv, etj.). Përveç kësaj, disa – përfshirë djalin e ndjerë të M.Sh. B.Sh.– ka mohuar se kishte ndarë ndonjëherë me ta pretendimet e tij për korrupsion brenda MTPT-së. Trupi gjykues ka gjetur këto mohime të jenë tejet të pabesueshme dhe vetë-shërbyese.
179. Në lidhje me këtë,. I.Z. ka pohuar se M.Sh. asnjëherë nuk i kishte thënë se F.L. i kishte premtuar atij tenderin dhe "rregullimin" e dokumenteve të tij ose se N.K. i kishte kërkuar ryshfet në shumë prej 20% të vlerës së tenderit, pavarësisht (a) pranimit të z. Zekës se ai e ka pranuar dhe lexuar ankesën e M.Sh. e cila i përmban këto pretendime; (b) SMS i M.Sh. dërguar te I.Z. i 29 marsit 2009 duke kërcënuar "*të hapte duart*", që në mënyrë të qartë nënkuptonte njohurinë e I.Z për atë që .M.Sh. kishte për qëllim të hapte duart; dhe (c) pohimi i përgjithshëm se z .M.Sh. "*ankohej për gjithçka*", goxha në mospërputhje me dështimin e M.Sh për t'u ankuar për këtë.
180. Në mënyrë të ngjashme, E.K. ka mohuar se z.M.Sh.i ka ndarë ndonjëherë ankesat e tij me të, përkundër një SMS-i nga z.M.Sh. dërguar te ai që i referohej qartë

diskutimit të tillë mes tyre (dmth. "... Unë nuk do të hesht më dhe askush nuk ka të drejtë të më thotë të heshti kur ai ose ajo nuk ma kreu punën.")

181. Q.M. ndryshonte qëndrimin në pyetjen nëse .M.Sh. kishte biseduar me atë lidhur me këtë procedurë specifike të tenderit (009-004-511). Trupi gjykues nuk është bindur nga shpjegimi i Q.M. për bisedën e tij me SMS me M.Sh. më 20 maji 2009, në veçanti kur ai e pyeti M.Sh. lidhur me ryshfetin, sepse pozita e tij politike e bënte atë të ndjeshëm ndaj pretendimeve për korrupsion dhe për këtë arsye donte të dinte nëse dikush kishte kërkuar/ofruar ryshfet. Përkundrazi, është e qartë se .M.Sh.më parë i kishte diskutuar pretendimet e tij për korrupsion të MTPT-së me Q.M. Në këtë shkëmbim të SMS-ve, vetë z.Q.M. e paraqet emrin e F.L., i pa nxitur nga .M.Sh.. Më tutje, konteksti i bisedës - ku përmenden emrat e F.L. dhe N. K. në disa SMS të mëparshëm - e bën të qartë se .M.Sh.i kishte thënë Q.M se ose F.L. ose N.K. i kishin kërkuar ryshfet.
182. B.Sh., i cili ishte i punësuar në *I-E*. në kohën përkatëse dhe i cili do të kishte qenë në pozitë të ketë njohuri të dorës së parë për ankesat e qarta të bëra gjerësisht nga babai i tij, mori qëndrim të dyshimtë: "*Nuk di asgjë. Unë nuk kam folur asgjë në lidhje me ministrin. Nuk mbaj mend asgjë.*"³¹⁸
183. Sidoqoftë, madje edhe nëse trupi gjykues do të refuzonte këto deklaratat dhe të pranonte të kundërtën, përkatësisht se .M.Sh. kishte diskutuar pretendimet e tij për korrupsion në MTPT me Q.M. I.Z. dhe djalin e tij B. Sh., kjo nuk do ta ndryshonte përfundimin e tij të mësipërm. Saktësia e një pohimi nuk mund të forcohet nga përsëritja e tij dhe këto deklaratat nuk mund të përdoren për të vërtetuar thelbin e pretendimeve të M.Sh.; në rastin më të mirë, ato mund të tregojnë se .M.Sh.ka qenë konsekuent në këtë. Kompania B. i vetëm, i pavërtetuar i pretendimeve për korrupsion mbetet vetë .M.Sh..
184. Për këto arsye, trupi gjykues ka gjetur se prokuroi nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L. ia ka premtuar M. Sh., Mirëmbajtjen Verore dhe Dimërore të Rrugëve Rajonale të Kosovës për Rajonin e Gjilanit për vitin 2009-2010 (Tenderi 009-004-511) në tetor ose nëntor 2008, dhe prandaj nuk e ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare si ministër i MTPT-së.

A i ka kërkuar N.K. ryshfet 20% të vlerës totale të tenderit M.sh.?

185. Trupi gjykues më pas iu drejtua pretendimit të dytë kryesorë të prokurorit për marrëveshje me M.Sh. përkatësisht se: në mars të vitit 2009, .M.Sh.ka bërë përpjekje të takohet me F.L. i cili e udhëzoi atë që ta kontaktojë N.K.; N.K. ryshfet në shumë prej 20% të vlerës së tenderit, i cili do t'i parapaguhej *I-E* nga MTPT-ja; kur .M.Sh.i refuzoi këto kushte, N.K. e dërgoi prapa tek F.L., i cili i sugjeroi që .M.Sh.ta kompletonte dokumentacionin e ofertës me një kompani me të cilën *I-E* kishte bërë oferta të mëhershme të pasuksesshme (kështu në mënyrë

³¹⁸ Procesverballi, 25 tetor 2016, f. 17. Shih gjithashtu procesverballin 25 tetor 2016, f. 20 ("*Nuk di asgjë.*"); 26 tetor 2016, f. 7 ("*Nuk di asgjë ose diçka e tillë*").

- efektive duke mos e mbajtur premtimin e tij të mëhershëm për 'rregullimin' e dokumentacionit të I-E në mënyrë që t'i jepej tenderi).
186. Trupi gjykues thekson se në mars 2009, M.Sh.i kërkoi Q.M që ta shoqëronte atë në një takim me F.L., dhe Q.M. refuzoi. Kjo tregohet nga SMS-të midis M.Sh. dhe Q.M. të datës 19 mars 2009 dhe konfirmohet nga dëshmia e këtij të fundit para gjykatës. Mesazhet me shkrim të dërguara nga .M.Sh. te .Q.M. më 19 mars ("*F.L. tha me shku te ai*") dhe te F.L. më 20 mars ("*Jam M.Sh. jam rrugës*") gjithashtu sugjerojnë (edhe pse nuk janë përfundimtare) se F.L. ishte pajtuar për një takim të tillë.
187. Sidoqoftë, provat nuk kanë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm F.L. ose është takuar me M.Sh. ose në ndonjë mënyrë tjetër e ka udhëzuar atë që bisedonte me N.K. Përkundrazi, SMS-të e përgjuara të dërguar nga M.Sh.tek F.L. më 20 dhe 23 mars – në të cilat nuk ka përgjigje të regjistruar nga F.L. - tregojnë se përpjekjet e përsëritura të M.Sh në këtë drejtim ishin të kota dhe të pasuksesshme.
188. Në fakt, pohimi se F.L. në çfarëdo mënyre, e ka udhëzuar M.Sh. që të bisedojë me N.K., nuk gjen bazë në asnjë provë të pranueshme. Në veçanti, pretendimet e z. M.Sh. siç raportohet nga AKK-ja janë se F.L. e ka këshilluar atë që ta kompletojë dokumentacionin me S. dhe .M.Sh. vetë ka shkuar te N.K. ("*... F.L. më tha: - Nuk mund ta kompletojë dokumentacionin tuaj, por kompletoje atë përsëri me kompaninë 'S'. Pastaj kam shkuar te menaxher i prokurimit i MTT-së, . N. K., dhe kam filluar një bisedë me të ...*") Ky drejtim i caktuar i pretenduar i F.L. nuk është përmendur në letër ankesën e M.Sh.
189. Duke u kthyer në pjesën e tretë të pretendimit të prokurorit në lidhje me z. Krasniqin, provat kyçe të renditura në mbështetje të pohimit se N.K. i ka kërkuar z. M.Sh. rryshfet, gjendet në informatën e AKK-së, si në vijim:
- "Pastaj kam shkuar te menaxheri i prokurimit i MTT-së, Z. N. K., dhe kam filluar një bisedë me të, gjatë kësaj bisede ai më ka kërkuar 20% të vlerës totale të këtij tenderi dhe unë i kam thënë: - Nuk kam pare për t'i dhënë. Ai më ka thënë: - ne do të depozitojmë tek ti 20% të shumës totale paraprakisht dhe ti pastaj do të na i japësh ne këto të holla (pra këto janë fjalët e menaxherit, . N. K.t, thotë .M.Sh.). Kur i kam thënë se nuk kam para dhe nuk e kam pranuar atë që më tha, ai pastaj më tha: - Shko te F.L., ai të ka premtuar dhe ai do ta bëjë për ty."*
190. Përfundimisht, një numër i SMS-ve të dërguara nga .M.Sh., pas kësaj që pretendohet të ketë ndodhur më lart, sugjerojnë të kundërtën, që .M.Sh. nuk ka pasur sukses në arritjen e kontaktit me F.L. apo N.K. në mars 2009. Trupi gjykues thekson se në SMS-të e dërguara te A.G. (23 mars) dhe F.L. (28 mars), .M.Sh. vazhdon t'i referohet premtimeve të tetorit/nëntorit të kaluar dhe jo, siç do të mund të pritej në mënyrë të arsyeshme, ngjarjeve të kohës së fundit. Kjo është pasuar më 30 mars, me një vazhdim të përpjekjeve për t'u takuar me F.L..
191. Për këto arsye, trupi gjykues ka gjetur se prokurori nuk ka arritur të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm se në mars 2009, M.Sh. ka bërë përpjekje të takohet me z.

F.L., i cili e udhëzojë atë që ta kontaktojë N.K.; N.K. i kërkoj ryshfet në shumë prej 20% të vlerës së tenderit, i cili do t'i parapaguhej kompanisë I-E nga MTPT-ja; kur M.Sh. refuzoi këto kushte, N.K. e dërgoi atë te F.L., i cili sugjeroi M.Sh. që ta kompletojë dokumentacionin e tenderit me S. Sa i përket pretendimit të M.Sh. (raportuar nga AKK-ja) se N.K. i kërkoj ryshfet prej 20% të vlerës së tenderit, trupi gjykues sërish nënvizon nenin 262 (1) të KPP-së dhe që pretendimet e M.Sh janë të pavërtetuara.

192. Për këto arsye, trupi gjykues ka gjetur se prokurori nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se N.K.ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare si Shef i Prokurimit në MTPT duke i kërkuar M.SH.ryshfet në shumë prej 20% të vlerës së tenderit 009-004-511 për Mirëmbajtjen Verore dhe Dimërore të Rrugëve Rajonale të Kosovës për Rajonin e Gjilanit për vitin 2009-2010

Marrëveshja me F. Z.

193. Sa i përket marrëveshjes me F.Z., prokurori pretendoi se "*pasi që M.Sh .nuk u pajtua që të paguaj ryshfetin e kërkuar, F.L. e udhëzoi E. Sh. që të negocioj një marrëveshje (ryshfet) me F. Z. Nga kompania T. për përfitime të tij personale.*"³¹⁹ Për më tepër, ai theksoi se F.Z. ia ka dhuruar PDK-së 5,000 euro në janar 2009.³²⁰ Më 1 shkurt 2009, F.Z. ndihej i tradhtuar sepse, pavarësisht investimit të tij, ai nuk ishte ftuar në një takim të PDK-së në të cilën u diskutuan tenderët dhe u ankua te E.Sh.³²¹ Sipas prokurorit, E.Sh. e ka ftuar F.Z. në takim sa ishte duke u mbajtur,³²² dhe pastaj - në emër të F.L. - e siguroi atë "*se kishte mundësi që F.Z. dhe T. të fitonin kontratat e MTPT-së.*"³²³ Të dy u pajtuan të hanin drekë dhe "*në kohën e duhur gjatë shkurtit të vitit 2009, F.Z. i kërkoj E.SH. që të dilte për drekë me të.*"³²⁴ E.Sh. dhe F.Z. u takuan më 10 mars dhe diskutuan "*çështjen që kompania T. do të mund të lihej jashtë ... përkundër investimit të cilin F.Z. e kishte bërë më parë në partinë politike.*"³²⁵
194. Mosmarrëveshjet ndërmjet E.Sh. dhe F.L. nga njëra anë dhe F.Z. nga ana tjetër janë zgjidh gjatë marsit 2009.³²⁶ U pajtuan që, para ofertimit të mbyllur dhe hapjes së ofertave, E.Sh. (në emër të F.L.) do ta "rregullonte" ose manipulonte dokumentacionin e tenderit të T-t në atë mënyrë që të sigurohej që kompania të fitonte tenderin; në shkëmbim F.Z. do të paguante ryshfet në vlerë prej 250,000 euro ("*25 me katër zero*").³²⁷ E.Sh plotësoi pjesën e tij të marrëveshjes më 24 mars.

³¹⁹ Aktakuza e konsoliduar, f. 9.

³²⁰ Aktakuza e konsoliduar, f. 41, paragrafi 72; f. 42, paragrafi 76.

³²¹ Aktakuza e konsoliduar, f. 41, paragrafi 72; f. 42, paragrafët 73-75.

³²² Aktakuza e konsoliduar, f. 41, paragrafi 74 ("*Në përgjigje E. SH. fton F. Z. për një bisedë ...*").

³²³ Aktakuza e konsoliduar, f. 43, paragrafi 77.

³²⁴ Aktakuza e konsoliduar, f. 43, paragrafi 78.

³²⁵ Aktakuza e konsoliduar, f. 43, paragrafi 81.

³²⁶ Aktakuza e konsoliduar, f. 44, paragrafët 82-84.

³²⁷ Aktakuza e konsoliduar, f.9; f. 46, paragrafët 91-92.

- ³²⁸ Më 25 mars, F.Z. e dërgoi ofertën e *T-t* në orën 9:45 dhe, në orën 10:30, ofertat u hapën.³²⁹ Të dy pretendohet se kanë qëndruar në komunikimin me SMS midis 25 dhe 29 marsit, duke kërkuar përditësime dhe duke e siguruar njëri tjetrin se gjithçka ishte në rrugë të mbarë.³³⁰
195. *Kompania T.* e fitoi tenderin me ofertën e tij prej 1,192,844.94 euro. Prokurori ka vërejtur se 250,000 euro përfaqëson 20% e vlerës totale të tenderit—e cila përkon me përqindjen e pretenduar të kërkuar nga N.K. prej M. Sh. (diskutuar më lartë).³³¹ Këto para “do t’i kalonin drejtpërdrejtë familjes L.”³³² Kontrata ndërmjet F.Z. në emër të *T-t* dhe N.K. në emër të MTPT-së është nënshkruar më 7 maj.³³³
196. Prokurori më tutje pretendon se procedura e prokurimit përmbante “shkelje kritike ligjore”.³³⁴ Konkretisht: kompania ofertuese *I.* është dashur të eliminohet nga kjo procedurë tenderimi për papërgjegjshmëri.³³⁵ Një eliminim i tillë do të linte më pak se tri oferta të përgjegjshme dhe, sipas dispozitave të zbatueshme të Ligjit mbi Prokurimin Publik, është e domosdoshme që e gjithë procedura të anulohet dhe të përsëritet.³³⁶ Parashtrësit e prokurorit ishin të paqarta sa i përket rëndësisë së këtyre parregullsisë të pretenduara për keqpërdorim të pozitës zyrtare kundër F.L. dhe E.Sh. Sidoqoftë, trupi gjykues e pranon që vendimi për ta konsideruar *I.* si të përgjegjshëm - nëse do të mund t’i atribuohet F.L. - do të siguronte mbështetje rrethanore për marrëveshje me *T-n*. Kjo për shkak se (hipotetiki) F.L. do të merrte ryshfet duke siguruar vazhdimin e procedurës deri në fund duke ia dhënë tenderin kompanisë *T-t*.
197. Trupi gjykues rikujtoi gjetjet e tij, të shtjelluara në hollësi në Pjesën IV.C, se kopja fizike e printuar e SMS-ve të sekuestruara gjatë bastisjes së shtëpisë së F.L. në XXX janë të papranueshme në këtë procedurë. Duke pasur parasysh këtë, trupi gjykues shqyrtoi pjesën e mbetur të provave të paraqitura nga prokurori në mbështetje të këtyre pretendimeve dhe nënvizoi provat relevante në vijim:
- a. **SMS-të e përgjuara gjatë asaj kohe, përfshirë:**
- i. Pesë SMS-të e përgjuara të dërguara nga F.Z. te E.Sh. më 1 shkurt 2009, shkruajnë:³³⁷

³²⁸ Aktakuza e konsoliduar, f.9; f. 46-47, paragrafi 93.

³²⁹ Aktakuza e konsoliduar, f. 47, paragrafi 94

³³⁰ Aktakuza e konsoliduar, f. 47-49, paragrafët 95-103.

³³¹ Aktakuza e konsoliduar, f.9; f. 47, paragrafi 94.

³³² Aktakuza e konsoliduar, f. 9.

³³³ Aktakuza e konsoliduar, f. 52, paragrafi 112.

³³⁴ Aktakuza e konsoliduar, f. 52-53, paragrafët 112-113.

³³⁵ Aktakuza e konsoliduar, f. 52-53, paragrafi 113.

³³⁶ Aktakuza e konsoliduar, f. 52-53, paragrafi 113.

³³⁷ Transkripti i SMS-ve midis F. Z. dhe E. Sh. i datës 01 shkurt 2009 në ora 14:09, 14:14, 14:17, 15:10, 15:15: Përmbledhje e të dhënave të përgjimit Nr. 66, 67, 68, 70 71, Regjistratori pas aktakuzës IV-A.

“A met partis jeni a? Kerkush sumka thir bre nanen ktyne a kur jan ngusht meniren me thirin. Vetu thuj apo ju ndihmon kompania T. hiq.” (14:09)

“Nëse nuk idhnohesh ti nuk isha ardh se inati pom vjen pse sumkan thirr kta.” (14:14)

“Pom vjen keq pi juve pasha fnit ama shum pom vjen inati pi pirave para I jave partis 5000? Ja kum dhan e mos mem thir nanen kamejau qi.” (14:17)

“Po a se vete shefin a po ka kohe me shku te Planeti a? OK qysh ti keni punt, pata qef me jau qit 1 drek po shnosh në Pr takohemi naj nat.” (15:10)

“Në rregull vëlla, shihemi në Prishtinë. Përshëndete shefin.” (15:15)

ii. Një SMS i dërguar nga F.Z te E.Sh në ora 16:03 më 10 mars 2009 shkruan: *“A e lëmë për 6?”*³³⁸

iii. Një SMS i dërguar nga E.SH. te F.L. në ora 20:58 më 10 mars 2009 thotë: *“kompania T. po thotë më ke tradhtu”*.³³⁹

b. **‘Raporti i Auditimit i Publikimit të Raporteve Financiare të Fushatës të Partive Politike: Zgjedhjet Lokale 2009’** me raportin e auditimit ligjor të kompanisë U. A. të datës nëntor 2010, specifikohet se F.Z. ka dhënë një donacion prej 8,000 euro PDK-së degës në ‘Gjilan 2’.³⁴⁰ Raporti nuk e specifikon datën kur është bërë donacioni.

c. Në **‘Raportin e ekspertit lidhur me procedurën për dhënien e kontratës,**³⁴¹ eksperti ndërkombëtar i prokurimit . K. G. ka konstatuar se dhënia e kontratës kompanisë T. ka qenë e paarsyetuar sepse (i) numri i madh i (pesë) ofertave të cilave u mungonte plani i duhur i pastrimit mund të shpie tek dyshimi se *“këta tenderë nuk ishin seriozë”* dhe (ii) *“ka pasur shkele të rëndë të ligjit kur oferta e operatorit ‘I.’ është dashur të eliminohet nga gara për arsye të papërgjegjshmërisë. Kjo do të paraqiste arsye për anulimin e aktivitetit të prokurimit për shkak të nenit 30A.4 të LPP-së pasi që kanë mbetur më pak se tri oferta të përgjegjshme. Është dashur të fillohet aktivitet i ri i prokurimit.*”³⁴²

³³⁸ Transkripti i SMS-ve midis F. Z. dhe E. Sh. i datës 10 mars 2009 në ora 16:03: Përmbledhje e të dhënave të përgjimit Nr. 75a, Regjistratori pas aktakuzës IV-A.

³³⁹ Transkripti i SMS-ve midis E. Sh. dhe F.L.t i datës 10 mars 2009 në ora 20:58: Përmbledhje e të dhënave të përgjimit Nr. 75b, Regjistratori pas aktakuzës IV-A

³⁴⁰ Raporti i auditimit i publikimit të deklaramit financiar të fushatës të partive politike zgjedhjet lokale 2009 (N.SH. U. A.) i datës nëntor 2010: Regjistratori 36, f. 129.

³⁴¹ ‘Raporti i ekspertit lidhur me procedurën për dhënien e kontratës, L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, f. 293-319.

³⁴² ‘Raporti i ekspertit lidhur me procedurën për dhënien e kontratës’, L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, f. 314-315.

Raporti i K. G. për këtë procedurë të tenderit ka përcaktuar se atij i është dhënë "raporti i ekspertëve lokal i gushtit të vitit 2011 për tenderin e lartpërmendur" dhe "kjo ekspertizë merret si bazë dhe do t'i referohet asaj".³⁴³ Ai më tutje thekson se vërejtjet e tij "kanë për qëllim të tregojë mënyrat ligjore dhe mënyrat e caktuara ligjore për dhënien e një kontrate publike një operatori të caktuar ekonomik me ... trajtim të veçantë të procedurës. Sidoqoftë, nuk është qëllimi i kësaj ekspertize të pretendojë të vërtetën, pasi që është e mundur që dhënia e një tenderi të caktuar (sic) është rezultat i një sjellje të padrejtë por jo domosdoshmërisht kriminale. Kjo është kontrolluar ose do të kontrollohet nga mjetet e ndjekjes penale."³⁴⁴

d. **K. G.** ka dëshmuar si në vijim lidhur me këtë tender:³⁴⁵

"Kanë qenë 11 ofertues; 8 nga këto oferta të tenderit janë përjashtuar si të pakualifikuara për një sërë arsyesh. Pse ka ndodhur kjo, ne nuk kemi mundur ta gjurmojmë, por rezultati është interesant, do të thotë kanë mbetur vetëm tre ofertues. Ligji e përcakton që kur ka më pak se 3 oferta të vlefshme, zakonisht procedura publike e prokurimit duhet të ndërpritet. Dhe këtu kemi gjetur se oferta e kompanisë "I" do të duhej të përjashtohet gjithashtu, por nuk ishte përjashtuar. Pra normalisht, procedurat do të duhej të ndërpritet dhe do të duhej të fillonte një procedurë krejtësisht e re. Administrata e Prokurimit do të kishte pasur mundësi t'i drejtohet Agjencisë Kombëtare të Prokurimit me qëllim që ta adresojë çështjen ligjore këtu, por kjo nuk është bërë si procedurë. Dhe për të përfunduar, kjo procedurë ka qenë e parregullt. Pavarësisht kësaj, ofertuesit kompanisë "T" i është dhënë kontrata."

Dëshmitari ka theksuar se, me qëllim të kryerjes së ekspertizës së tij, atij i janë siguruar dosjet voluminoze të prokurimit, të përkthyer, përfshirë dosjen e tenderit.³⁴⁶ Ai konfirmoi se atij i është dhënë ekspertiza e mëparshme dhe "është ftuar për të bërë një ekspertizë dhe për ta plotësuar atë."³⁴⁷ K. G. nuk i kujtohet baza për përfundimin e tij se I. është dashur të përjashtohet gjithashtu si i papërgjegjshëm.³⁴⁸

A i ka dhënë F.Z. donacion 5,000 euro PDK-së në janar 2009?

198. Trupi gjykues ka shqyrtuar nëse secili pretendim i prokurorisë është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Prokurori pretendoi se F.Z është ankuar më 1 shkurt

³⁴³ 'Raporti i ekspertit lidhur me procedurën për dhënien e kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, p. 314, duke iu referuar 'Ekspertizës PPS. Nr. 425/09, Procesi i prokurimit 'Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës 2009/2010', MTPT 09/004/511, Regjistratori 16, f. 20-30.

³⁴⁴ 'Raporti i ekspertit lidhur me procedurën për dhënien e kontratës', L. M. dhe K. G., Regjistratori 16, f. 314.

³⁴⁵ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 10.

³⁴⁶ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 14-15, 38.

³⁴⁷ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 13, 27-28.

³⁴⁸ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 41.

2009 se nuk ishte ftuar në një takim të PDK-së përkundër donacionit që ai e kishte dhënë "javën e kaluar".³⁴⁹ Ai kërkoi të provonte ekzistencën e vetë donacionit duke iu referuar një raporti të auditimit mbi kontributet e fushatës politike të bëra - gjatë vitit 2009 - për zgjedhjet lokale të vitit 2009.³⁵⁰ Prandaj, nxjerrët përfundimi, se teoria e prokurorit ishte se F.Z. ka dhuruar 5,000 euro midis 1 dhe 31 janarit 2009.

199. Trupi gjykues thekson se ekzistenca e një donacioni nga F.Z. pak para mbledhjes së pretenduar të PDK-së (diskutuar më poshtë) nuk përbën asnjë element të veprës penale të akuzuar të shpërdorimit të pozitës/autoritetit zyrtar nga F.L. me ndihmën e E.Sh. Sidoqoftë, kjo shërbeu për të paraqitur një kontekst të dobishëm për këto pretendime.
200. Trupi gjykues ka gjetur se në Raportin e Auditimit të asaj date nuk kishte asnjë indikacion se kur ishte bërë ndonjë donacion nga F.Z., e as që ishte bërë në dy ose më shumë këste, dhe një prej tyre ishte 5,000 euro (siç ishte spekuluar nga prokurori). Për më tepër, Raporti i Auditimit ka shqyrtuar donacionet e bëra për zgjedhjet lokale të 2009. Ato janë mbajtur në mes të nëntorit të vitit 2009 dhe pjesa e mbetur e raportit sugjeron që asnjë nga partitë politike nuk ka marrë asnjë donacion për këto zgjedhje para gushtit 2009, me shumicën e pranuar në tetor 2009. Prandaj, trupi gjykues ka gjetur se Raporti i Auditimit nuk e mbështet pretendimin se z.F.Z. ka i ka dhënë PDK-së një donacion prej 5,000 euro gjatë muajit janar 2009.
201. Natyrisht, është e mundur që PDK-ja ose nuk e ka raportuar donacionin prej 5.000 euro nga F.Z. ose është raportuar diku tjetër, në veçanti sepse Raporti i Auditimit duket se ka të bëjë vetëm me kontributet politike të bëra për zgjedhjet. Megjithatë, provat të tilla nuk ishin prezantuar nga prokurori. Trupi gjykues ka pranuar, se z. F.Z. ka pohuar t'ua ketë dhënë atyre të partisë 5,000 euro, siç është theksuar në SMS-të e tij.

A e ka udhëzuar F.L.E.Sh. që të negocioj një marrëveshje me F.Z.?

202. Prokurori ka bërë një pretendim të përgjithshëm se "*pasi që M.Sh.nuk u pajtua që të paguar ryshfetin të kërkuar, F.L. e udhëzoi E. Sh. që të negocioj një marrëveshje (ryshfet) me F. Z. nga kompania T. për përfitime të tij personale.*"³⁵¹ Nuk është paraqitur asnjë provë në mbështetje të këtij udhëzimi. Në fakt, trupit gjykues i duket se ekzistimi i tij ishte në kundërshtim me teorinë e prokurorit, se diskutimet ishin nxitur nga ankesat e F.Z. sesa nga refuzimi i M.Sh. (duke pasur parasysh edhe SMS-të e panumërta të M.Sh. që sugjeronin refuzimin e F.L. për të negociuar me të). Prandaj, trupi gjykues nuk konsideroi se kjo ishte vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

³⁴⁹ Aktakuza e konsoliduar, f. 42, paragrafi 75.

³⁵⁰ Aktakuza e konsoliduar, f. 42, paragrafi 76.

³⁵¹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 9.

A e ka siguruar E.Sh., në emër të F.L. F.Z.. se kompania T. do ta fitonte tenderin për ndërtimin e rrugëve më 1 shkurt 2009?

203. Prokurori ka vënë në dukje disa raste ku F.L. përmes E.Sh., thuhet se kishte negociuar ose premtuar F.Z. se kompania T.-t do t'i jepeshin tenderët për ndërtimin e rrugëve, dhe konkretisht tenderi 009-004-511 për rajonin e Gjilanit; secili prej tyre është shqyrtuar.
204. E para nga këto ishte përmes SMS-së nga mbledhja e PDK-së e mbajtur më 1 shkurt 2009. Trupi gjykues konsideron se SMS-të e dërguara nga F.Z tek E.Sh. më 1 shkurt 2009 e bëjnë të qartë se ishte duke u zhvilluar një lloj takimi në të cilin ai nuk ishte ftuar dhe se në takim kishin marrë pjesë anëtarë të PDK-së. Kjo e fundit tregohet nga fakti se vetë E.Sh ishte i pranishëm; dhe nga referenca e F.Z për "*ata të Partisë*" dhe - me sa duket i pranishëm ishte edhe - "*Shefi*". Ndonëse nuk ka SMS të regjistruar nga E.Sh. te F.Z., SMS-të nga F.Z.tregojnë se E.Sh në fakt i përgjigjej.
205. Sidoqoftë, nuk ka pasur asnjë provë se cilido tender për ndërtimin e rrugëve - e lëre më tenderi specifik që ka qenë subjekt i kësaj akuze – janë diskutuar në këtë takim në të cilin kanë marrë pjesë anëtarë nga PDK-ja. Dikush mund të supozojë se F.Z. (duke qenë pronar i një kompanie që oferton për ndërtimin e rrugëve) mund të ketë qenë i interesuar të marrë pjesë në një takim të tillë dhe do të ishte i mërzhitur nëse nuk do të ishte i ftuar. Kjo nuk thotë asgjë për atë që është diskutuar në mes të atyre në takim dhe sidoqoftë bie shumë nën prapen e të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm.
206. Për më tepër, nuk ka prova të mjaftueshme se, siç u pretendua nga prokurori, më 1 shkurt 2009, E.Sh. ia kaloi një mesazh nga F.L. duke siguruar F.Z. "*se kishte mundësi që F.Z. dhe T.kompania të fitonin kontratat e MTPT-së.*"³⁵² Është e qartë se disponimi i mesazheve të F.Z. ndryshon gjatë pasdites, nga "*shumë i idhnuar*" (14:14), "*shumë i zemëruar*" dhe duke kërcënuar "*nanen kam me jau qi*" (14:17), më vonë në, "*Në rregull, qysh ti keni punt!*" (15:10) dhe "*Në rregull vëlla... përshëndete shefin*" (15:15). Mund të supozohet se ky ndryshim është shkaktuar nga përmbajtja e përgjigjeve të E.Sh. (të pa dokumentuara). Sidoqoftë, duke mos pasur ndonjë provë konkrete dhe të drejtpërdrejtë, trupi gjykues nuk ka konsideruar se prokurori ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se kjo përmbajtje ishte një premtim i F.L. nëpërmjet E.Sh., për dhënien e kontratave për ndërtimin e rrugës T-kompanise.

A i ka diskutuar E.Sh. tenderët për ndërtimin e rrugëve me F.Z gjatë drekës më 10 mars 2009?

³⁵² Aktakuza e Konsoliduar, f. 43, paragrafi 77.

207. Trupi gjykues ka pranuar se E.SH. është takuar me F.Z më 10 mars 2009, në bazë të dy SMS-ve të dërguara atë ditë. E.Sh. ia ka përcjellë F.L. se z. F.Z. ndihej i tradhtuar. Ndërsa, këtu përsëri mund të spekulohet se F.Z. ishte i brengosur për tenderët për ndërtimin e rrugëve, kjo në asnjë mënyrë nuk është bërë e qartë me prova dhe trupi gjykues nuk e ka pranuar se ky ishte shpjegimi i vetëm i arsyeshëm.

A kanë bërë E.SH dhe F.Z. marrëveshje në gjysmën e dytë të marsit 2009?

208. Përfundimisht, prokurori pretendon se në gjysmën e dytë të marsit 2009, E.Sh. dhe F.Zuka kanë bërë një marrëveshje ku E.Sh. ka premtuar t'ia "rregullojë" dokumentacionin e tenderit kompanisë *T.-t* në mënyrë që do ta siguronte që ai ta fitoi këtë tender, në këmbim të ryshfetit prej 250,000 euro. Trupi gjykues vëren se këto pretendime janë bazuar në pjesën më të madhe në kopjen fizike të SMS-ve të pretenduara të konfiskuara gjatë bastisjes së shtëpisë së F.L., të cilat u konsideruan si të papranueshme.

209. Prova kryesore e mbetur për të mbështetur këtë pretendim është raporti i ekspertëve dhe dëshmia e drejtpërdrejtë e ekspertit ndërkombëtar të prokurimit K.G. Kjo, pretendohet, se e ka vërtetuar se ka pasur shkelje në procesin e prokurimit në këtë tender: në mënyrë specifike, *I.* është dashur të eliminohej si i papërgjegjshëm, duke rezultuar në më pak se tre ofertues të përgjegjshëm duke e bërë të domosdoshme anulimin e procesit dhe përsëritjen e tij. Argumenti (i tërthortë) që paraqitet është se vendimi për të konsideruar *I.* si të përgjegjshëm kur në fakt nuk ishte, nëse mund t'i atribuohet F.Z., do të sugjeronte interesin e tij personal për ta çuar procesin e prokurimit deri në fund, dhe prandaj ekzistimin e një marrëveshjeje me kompaninë *T-n*. Këto prova nuk arritën të përmbushnin barrën e të provuarit për arsyet në vijim.

210. Së pari, trupi gjykues nuk ka qenë i bindur se prokurori ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se *I.* është dashur të eliminohet për papërgjegjësi. Në një pjesë të ekspertizës së K.G. është konstatuar se *"ka pasur shkelje të rëndë të ligjit kur oferta e operatorit 'T' është dashur të eliminohet për arsye të papërgjegjshmërisë. Kjo është pasqyruar në dëshminë e K. G. të dhënë drejtpërdrejtë se "kemi gjetur se oferta e kompanisë 'T' do të duhej të përjashtohet gjithashtu, po që kjo nuk ishte bërë."*

211. Sidoqoftë, trupi gjykues nuk mendon që ky përfundim ishte fryt i gjykimit personal të K.G, bazuar në aplikimin e ekspertizës së tij profesionale. Përkundrazi, duket se K.G është mbështetur në analizën e mëhershme të PSRK-së për këtë përfundim.³⁵³ Ndërsa K.G ka deklaruar se atij i janë siguruar shumë materiale primare, ai gjithashtu pranoi se atij i është siguruar analiza e mëparshme dhe është kërkuar që

³⁵³ 'Ekspertiza PPS. Nr. 425/09: Procesi i prokurimit 'Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës 2009/2010' MTPT 09/004/511, Rajoni i Gjilanit, Regjistratori 16, f. 20-30.

- "ta plotësonte atë"*. Në dëshminë e tij para gjykatës, K.G. nuk i kujtohej se si arriti në përfundimin se *I.-i* duhej të ishte eliminuar, ndërsa raporti i tij në mënyrë eksplicite thotë se *"raporti i ekspertëve vendorë i gushtit 2011 ... është marrë si bazë."* Trupi gjykues nuk ka dëgjuar ndonjë dëshmi rreth përpilimit të ekspertizës së mëparshme siç mund të ishte mbështetur siç duhet në të.
212. Së dyti, nuk ka asnjë provë se F.L. (ose E.SH. ose N.K. në emër të tij) ka pasur ndonjë rol në vendimin për ta konsideruar *I.* si të përgjegjshëm (kështu duke i hapur rrugën që kompania *T.* të fitojë tenderin dhe të paguhet ryshfeti). Vendimi për ta konsideruar kompaninë *I.* si të përgjegjshëm - nëse duhet, në të vërtetë, është eliminuar - shpjegohet në mënyrë të barabartë nga mbikëqyrja ose paaftësia e komisionit të vlerësimit të ofertave. Trupi gjykues rikujtoi gjetjen e tij të mëparshme se N.K. nuk ka qenë i obliguar që personalisht të shqyrtoj çdo ofertë të tenderit për secilën procedurë të tenderit, por ka pasur të drejtë të mbështetet në vlerësimin dhe rekomandimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në nënshkrimin e kontratës me fituesin eventual (shih paragrafin 146).
213. Në fund, edhe nëse vendimi për ta konsideruar kompaninë *I.* të përgjegjshëm kur në fakt nuk ishte, do të mund t'i atribuohet F.L. (një supozim të cilin trupi gjykues nuk e pranoi), mungesa e ndonjë prove tjetër do të thoshte se kjo do të ishte e pamjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se tenderit i është dhënë kompanisë *T.* në këmbim të pagesës së ryshfetit. Në veçanti, trupi gjykues ka vërejtur se as ekspertiza e L.M. dhe as e K.G. nuk mbështetën supozimin se dokumentacioni i ofertës së kompanisë *T.* ishte 'rregulluar'. Më tutje, edhe pse prokurori pretendon se ryshfeti prej 250,000 euro *"do t'i kalonte drejtpërdrejt familjes L."*,³⁵⁴ nuk ka asnjë provë se një shumë e tillë i ishte paguar F.L. apo ndonjë anëtar i familjes së tij.
214. Për këto arsye, trupi gjykues konstatoi se prokurori nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm asnjërin nga pretendimet në vijim: pas prishjes së negociatave me M. Sh., F.L. ka udhëzuar E. Sh. që të negociojë një marrëveshje (ryshfet) me F. Z. për dhënien e tenderit 009-004-511 për rajonin e Gjilanit; më 1 shkurt 2009 E.SH., në emër të F.L.t, e ka siguruar F. Z. se kishte mundësi që F.Z. dhe kompania *T.* të fitonin kontratat e MTPT-së; më 10 mars 2009, E.SH. dhe F.Z. janë takuar dhe kanë diskutuar çështjen që *T kompania* mund të lihej jashtë përkundër investimit të këtij të fundit përmes donacionit prej 5,000 euro që ia kishte dhuruar PDK-së; në gjysmën e dytë të marsit 2009, E.SH. dhe F.Z. kanë arritur një marrëveshje ku E.SH. do t'ia 'rregullonte' *T-t* dokumentacionin e ofertës për tenderin 009-004-511 për rajonin e Gjilanit dhe F.Z. do të paguante ryshfet prej 250,000 euro pas marrjes së tenderit dhe ky ryshfet do t'i shkonte F.L.t ose familjes së tij.

³⁵⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f. 9.

v. Tenderi 08-073-521 – Asfaltimi i rrugës Duraj-Gabrice, Gjilan, i fituar nga kompania B.

215. Prokurori ka bërë tri pretendime të ndryshme për keqpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit në lidhje me procedurën e tenderit “Asfaltimi i rrugës Duraj-Gabrice” (08-073-521), si në vijim: (a) **F.L.** udhëzoi bashkëpunëtorët e kompanisë *B.* (“*Me gjasë A. A.*”) përmes një “letre” të shkruar në restorantin *Mani* lidhur me lartësinë e shumës të cilën *B. Kompania* duhej të ofronte në ofertën e saj për të qenë i suksesshëm; (b) **SH.T.** ka ndihmuar **F.L.**n “*duke mundësuar një komunikim privat me A.A.n kur filloi procedura e tenderit*”; dhe (c) **N. K.**, pavarësisht dijenisë lidhur me marrëveshjen private të **F.L.**, pranoi vazhdimin e procedurës së tenderit, duke mos raportuar sjelljet e këqija tek autoritetet dhe përfundimisht nënshkroi kontratën me kompaninë fituese, *B.*³⁵⁵
216. Prokurori nuk ka pretenduar përfshirjen e **E.SH.** në këtë procedurë të tenderit dhe përgjegjësia e tij penale nuk është shqyrtuar më tej në këtë pjesë.

A e ka njoftuar F.L. bashkëpunëtorin e kompanisë Kompania B. se çfarë oferte ishte e mjaftueshme për të fituar tenderin?

217. Prokurori, në fillim, ka pretenduar se vetë **F.L.** kishte udhëzuar një bashkëpunues të kompanisë *Kompania B.*, “*me gjasë A.A.n*”, lidhur me shumën që *Kompania B.* duhej të ofronte për të qenë i suksesshëm duke e shkruar në një faturë në restorantin *Mani*³⁵⁶. Më pas, prokurori pretendon se **F.L.** ishte “*shumë i vetëdijshëm për caktimin e çmimit për procedurën e tenderit që përfshinte rrugën Duraj-Gabrice*”³⁵⁷ dhe kishte marrë pjesë personalisht në takimet në restorantin *Mani* ku zyrtarët e **MTPT-së** dhe pronarët e kompanisë diskutonin marrëveshjet e paligjshme mbi caktimin e çmimeve.³⁵⁸
218. Duke u kthyer fillimisht në pretendimin e dytë të prokurorit: trupi gjykues theksoi se parashtresat e prokurorit në lidhje me këtë ishin përshtatur me elementet e Pikës 1 të aktakuzës (Krimi i Organizuar), për të cilën pikë **F.L.** u lirua nga akuza, si më lart³⁵⁹. Më tej, trupi gjykues konsideron se këto pretendime, edhe nëse janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm (dhe nuk ishin vërtetuar), do të vërtetonin shkeljen e keqpërdorimit të pozitës zyrtare/autoritetit. Nga prokurori kërkohet që të paraqesë sjelljen në emër të të akuzuarit që mund të karakterizohet si keqpërdorim i pozitës zyrtare të ndërmarrë me qëllimin për të përfituar një “dobi pasurore” për

³⁵⁵ Aktakuza e Konsoliduar, f. 10.

³⁵⁶ Aktakuza e Konsoliduar, f.10

³⁵⁷ Aktakuza e Konsoliduar, f. 74, paragrafi 180

³⁵⁸ Aktakuza e Konsoliduar, f. 75, paragrafi 180 (“...Restoranti *Mani*, i cili ndodhet në afërsi të të djave lokaleve, kompania *E.* dhe Kompania *B.*, ka shërbyer si pikë e përgjithshme e takimit midis zyrtarëve të **MTPT-së** dhe pronarëve të kompanive përkatëse, ku palët pinin kafe dhe diskutonin ujdite e tyre.”); para. 181 (“*Ekzistenca e një fature të Manit në posedim të F.L.t tregon se F.L. ka marrë pjesë personalisht në takime të tilla ...*”)

³⁵⁹ Shiko supra Pjesën V.A.

- vete ose për personin tjetër, të shkaktojë dëme ndaj personit tjetër ose të shkelë seriozisht të drejtat e personit tjetër.³⁶⁰
219. Pretendimi i prokurorit (d.m.th. F.L. “*ka marrë pjesë personalisht në takime të tilla*”) nuk ka theksuar ndonjë takim specifik ku është diskutuar tenderi 08-073-521, roli (ose sjellja) e F.L. në atë takim, ose qëllimin e tij përkatës për të përfituar dobi pasurore ose për të shkaktuar dëme. Për këtë të fundit, dijenia e F.L. për caktimin e çmimeve, kur ishte e nevojshme, do të ishte e pamjaftueshme në vetvete për të përbërë elementin mendor të veprës penale.
220. Prandaj, trupi gjykues i kthehet pretendimit të parë dhe më konkret të prokurorit, se F.L. udhëzoi një bashkëpunëtor të *Kompania B.t*, “*me gjasë A.A.n*”, lidhur me shumën që *Kompania B.* duhej të ofronte për të qenë i suksesshëm në këtë ofertë. Trupi gjykues shqyrtoi dëshmitë e A.A.t dhe B. D.; përgjimet e bisedave telefonike dhe mesazhet SMS mes prillit dhe qershorit 2008; dhe raporti i ekspertëve L.M.dhe K.G, i bashkuar me dëshminë e drejtpërdrejtë të këtij të fundit. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, përderisa ka disa indikacione se *Kompania B.* mund të ketë marrë informacion në lidhje me vlerën e parashikuar të tenderit, dëshmitë nuk e lidhin qartë F.L. (ose, siç do të shihet më poshtë, Sh.T.në emër të tij) si burim i një informacioni të tillë.
221. Kështu, pjesa tjetër e provave të mbetura të paraqitura në mbështetje të këtij pretendimi është një faturë e papaguar nga restoranti *Mani* e gjetur gjatë një kontrolli të shtëpisë së F.L. në Çagllavice.³⁶¹ Prapa kësaj fature disa projekte dhe llogaritjet e çmimeve të tyre, mes tyre “*Duraj-Gabrice - 239,000*”. Kjo është shumë afër vlerës së parashikuar të projektit, e caktuar në shumën 238,802.00 euro³⁶², si dhe ofertat e bëra nga *Kompania S.* (238,758.00 euro) dhe *Kompania B.* (254,987.83 me një zbritje 7.3%, duke e ulur ofertën në shumën 236,373.71 euro), duke sugjeruar sipas prokurorit se *Kompania S.* dhe *Kompania B.* ishin në dijeni se sa duhej të ofertonin.³⁶³
222. Trupi gjykues nuk ishte në gjendje të pranonte pretendimet e prokurorit se kjo tregonte se F.L. kishte udhëzuar një bashkëpunëtor të *Kompania B.-t* për shumën që duhej të ofertonte për të fituar tenderin. Prokurori nuk ka sjellë dëshmi për rrethanat në të cilat vlerat e parashikuara të projekteve janë shkruar në një faturë të *Mani-t*, pasi mund të vërtetonte çfarë ndryshe është spekulimi i pastër. Nuk është e ditur për trupin gjykues kur mund të jenë venë shënimet në faturë (dhe si kjo korrespondon me afatin kohor të procesit të prokurimit); nëse ndonjë bashkëpunëtor i kompanisë ishte i pranishëm kur vlera e projektit ishte shkruar në faturë (siç është e qartë edhe nga supozimi i prokurorit se ishte shumë “*e mundshme A.A.*”); ose në të vërtetë nëse ajo është shkruar nga F.L. apo edhe në restorantin *Mani*. Nëse F.L. e ka shkruar me të vërtetë, ofrimi i udhëzimeve për

³⁶⁰ Shih *supra* Pjesën II.A. i.

³⁶¹ Shih aktakuza e Konsoliduar, f. 75, paragrafët 180-181.

³⁶² Dosja e prokurorisë, regjistratori 34, f. 233-234.

³⁶³ Aktakuza e Konsoliduar, f. 75, paragrafi 181.

bashkëpunëtorët e kompanisë nuk është i vetmi shpjegim i arsyeshëm për ta bërë një gjë të tillë; ai ka mundur, për shembull, të ketë marrë parasysh shpenzimet e infrastrukturës së MTPT-së për atë periudhë.

223. Përveç kësaj, trupi gjykues konsideron se oferta në fjalë e kompanisë *Kompania B.* nuk e vërteton pohimin se ai ishte në dijeni paraprakisht, nëpërmjet A.A.t ose cilido tjetër, të vlerës së parashikuar të projektit. Në veçanti, prokurori gjithashtu ka parashtruar se oferta e *Kompania B.-t* “është manipuluar gjatë procedurës së prokurimit.”³⁶⁴ Kjo është, sipas prokurorit, zbritja prej 7.3% për ofertën e *Kompania B.-t* e cila u prezantua pasi që kompania paraqiti ofertën e saj në MTPT (pra: nga një zyrtar i MTPT-së) dhe me qëllim të uljes së ofertës së *Kompania S.t* saktësisht në vlerën nevojshme për të fituar tenderin.³⁶⁵ Kjo teori e prokurorit do të kishte tendencën të sugjeronte të kundërtën, d.m.th., se *Kompania B.* nuk ishte informuar paraprakisht për vlerën e parashikuar të projektit - përndryshe oferta e saj origjinale (para-zbritjes) do të ishte në përputhje me atë vlerë. Më tej, pasi ofertat u vlerësuan me anë të një kriteri “ekonomikisht më të favorshëm” dhe jo “çmimit më të ulët”, ky zvogëlim i çmimit nuk ishte patjetër i domosdoshëm.
224. Përfundimisht, trupi gjykues thekson se - ashtu si në procedurat e tenderit të shqyrtuara më parë - prokurori përsëri nuk ka parashtruar qartë faktet, pasi do të vërtetonte elementin mendor të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare/autoritetit sipas nenit 422 të KPK-së.³⁶⁶ Kjo, duke sjellë ndërmend, kërkohej që nëpërmjet sjelljes së tij, i akuzuari kishte për qëllim të përfitonte një dobi pasurore për vete ose për personin tjetër, t’i shkaktonte personit tjetër ose të shkelte seriozisht të drejtat e personit tjetër. Prokurori në asnjë mënyrë të kënaqshme nuk ka shpjeguar se si ky element ishte përmbushur në lidhje me procedurën e tenderit 08-073-521.
225. Për këto arsye, trupi gjykues konstaton se prokurori nuk ka dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L. ka keqpërdorur pozitën/autoritetin zyrtar të tij si ministër i MTPT-së në shpalljen e tenderit 08-073-521 për asfaltimin e rrugës Duraj-Gabrice.

A është ndihmuar F.L. nga Sh.T., duke i mundur një komunikim privat me A.A.n kur kishte filluar procedura e tenderit?

³⁶⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f. 72, paragrafi 172.

³⁶⁵ Aktakuza e Konsoliduar, f. 72, paragrafi 173 (“... shifra prej 7,3% u paraqit më pas për të ulur ofertën e Sallahut pikërisht në lartësinë e nevojshme për të fituar tenderin”); faqe 73, paragrafi 175 (“... ndarja e zbritjes prej 7.3% nga oferta e llogaritur është kryer për qëllime të manipulimit”.); f. 73-74, paragrafi 176 (“Pretendohet se zbritja u shtua në një fazë të mëvonshme të procedurës së prokurimit me qëllim manipulimin e numrave për të siguruar që Kompania B. do të ishte ofertuesi më i lirë ... në formularin e deklaratës së ofertës, çmimi fillestar duket të jetë i shkruar në një mënyrë të tillë duke e shmangur ngjasimin me vulën e Kompania B.t. Kjo ngre dyshimin se letra e ofertës fillimisht ishte “e vulosur bosh” dhe se shifrat ishin futur më pas.”).

³⁶⁶ Shih supra Pjesën II.A.i

226. Prokurori pretendon se Sh.T.e kishte ndihmuar F.L. në keqpërdorimin e pozitës/autoritetit të tij zyrtar “*duke mundësuar një komunikim privat me A.A.n kur kishte filluar procedura e tenderit*”.³⁶⁷ Provat kryesore të drejtuara nga prokurori në mbështetje të këtij pretendimi janë dy mesazhet SMS të dërguara nga A.A. tek SH.T. në afatin kohor përkatës. I pari u dërgua më 23 prill 2008 (një ditë para publikimit të njoftimit të kontratës) dhe thotë: “*Shpejtim, a mund të dalim për kafe, unë jam në Prishtinë*”.³⁶⁸ I dyti u dërgua më 1 qershor 2008 (një javë pas shpalljes së fituesit të tenderit) dhe pyet nëse Sh.T. është në Shtërpçë dhe kërkon përgjigje.³⁶⁹
227. Trupi gjykues rikujton se Pika 2 e aktakuzës e ngarkonte Sh.T.si ndihmës sipas nenit 25 të KPPK-së.³⁷⁰ Përgjegjësia penale e një ndihmësi bazohet në kontributin e tij me dijëni ndaj kryerësit kryesor. Kështu, ishte detyrë e prokurorit të dëshmonte që Sh.T.me vetëdije ishte angazhuar në sjelljen që ndihmoi F.L. në keqpërdorimin e pozitës së tij zyrtare dhe ishte në dijëni të qëllimit të F.L. për të përfituar dobi pasurore për vete ose për një person tjetër ose për të shkakuar dëme materiale personit tjetër ose shkeljet serioze të të drejtave personit tjetër.
228. Trupi gjykues konstatoi se provat nuk mbështesin pretendimin e prokurorit se Sh.T.ka mundësuar një komunikim me A.A.n kur kjo procedurë e tenderit kishte filluar. Nuk ka asnjë indikacion se Sh.T.ia përgjigj SMS-it që e kishte pranuar më 23 prill ose se kishte ndonjë komunikim ndërmjet Sh.T.dhe A.A.t ose ndërmjet A.A.t dhe F.L. më pas (e lëre më që ky komunikim kishte të bënte me tenderin 08-073 -521 apo si mund ta ketë ndihmuar F.L. në keqpërdorimin e pozitës së tij si ministër i MTPT-së).
229. Në lidhje me këtë, trupi gjykues ka konsideruar se pjesa e mbetur e provave të drejtuara nga prokurori (kryesisht komunikimet ndërmjet A.A.t dhe Z.A.³⁷¹ dhe A.A.t dhe B.D.³⁷²) po ashtu nuk kanë ofruar tregues të qartë se Sh.T.ka ndihmuar komunikimin me F.L.. Përfundimisht, trupi gjykues konstaton se mesazhi SMS i pranuar nga Sh.T.më 1 qershor, është jo relevant, duke qenë se është dërguar pas shpalljes së fituesit të tenderit.
230. Për këto arsye trupi gjykues konsideron se prokurori nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se SH.T. e kishte ndihmuar F.L. në keqpërdorimin e pozitës së tij zyrtare si ministër i MTPT-së, duke mundësuar një komunikim privat me A.A.n kur procedura për tenderin 08-073 -521 kishte filluar.

³⁶⁷ Aktakuza e Konsoliduar, p. 10.

³⁶⁸ Regjistratori 11, f. 50; Aktakuza e Konsoliduar, p. 68, paragrafi 157.

³⁶⁹ Regjistratori 7D, f. 402-403 (“*Jaran, a je në territorin e Shtërpçës të lutem kthe nëse ke mundësi*” apo “*Jaran, a jeni në territorin e Shtërpçës, kthema nëse ke mundësi*”).

Aktakuza e Konsoliduar, f. 71, paragrafi 169.

³⁷⁰ Aktakuza e Konsoliduar, f. 6-7, 10

³⁷¹ Aktakuza e Konsoliduar, f.68, paragrafi 159; f. 69. Paragrafët 162-163; f. 70, paragrafët 165-166; f.71. paragrafët 167-169.

³⁷² Aktakuza e Konsoliduar, f. 69, paragrafi 160.

A ka qenë e pajustificuar nënshkrimi i kontratës nga N.K.me Kompania B.-n?

231. Përfundimisht, prokurori pretendon se N.K.ka keqpërdorur autoritetin zyrtar që i ishte dhënë atij si drejtor i prokurimit të MTPT-së duke lejuar vazhdimin e procedurës së prokurimit (d.m.th., duke mos ndërhyrë për ta ndaluar), duke mos raportuar keqpërdorim autoriteteve dhe përfundimisht nënshkrimin e kontratës me *Kompania B.-n* në emër të MTPT-së. Sipas prokurorit, ka pasur disa shkelje të procedurës së prokurimit lidhur me tenderin 08-073-521.³⁷³ Më e rëndësishmja në mesin e tyre është manipulimi i ofertës së *Kompania B.-t* që dëshmohet nga oferta e saj e pashpjeguar dhe e pazakontë me një zbritjeje prej 7.3% e cila “*e uli ofertën e Kompania S.t pikërisht deri në lartësinë e nevojshme për të fituar tenderin*”.³⁷⁴ Përveç kësaj, prokurori vë në pah parregullsitë në dosjen e operatorëve që kanë pranuar dosjen e tenderit;³⁷⁵ shkresën që dokumenton dorëzimin e ofertave;³⁷⁶ dhe procesverbalin e hapjes së ofertave³⁷⁷. Ai gjithashtu vëren se, duke qenë një rrugë lokale, më parë duhet të kishte qenë në kompetencë të komunës sesa të MTPT-së.³⁷⁸
232. Trupi gjykues rikujton konstatimet e tyre të mëparshme se nuk e ka parë të nevojshme të vërtetoj përtej dyshimit të arsyeshëm parregullsitë bazike në procedurën e prokurimit. Përkundrazi, ishte detyra e tij të tregonte se N.K.ishte në dijeni për shkelje të dyshuara që do të nxisin përgjegjësinë e tij për të ndaluar procesin dhe për të nxjerrë hetime të tjera përpara se të nënshkruante ndonjë kontratë me kompaninë fituese. Prandaj, dëshmitë e **A.A.t** dhe **B.D.** janë konsideruar si të parëndësishme në këtë pikë, pasi janë marrë më shumë me ekzistencën e shkeljeve themelore sesa në dijeninë e N.K.
233. Trupi gjykues ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndes për dëshmi që janë të rëndësishme lidhur me këtë pretendim dhe ka nënvizuar si në vijim:
- Dëshmia e **B. R.** dhe **V. K.** të përmbledhura më lartë në paragrafin 144.
 - Një “**akt përcjellës**” i MTPT-së i datës 23 prill 2008, i drejtuar dhe nënshkruar nga N. K., parashikon vlerën e tenderit në shumën EUR 238,802.00.³⁷⁹
 - “**Regjistri i Operatorit Ekonomik që ka pranuar dosjen e tenderit**”³⁸⁰ përmend katër kompani që kanë marrë dosjen e tenderit. *Kompania S.* është renditur si e treta në orën 15:45 më 9 maj 2008, ndërsa *Kompania B.* është renditur si i katërti, megjithëse më herët, në orën 15:30, në të njëjtën ditë.

³⁷³ Aktakuza e Konsoliduar, f. 71-74, paragrafët 170-179.

³⁷⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f. 72-74, paragrafët 172-176.

³⁷⁵ Aktakuza e Konsoliduar, f. 71-72, paragrafi 171.

³⁷⁶ Aktakuza e Konsoliduar, f. 74, paragrafi 177.

³⁷⁷ Aktakuza e Konsoliduar, f. 74, paragrafi 178.

³⁷⁸ Aktakuza e Konsoliduar, f. 74, paragrafi 179.

³⁷⁹ Regjistratori 34, f. 233-234.

³⁸⁰ Regjistratori 34, f. 220.

Dokumenti nuk mban nënshkrimin e një zyrtari të pranimit në katrorin që korrespondon me pranimin e secilës kompani. Është nënshkruar nga N. K..

- d. **‘Regjistri i Dorëzimit të Tenderit’**³⁸¹ përmend tre kompani që kanë dorëzuar ofertat e tyre më 13 maj 2008. Këto janë të shënuara në mënyrë kronologjike dhe të gjitha kanë një “Nënshkrim të ofertuesit të tenderit” siç duhet. Megjithatë, kërkesa e *Kompania B.-t* nuk ka nënshkrimin e një zyrtari të pranimit. Është nënshkruar nga N. K..
- e. **Raporti i Komisionit të Vlerësimit të Ofertës**³⁸² përmend ofertat e tri kompanive ofertuese, duke përfshirë edhe atë të *Kompania B.t* të ofruar me një zbritje prej 7.3% (pa specifikuar ndonjë arsye për një gjë të tillë).³⁸³ Të tre ofertat konsiderohen të përgjegjshme sipas vlerësimit paraprak,³⁸⁴ dhe tri ofertat e përgjegjshme janë renditur përsëri (dhe përsëri është treguar zbritja prej 7.3% nga *Kompania B.*).³⁸⁵ Komisioni raportues kryen vlerësimin “ekonomikisht më të favorshëm”, në të cilin *Kompania B.-t* i janë dhënë 100 pikë, e pasuar nga *Kompania E.* (96,63) dhe *Kompania S.* (87.60).³⁸⁶ *Kompania B.* rekomandohet si fitues nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe ky rekomandim miratohet me N.K.³⁸⁷
- f. **Raporti i ekspertëve** përkatës³⁸⁸ parashikon që L.M.ka shqyrtuar ofertat për këtë tender, duke përfshirë atë të *Kompania B.-t*, dhe arriti në përfundimin se nuk kishte “*asnjë dëshmi të manipulimit*” ose marrëveshjeve për rregullimin e çmimeve.³⁸⁹ L.M.shton:

*“Është megjithatë e dukshme që ofertuesi Kompania B. ka lejuar një ulje të çmimit prej 7.3%, e cila në fund ishte e mjaftueshme për të qenë ofertuesi me çmimin më të mirë. Në bazë të dokumenteve, nuk mund të gjykohet se deri në ç’masë ofruerit Kompania B. i ishin ofruar informacione të hershme të mundshme.”*³⁹⁰

K.G., në pjesën e tij të raportit, vuri në dukje se “[k]orrektësia e procedurës mund të dyshohet në të paktën deri në një farë mase”.³⁹¹ Këto dyshime, sipas K.G., buronin nga çështja e “kompetencave” dhe nga nevoja për të shpjeguar pse kishte ndryshim të kompetencës në MTPT dhe pse afati i fundit për

³⁸¹ Regjistratori 34, f. 219.

³⁸² Regjistratori 34, f. 201-212.

³⁸³ Regjistratori 34, f. 203.

³⁸⁴ Regjistratori 34, f. 205.

³⁸⁵ Regjistratori 34, f. 206.

³⁸⁶ Regjistratori 34, f. 210-211.

³⁸⁷ Regjistratori 34, f. 212.

³⁸⁸ ‘Raportet e siguruar të procedurave të dhënies së kontratës (Ref: PROC/PEX/12’)’, të datës 30.05.2013, të vulosura me rastin e pranimit 10.06.2013, regjistratori 9, f. 1-23.

³⁸⁹ Regjistratori 9, f. 3, 10.

³⁹⁰ Regjistratori 9, f. 10.

³⁹¹ Regjistratori 9, f. 16.

dorëzimin e ofertave ishte shkurtuar.³⁹² Në lidhje me zbritjen e ofruar nga Kompania B., K.G. vuri në dukje.³⁹³

“Mund të ketë dyshime se dikush nga MTPT-ja e ka informuar ndërmarrjen në fjalë më parë. Për më tepër, oferta e Kompania S.t gjithashtu është mjaft afër ‘vlerës së përafërt’ ... dhe lë hapësirë për dyshime ...

“Nuk ka dëshmi të qartë për manipulime në lidhje me kriteret financiare përveç një dyshimi të vetëm: Kompania B. ishte informuar paraprakisht për vlerën e parashikuar dhe kishte zbritur ofertën duke pasur këtë njohuri. Por, pasi kjo ndërmarrje do të kishte fituar garën edhe pa zbritje, manipulimet do të duhej të kërkoheshin edhe në zbritjen e pikave teknike për Kompania S.n. Kjo nuk mund të nxirret lehtësisht nga materiali ...”

g. Lidhur me këtë procedurë të prokurimit,, **K.G** ka dëshmuar si në vijim:³⁹⁴

“...kjo ka të bëjë me një rrugë të vogël në një zonë komunale ose vendore me një gjatësi prej rreth 2 kilometrash, dhe përsëri këtu nuk na është dhënë ndonjë shpjegim se pse ministria do të kishte qenë kompetente këtu dhe jo komuna. Ekziston gjithashtu një çështje sa i përket aspektit kohor këtu. Për këtë kategori të rrugëve të vogla, siç kemi përmendur më parë, ka qenë afati 40 ditor ose afati 24 ditor, dhe në këtë rast ishte zbatuar afati prej 24 ditësh. Ligji ofron një numër mundësish për të shkurtuar afatin më të shkurtër për arsye urgjente ose prioritare. Pra, kjo në të vërtetë do të thotë se për rrugët e vogla afati mund të shkurtohet në minimum prej 10 ditësh dhe ministria u mbështet në këtë mundësi të shkurtimit të afateve pa dhënë ndonjë arsye. Rezultati ishte në të vërtetë se kemi mbetur vetëm me 3 oferta të tenderit. Para së gjithash, nuk e dimë pse vlera e kësaj kontrate nuk është përshkruar, pra nëse ky ishte në të vërtetë një tender me vlerë më të lartë apo jo, por në rast se kanë qenë vetëm tre ofertues shpesh ndodh që vetëm kompanitë që janë të përgatitura mirë dhe e dinë se një ftesë e tillë për të lëshuar një tender do të publikohet do të jenë në dijeni të kësaj. Këtu ekziston një detaj shumë interesant lidhur me ofertën e tenderit si të tillë. Ofertat ishin nga kompanitë “Kompania E.,” “Kompania B.” dhe “Kompania S.”. Kompania “Kompania E.” kishte vendosur një ofertë në vlerë prej 258.000 euro, kompania “Kompania B.” rreth 255.000 euro dhe kompania “Kompania S.” rreth 239.000 euro. Kështu që normalisht kompania “Kompania S.” do të shihej se ka paraqitur ofertën më të ulët dhe këtu është interesante që kompania Kompania B. ka ofruar një zbritje në vlerë prej 7.3% dhe eventualisht ishte me raundin me rreth 236.000 euro si ofertuesi më i ulët. Nëse hedhim një vështrim të dytë në vlerësimin e pikave të ofertuesve të ndryshëm, dhe përsëri kompania “Kompania B.” ka marrë vlerësimet më të larta me 100 pikë. Përfundimisht, kemi gjetur indikacione, por asnjë provë për manipulime, ne si specialistë të

³⁹² Regjistratori 9, f. 16-17.

³⁹³ Regjistratori 9, f. 18-19.

³⁹⁴ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 10-11.

prokurimit, përveç një dyshimi se kompania “Kompania B.” kishte njohuri paraprakisht se çfarë vlerash duhej të ofronte dhe çfarë zbritje duhet të ofronte.

Përfundimisht, nga këndvështrimi ynë kanë mbetur dy pika të vështira: së pari, kompetenca e ministrisë për këtë rrugë të vogël; dhe së dyti çështja e shpjegimit se pse ky afat i shkurtër prej 10 ditësh është përdorur si një opsion. Kjo mënyrë për të ofruar një zbritje prej 7.3%, ne si ekspertë të prokurimit e dimë se kur gjërat bëhen nën tryezë, kjo do të thotë kur ka kontekst të paligjshëm midis palëve në fjalë, por natyrisht nuk mund ta them një gjë të tillë.

Siç e kam thënë tashmë, nga këndvështrimi ynë nuk ka prova të qarta sipas dosjeve, por sigurisht që është e habitshme që oferta e kompanisë “Kompania B.” pas zbritjes është pak më e ulët se oferta e kompanisë “Kompania S.” që e bën dallimin më të vogël se 2000 euro. Kjo mund të merret si një tregues se ka pasur një kontakt të paligjshëm midis ofertuesit dhe ministrisë.”

234. Trupi gjykues ka shqyrtuar dijeninë e N.K. për secilën nga parregullsitë në procedurën e prokurimit të pretenduar nga ana e prokurorit. Ndërsa shihet se nënshkrimi i N.K. paraqitet edhe në dokumentin e pranimit të dosjes së tenderit edhe të dorëzimit të dosjes së tenderit, dhe në këtë mënyrë ai ishte në dijeni për përmbajtjen e të dy dokumenteve, trupi gjykues nuk është bindur se këto ishin të natyrës ose peshës që tregojnë qartë nevojën për hetime të mëtejshme.
235. Në mënyrë të ngjashme, N.K. është në dijeni për zbritjen prej 7.3% të ofruar nga Kompania B. dhe se kjo ka rezultuar që Kompania B. të ofron çmimin më të ulët, sipas raportit të komisionit për vlerësimin e ofertave. Megjithatë, siç vuri në dukje K.G., Kompania B. do të kishte fituar tenderin pavarësisht zbritjes në bazë të pikëve të dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave për kritere të tjera në kryerjen e vlerësimit “ekonomikisht më të favorshëm”. Në lidhje me këtë, trupi gjykues sjell ndërmend gjetjen e tij të mëparshme që N.K. kishte të drejtë të mbështetej në këtë vlerësim dhe nuk kërkohet anasjelltas që ta “shqyrtonte” dhe vetë të shqyrtonte ofertat individuale dhe të rivlerësonte pikat e dhëna nga komisioni.
236. Për më tepër, prokurori nuk ka parashtruar fakte që do të vërtetonin se N.K. ka lejuar vazhdimin e procedurës, nuk ka nxitur hetime të mëtejshme ose kishte nënshkruar kontratën me Kompania B.-n me qëllimin e domosdoshëm për të përfituar dobi pasurore, ose kishte shkelur seriozisht të drejtat e personit tjetër (neni 422 i KPK-së). Ky është një element i domosdoshëm i veprës penale.
237. Për këto arsye, trupi gjykues konstaton se prokurori nuk ka dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se N.K.ka keqpërdorur autoritetin e tij zyrtar si drejtor i prokurimit të MTPT-së duke nënshkruar në emër të MTPT-së kontratën për tenderin 08-073-521 për ‘asfaltimin e rrugës Duraj-Gabrice’ me kompaninë Kompania B..

C. Marrje e ryshfetit (Pika 3 e aktakuzës)

238. Prokurori ka akuzuar **F.L.n, N. K.n** dhe **E.Sh.** për veprën e Marrjes së ryshfetit (Pika 3 e aktakuzës) dhe, anasjelltas, F.Z. për Dhënie të ryshfetit (të njëjtë) (Pika 4 e aktakuzës). Prokurori nuk ka pretenduar përfshirjen e **SH.T.t** në marrje të ryshfetit, dhe përgjegjësia e tij më nuk konsiderohet. Trupi gjykues rikujtoi se **Pika 4 të aktakuzës** kundër F.Z. ishte refuzuar si e parashkruar sipas parashkrimit absolut (Shiko Pjesën III.B).
239. Para se të kalojmë në thelbin e pretendimeve të prokurorit, trupi gjykues e pa të arsyeshme të bëjë disa vërejtje lidhur me akuzën e prokurorit në Pikën 3 të aktakuzës. Aktakuza e konsoliduar e ngarkonte të akuzuarin me veprën penale të Marrjes së ryshfetit në kundërshtim me nenin 343 (2) të KPPK-së, e dënueshme me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.³⁹⁵ Kjo është gabim. Vepra penale e Marrjes së ryshfetit në kundërshtim me nenin 343 (2) të KPPK-së dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet (jo pesë vjet). Vepra penale e Marrjes së ryshfetit në kundërshtim me nenin 343 (1) të KPPK-së dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet. Për këtë arsye Aktakuza e konsoliduar nuk përputhet me nenet dhe dënimet e tyre përkatëse.
240. Mospërputhja e detyroi trupin gjykues që të përcaktonte se cila vepër penale ngarkohet me Pikën 3 të Aktakuzës së konsoliduar. Trupi gjykues së pari vuri në dukje periudhat e parashkrimit të cilat vlejné për të dy veprat penale. Siç është diskutuar më parë, parashkrimi absolut për ndjekjen penale llogaritet nga data e kryerjes së veprës deri në datën e skadimit të dyfishit të periudhës përkatëse të parashkrimit.³⁹⁶ Nëse trupi gjykues do pranonte që prokurori ka ngarkuar të akuzuarin sipas nenit 343 (2), kjo do të thoshte se parashkrimi absolut është gjashtë vjet nga kryerja e veprës penale (d.m.th. dyfishi i dënimit maksimal prej tre vjetësh burgim). Pasi që vepra supozohet të jetë kryer në mars të vitit 2009, parashkrimi absolut i saj do të kishte skaduar në mars të vitit 2015 dhe neni 363 (1) (1.3) i KPPK-së do të kërkonte që kjo pikë e aktakuzës të refuzohej si e parashkruar sipas parashkrimit absolut.
241. Trupi gjykues, megjithatë, ka pranuar se prokurori ka dashur të ngarkonte të akuzuarin me veprën e Marrjes së ryshfetit sipas nenit 343(1) të KPPK-së (e cila dënohet me maksimumin pesë vjet burgim) për arsyet vijuese. Ai rikujtoi se neni 343(1) e ndëshkon Marrjen e ryshfetit për të vepruar në shkelje të detyrave zyrtare, ndërsa neni 343(2) ka të bëjë me zyrtarin i cili merr ryshfet për të vepruar në përputhje me detyrat zyrtare.³⁹⁷ Thelbi i pretendimeve të ngritura kundër të akuzuarit nën këtë pikë të Aktakuzës është se ata kanë marrë premtime për ryshfet në këmbim të dhënies së një tenderi *Kompania T.-t* për ndërtimin e rrugës. Prandaj

³⁹⁵ Aktakuza e Konsoliduar, f. 10

³⁹⁶ Kjo është diskutuar në detaje në Pjesën III. A

³⁹⁷ Shih *supra* Pjesën II. A.i.

është e qartë se pretendimi i prokurorit është se ata kanë vepruar në shkelje të detyrave të tyre zyrtare brenda MTPT-së. Prandaj thelbi i pretendimeve pasqyron Marrje të ryshfetit në formën që parashihet me nenin 343 (1) të KPPK-së. Prandaj trupi gjykues ishte i bindur se përmendja e nenit 343(2) e jo nenit 343(1) kishte qenë gabim shtypi, dhe se në fakt akuzat ishin ngritur lidhur me nenin 343(1).

242. Në fund, të gjitha veprimet e ngarkuara sipas këtyre pikave të Aktakuzës kanë të bëjnë me arritjen e marrëveshjeve lidhur me dhënien e **Tenderit 009-004-511, Mirëmbajta Verore dhe Dimërore e Rrugëve Regjionale të Kosovës 2009-2010, Rajoni i Gjilanit**. Pretendimet faktike që mbështesin këto akuza ishin diskutuar në detaje nga trupi gjykues në lidhje me Pikën 2 të Aktakuzës (Pjesa IV.A.iii) dhe këto të gjetura janë përmendur sërish këtu.

Marrëveshja me M.Sh.

243. Prokurori ka pretenduar se F.L. ishte paraqitur në një takim që z.M.Sh.kishte pasur me Zëvendës Ministrin e MTPT-sëA.G. dhe i kishte thënë z.M.Sh.“*Mos fol, dhe tenderi për mirëmbajtjen verore të rrugëve për 2009 është i yti*”, dhe kishte premtuar të ‘rregulloj’ dokumentacionin e tij tenderues.³⁹⁸
244. Trupi gjykues ishte i bindur se ky pretendim, nëse provohet, do të binte në kuadër të fushëveprimit të nenit 343(1) të KPPK-së, pasi që do të rezultonte në atë që F.L. (a) kishte kërkuar premtimin e dobisë për të apo për një person tjetër (nëse z.M.Sh.do të heshte për korrupsionin e mëhershëm në MTPT), (b) në këmbim të kryerjes së një veprimi që ai nuk duhet të kryente (d.m.th. ndërhyrjes në dhënien e kontratave të MTPT-së).
245. Megjithatë, trupi gjykues rikujtoi se, pas shqyrtimit të gjerë të provave, ai gjeti se prokurori nuk kishte dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L. kishte bërë premtimet e pretenduara (Shih Pjesën IV.A.iii, ‘Marrëveshja me M Sh.’).

Marrëveshja me F.Z.

246. Prokurori ka pretenduar se në pjesën e dytë të marsit 2009 z. Shala, duke vepruar në emër të (d.m.th. duke ndihmuar) F.L., ka negociuar një marrëveshje me F.Z.. Më konkretisht, që të dy ishin dakorduar që para përmbylljes së tenderimit të fshehtë dhe hapjes së ofertave, E.Sh.do të ‘rregullonte’ apo manipulonte dokumentacionin tenderues të *Kompania T.-t* në një mënyrë që siguronte që kompania të fitonte tenderin; si kompensim, F.Z. do paguante ryshfet në shumën prej 250,000 Euro (“25 me katër zero”).³⁹⁹ Paratë e ryshfetit “do t’i kalonin

³⁹⁸ Aktakuza e Konsoliduar, f. 11; f. 41, paragrafi 71.

³⁹⁹ Aktakuza e Konsoliduar, f 11-12; f. 46, paragrafët 91-92.

drejtpërdrejtë familjes L.”⁴⁰⁰ E.Sh.e kishte kryer pjesën e tij të ujdisë më 24 mars.⁴⁰¹

247. Trupi gjykues kishte pranuar se pretendimet e prokurorit, nëse dëshmohen, do të vërtetohin veprën e “marrjes së ryshfetit” sipas nenit 343(1) të KPPK-së. Në veçanti, trupi gjykues ishte pajtuar me prokurorin⁴⁰² që ishte e panevojshme të provohet nëse ryshfeti ishte paguar në të vërtetë apo nëse F.L. në fakt kishte kryer një veprë që ai nuk është dashur ta kryente dhe në vend të kësaj do të mjaftonte vetëm premtimi/marrëveshja.
248. Megjithatë, pas shqyrtimit të thellë të provave të pranueshme, trupi gjykues konstatoi se asnjëra nga pretendimet e prokurorit lidhur me marrëveshjen me F.Z. gjatë muajve shkurt dhe mars 2009 nuk ishin dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Kjo ishte diskutuar në Pjesën IV.A.iii, më konkretisht nën titullin ‘Marrëveshja me F.Z.’.
249. Për këto arsye, trupi gjykues konstatoi se prokurori nuk e kishte dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L., N.K. ose E.SH. kishin kryer veprën e ‘marrjes së ryshfetit’ gjatë dhënies së tenderit 009-004-511, Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e Rrugëve Regjionale të Kosovës 2009-2010, Rajoni i Gjilanit siç ngarkohet me Pikën 3 të Aktakuzës së konsoliduar.

D. Keqpërdorim i autorizimeve ekonomike (Pika 5)

i. Tenderi 08-049-511 – Ndërtimi i rrugës Ponesh-Zhegovc, Gjilan, fitues Kompania T.

250. Prokurori pretendon se ndërmjet datës 21 mars dhe 17 prill 2018 F.Z., si pronar i *Kompania T.-t*, ka lidhur dhe ka toleruar një marrëveshje për rregullimin e çmimeve me vëllain e vet N.Z.(pronar i *Kompania Z.*). Veçanërisht ai pretendon se ngjashmëritë e marrëveshjeve përkatëse të kompanive me *K.A.* dhe faktin se marrëveshja e *Kompania T.-t* është nënshkruar kurse ajo e *Kompania Z.* jo, tregon se F.Z. ka organizuar marrëveshjet për dy kompanitë⁴⁰³. Sipas prokurorit, ofertat e *Kompania T.-t* dhe *Kompania Z.* kanë çmime të njëjta në të gjitha pozicionet, me dallime të vogla në ofertat përfundimtare si pasojë e “*variacioneve të vogla të përfshira për fshehjen e marrëveshjeve për fiksimit të çmimit.*”⁴⁰⁴ Pasi F.Z. nuk ka deklaruar hapur se *Kompania T.* dhe *Kompania Z.* kanë qenë të ndërlidhur (d.m.th as që kanë ofertuar në konzorcium as që njëri do t’ia nënkontraktonte tjetrit ekzekutimin e kontratës, nëse do të fitohej), kjo, thotë prokurori, paraqet shkelje e

⁴⁰⁰ Aktakuza e Konsoliduar, f. 9.

⁴⁰¹ Aktakuza e Konsoliduar, f 9, 11; f 46-47, paragrafi 93.

⁴⁰² Shih Aktakuzën e Konsoliduar, f. 10 (“...premtimet e marra të ryshfetit në këmbim të...”)

⁴⁰³ Aktakuza e Konsoliduar, f.30, paragrafët 45-46; p. 33, paragrafi 52

⁴⁰⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f.31, paragrafi 49; p 33, paragrafi 52

nenit 66.2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe për pasojë një keqpërdorim të autorizimeve ekonomike që F.Z. ka mbajtur për *Kompania T.n.*⁴⁰⁵

251. Trupi gjykues është i bindur se F.Z., si pronar i *Kompania T.-t*, ka qenë ‘person përgjegjës’ në kuptim të nenit 107 (2) të KPPK-së në kohën relevante. Trupi gjykues është pajtuar se marrëveshja për rregullimin e çmimeve (nëse vërtetohet me prova) do të përbënte shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik si edhe elementin material të veprës ‘keqpërdorim i autorizimeve ekonomike’ sipas nenit 263(1)(5) të KPPK-së. Kjo më tepër do të konsiderohej si shkelje e nenit 117.1 (c) të Ligjit të Prokurimit Publik sesa shkelje e nenit 66.2 të Ligjit siç pretendon prokurori. Me nenin 117.1 (c) është ndaluar në mënyrë shumë të qartë lidhja e ndonjë marrëveshje e cila “ka për qëllim ose efekt parandalimin kufizimin ose shtrembërimin e garës për ndonjë kontratë publike”. Neni 117.2 ka liruar marrëveshjet brenda kornizës së nenit 66.2 nga aplikimi i nenit 117.1 (c).
252. Trupi gjykues ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës për prova relevante dhe thekson me sa vijon:
- a. **Marrëveshjet për furnizim me asfalt** të lidhura nga *Kompania T.*⁴⁰⁶ dhe *Kompania Z.*⁴⁰⁷ e kanë datën e njëjtë (15.04.2008) si edhe dizajnin e njëjtë (logon e K. A.) dhe formulimin (‘*NTSH K.A.obligohet të bëj furnizimin me të gjitha llojet e asfaltit dhe makinerinë e nevojshme që kërkohet sipas marrëveshjes ndërmjet NTSH K.A.dhe [kompania]. Kjo marrëveshje ka të bëjë me kërkesën tuaj për marrëveshjen me prodhuesin e asfaltit dhe zbatohet në gjithë territorin e Kosovës dhe gjatë këtij vitit 2008.*’).⁴⁰⁸ Marrëveshjen ndërmjet *Kompania T.-t* dhe *K.A.*e ka nënshkruar F.Z. dhe e ka vulosur me një vulë të *Kompania T.-t*. Marrëveshja midis *Kompania Z.* dhe *K.A.*është vulosur me vulën e *Kompania Z.* por nuk është nënshkruar.
 - b. Ofertat e ***Kompania T.-t*⁴⁰⁹ dhe *Kompania Z.*⁴¹⁰** kanë çmime identike në të gjitha pozicionet me gabime përfundimtare në çmime (576, 345,00 € dhe 579,499,26 €) që duket se janë gabimet aritmetike në kalkulimin e artikujve të sasisë.
 - c. Eksperti ndërkombëtar i prokurimit z. **L.M.**, në pjesë e vet të Paraqitja e Raportit të Ekspertit lidhur me procedurën e dhënies së kontratës’, deklaron:
“Në këtë tender është vërtetuar se dy tenderët kanë çmime identike në të gjitha pozicionet. Bëhet fjalë për tenderin Kompania T. Sh.p.k dhe garuesin,

⁴⁰⁵ Aktakuza e Konsoliduar, f. 12-13, f. 31, paragrafi 49; f. 33, paragrafi 52

⁴⁰⁶ ‘Marrëveshja’ Regjistratori 48B, f.387

⁴⁰⁷ ‘Marrëveshja’ Regjistratori 48T, p.191

⁴⁰⁸ Trupi gjykues ka vërejtur se të dy përkthimet në gjuhën angleze të këtij termi kanë pak dallime, por ka pranuar se origjinalet janë të njëjta.

⁴⁰⁹ Paramasa dhe Parallogaria, Regjistratori 48N, f. 278-279

⁴¹⁰ Paramasa dhe Parallogaria, Regjistratori 48T, f.273-275.

kompaninë, Kompania Z. L.L.C. Sidomos bie në sy se mbiemrat e familjeve të personave tregtarë janë identikë."⁴¹¹

Pasi ka krahasuar ofertat e tyre me anë të tabelës, L.M.vëren me sa vijon:

*"dyshime për marrëveshje për çmim".*⁴¹²

- d. **K.G**, ekspert ndërkombëtar i prokurimit dhe bashkautor i raportit⁴¹³ të cekur më lartë (b) ka dëshmuar se L.M.ka ekzaminuar çështjen e rregullimit të çmimeve⁴¹⁴. Prandaj K.G. nuk ka qenë në gjendje të komentoj rreth kësaj analize në substancë.⁴¹⁵
253. Për arsyet si në vijim, trupi gjykues nuk është bindur se prokurori e ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm pretendimin e tij se ka pasur marrëveshje sekrete për rregullimin e çmimeve ndërmjet *Kompania T.* dhe *Kompania Z.*. Së pari, trupi gjykues ka pranuar pohimin e prokurorit se F.Z. i ka organizuar dy marrëveshjet: asaj të *Kompania T.-t* dhe *Kompania Z.* me *K.A.*, por nuk është bindur se kjo nënkupton në mënyrë logjike që ai i ka përpiluar edhe tenderët e ofertave të dy kompanive. Trupi gjykues ka pohuar në këtë aspekt se të dy marrëveshjet (ngjashëm me marrëveshjen ndërmjet *Kompania P.I* dhe *Kompania K.A.*) janë një formalitet, që tregojnë gatishmërinë për furnizim me asfalt në vitin 2008 por nuk specifikon termat sipas të cilëve do të mundësohej kjo. Kështu ata nuk flasin për kalkulimet e artikujve relevant të ofertave të kompanive.
254. Së dyti, raporti i L.M. tregon një "dyshim" për rregullimin e çmimeve. Trupi gjykues nuk ka mundur të dëgjoj dëshminë e tij të drejtpërdrejte dhe prandaj nuk ka mundur të sqaroj sa ka qenë i qartë ai në këtë pikë. Në bazë të këtyre provave, trupi gjykues nuk konsideron se dyshimi, në vështrim të parë, arrin pragun e provës përtej dyshimit të bazuar.
255. Arsyeja e fundit dhe më e rëndësishmja, trupi gjykues nuk ka dëgjuar asnjë provë që lidhet me rrethanat e përpilimit të ofertës së *Kompania T.-t* apo sjelljes ose gjendjes mendore të F. Z. Edhe nëse trupi gjykues do ta pranonte (gjë që nuk e ka pranuar) se ngjashmëria e ofertave ka treguar me bindje bashkëpunimin ndërmjet dy kompanive, nuk ka prova të mjaftueshme që kjo mund t'i atribuohet sjelljes së F.Z.apo se ai ka qenë në dijeni të saj – faktorët esencial për ndonjë atribuim të përgjegjësisë penale. Pa dyshim shpjegim alternativ është se informata ka kaluar nëpërmjet punëtorëve të kompanive pa dijeninë e F.Z..
256. Për këto arsye trupi gjykues ka gjetur se prokurori nuk e ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.Z. ka keqpërdorur autorizimet ekonomike që ka pasur për

⁴¹¹ Paraqitja e raportit të ekspertit lidhur me procedurën e dhënies së kontratës, e datës 1 qershor 2012, Regjistratori 16, f. 297

⁴¹² Paraqitja e raportit të ekspertit lidhur me procedurën e dhënies së kontratës, e datës 1 qershor 2012, Regjistratori 16, f. 298.

⁴¹³ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f.4

⁴¹⁴ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 4, 30; Shih edhe, f. 6, 9-10, 12, 33

⁴¹⁵ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f.33-34.

kompaninë *Kompania T.* duke bërë ose toleruar një marrëveshje për rregullimin e çmimeve me *Kompania Z.* në ofertimin për tenderin 08-049-511 për Ndërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc në Gjilan.

ii. Tenderi 08-006-511 –Mirëmbajta Verore për Rrugët Regjionale të Kosovës 2008, Regjioni i Gjilanit, të cilin e ka fituar Kompania M.

257. Lidhur me këtë procedurë të tenderit, prokurori pretendon se ndërmjet 11 shkurtit dhe 24 prillit 2008 **F.Z.**, si pronar i *Kompania T.-t*, ka lidhur dhe ka toleruar një marrëveshje për fiksimit të çmimit me një përfaqësues të *Kompania E.* dhe është munduar ta fsheh atë duke përfshirë variacione të vogla ndërmjet dy ofertave të tenderëve⁴¹⁶. Prokurori ka identifikuar në fillim I. Sh.⁴¹⁷ dhe më vonë Y.Sh.,⁴¹⁸ pronar i *Kompania E.*, ndonëse ai nuk e ka specifikuar se me kë ka bërë konspiracion F.Z. për t'i ndarë çmimet. Pasi që F.Z. nuk e ka thënë hapur se *Kompania T. dhe Kompania E.* ishin të ndërlidhur (as që kanë ofertuar në konzorcium apo se njëri do t'ia nënkontraktonte tjetrit ekzekutimin e kontratës), kjo, thotë prokurori, përbën një shkelje të nenit 66.2 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe prandaj është keqpërdorim i autorizimeve ekonomike të cilat i ka pasur F.Z. për *Kompania T.n*⁴¹⁹.
258. Trupi gjykues nuk është bindur se prokurori e ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar pretendimin e tij se ka ekzistuar marrëveshja për rregullimin të çmimit ndërmjet *Kompania T.-t* dhe *Kompania E.*. Trupi gjykues bënë me dije se provat në vijim i japin mbështetje këtij pretendimi:
- Çmimet e ofertave të *Kompania T. dhe Kompania E.-it* janë identike në 54 prej 56 pozicioneve;⁴²⁰ prandaj janë shumë afër në vlerë me *Kompania T.-n* që bën një ofertë prej 799, 488. 63 për tenderin dhe *Kompania E.* 801, 386.15;⁴²¹
 - Pas ekzaminimit të ofertave për këtë tender eksperti ndërkombëtar i prokurimit **L.M.**deklaroi në pjesën e vet të raportit të ekspertit:

*“Tenderuesi Kompania T. dhe tenderuesi Kompania E. kanë çmime identike në të gjitha pozicionet. Nga kjo mund të supozojmë se ndërmjet tenderuesve të cekur është bërë një marrëveshje për çmim.”*⁴²²

⁴¹⁶ Aktakuza e Konsoliduar, f. 8 (“...F.Z.nga Kompania T. ka lidhur marrëveshje për fiksimit të çmimit me kompaninë E.... F.Z.e ka fshehur marrëveshjen e çmimit dhe ka manipuluar çmimin fshehurazi me kompaninë E.”); f. 13 (“ F. Z.... ka shkelur rregullat e aktivitetit biznesor duke bërë dhe toleruar një marrëveshje për fiksimit të çmimit me kompaninë E.”); f. 40 (“ Dallimi i vogël në çmimi del nga variacionet e vogla të cilat janë përfshirë në të fshehur marrëveshjen për fiksimit të çmimit”)

⁴¹⁷ Aktakuza e Konsoliduar, f. 13

⁴¹⁸ Aktakuza e Konsoliduar, f. 39

⁴¹⁹ Aktakuza e Konsoliduar, f 8, 13, 39-40

⁴²⁰ Aktakuza e konsoliduar, para 66ë (*Kompania T.*) Paramasa dhe Paralogaria, 2008; Regjistratori 47V, f. 307-328 (shqip), Regjistratori 47H, f 309-330 (Ang); (*kompania E*) Paramasa dhe Paralogaria, 2008; Regjistratori 47M, f. 101-125 (shqip).

⁴²¹ Aktakuza e konsoliduar, para 65: Procesverbali nga hapja e tenderit e datës 29 shkurt 2008: Regjistratori 47 D, f 297-310 (anglisht), Regjistratori 47B, f.302-315 (shqip).

Më tej ai deklaron: “ Çmime Identike për Kompania T. Sh.p.k dhe Kompania E.: dyshim për marrëveshje mbi çmimin.”⁴²³

- c. **K.G.**, ekspert ndërkombëtar i prokurimit dhe bashkë-përpilues i raportit⁴²⁴ të sipërcekur (b) ka dëshmuar se çështjen e rregullimit të çmimeve⁴²⁵ e ka ekzaminuar z. Mewes. Prandaj K.G. nuk ka qenë në gjendje të komentoj rreth kësaj analize në substancë.⁴²⁶
- d. **Y.Sh.**, drejtor dhe pronar i *Kompania E.*⁴²⁷ ka pranuar se Paramasa dhe Paralogaria e dorëzuar nga *Kompania E.* si pjesë e dokumentacionit⁴²⁸ të tenderit të vet ka qenë i njëjtë me atë të *Kompania T.-t* për 54 artikujt nga 56 gjithsej.⁴²⁹ Ai është “befasuar”⁴³⁰ duke e quajtur si “pak e pazakontë”⁴³¹. Y.Sh. e ka shpjeguar, si në vijim, procesin e vënies së çmimit për një tender të mirëmbajtjes së rrugëve: stafi teknik (inxhinierët, ekonomistët) të punësuar nga *Kompania E.* kanë përcaktuar çmimet e artikujve të ndryshëm sipas çmimit të tregut të materialeve të nevojshme (derivate, asfalti, etj.) dhe ka specifikuar një përqindje të dëshiruar të fitimit për kompaninë e cila menjëherë është shtuar në këto kalkulime.⁴³²

Y.Sh. ka mohuar ndonjë komunikim me *Kompania T.-n* për punën e çmimeve. Ai ka dëshmuar se kompania tij dikur kishte bashkëpunuar me *Kompania T.-n* për një projekt të ndërtimit të rrugëve, por bashkëpunimi ishte ndërprerë për shkak të mosmarrëveshjeve financiare dhe për pasojë ai dhe z. I.Z. kishin ndërprerë çdo diskutim dhe bashkëpunim siç kishin pasur në vitin 2008 kur kanë ofertuar për tenderin 08-006-511.⁴³³ Ka deklaruar se nuk e kishte parë F.Z. qe 10 vite para dëshmisë.⁴³⁴ Nuk e di a mos ka komunikuar dikush nga *Kompania E.-i* me *Kompania T.-n* për çmime.⁴³⁵ Në fund, dëshmitari ka sugjeruar se të dy kompanitë mund të kenë arritur në çmime të njëjta duke zbatuar formulat dhe marxhinat⁴³⁶ e njëjta të fitimit.

⁴²² Paraqitja e raportit të ekspertit për procedurën e dhënies së kontratës të datës 1 qershor 2012, Regjistratori 16, f. 323 (anglisht).

⁴²³ Paraqitja e raportit të ekspertit për procedurën e dhënies së kontratës të datës 1 qershor 2012, Regjistratori 16, f. 324 (anglisht).

⁴²⁴ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 4

⁴²⁵ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f. 4, 30: shih edhe f. 6, 9-10, 12, 33

⁴²⁶ Procesverbali, 1 nëntor 2017, f 33-34

⁴²⁷ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 3

⁴²⁸ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 8

⁴²⁹ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f.11-14

⁴³⁰ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 16

⁴³¹ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 15

⁴³² Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 9-10

⁴³³ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 5-6, 15-16

⁴³⁴ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 15

⁴³⁵ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 14-15.

⁴³⁶ Procesverbali, 26 nëntor 2017, f. 14-16 (“...ne kemi përdorur formulat e njëjta, përqindjen e njëjtë dhe çmimi del i njëjtë. Derivati ka çmimin e njëjtë, asfalti ka çmimin e njëjtë, pra gjërat që i përdorim të arrijmë tek ai produkt, çmimet janë të njëjta dhe çmimi i njëjtë do të dal. Nëse e bëni këtë

- e. **S.P.**, ka qenë punëtor fizik në kompaninë *M.* në vitin 2008,⁴³⁷ edhe në projektet⁴³⁸ e ndërtimit të rrugëve, ka dëshmuar se nuk kishte dijeni për punën e *S. P.* (dajës së tij dhe pronarit të *Kompania M.*) në atë kompani as nuk dinte nëse kompania kishte ofertuar në tenderët për ndërtim të rrugëve dhe nuk i kujtohej se a ka punuar në ndërtimin e rrugëve në Gjilan.⁴³⁹
259. Trupi gjykues nuk është bindur se kjo provë, marrë në tërësi, ka arritur pragun e provës përtej dyshimit të arsyeshëm. Ndërsa *L.M.* fillimisht “*supozonte*” se kishte marrëveshje për rregullim të çmimeve, ai këtë e quante edhe si një “*dyshim*”. Trupi gjykues nuk ka mundur ta dëgjoj dëshminë e tij drejtpërdrejt,⁴⁴⁰ prandaj nuk mund të sqaroj nivelin e sigurisë së tij në këtë pikë, pra gjasat, bazuar në përvojën e tij profesionale, që dy kompanitë mund të arrijnë rastësisht në oferta gati identike. Trupi gjykues ka dyshime në supozimin e *Y.Sh.* se kompanitë mund të kishin zbatuar formulat dhe marxhinat e njëjta të fitimit për të arritur në oferta identike dhe dëshmia e tij nuk e vërteton të kundërtën – d.m.th, se ngjashmëria *nuk* ka qenë koincidence.
260. Më konkretisht, prokurori nuk ka paraqitur asnjë provë që shpie në rrethanat e përpilimit të ofertës së *Kompania T.-t* ose sjelljen a gjendjes mentale të *F.Z.* (i akuzuar për një krim). Edhe sikur trupi gjykues ta kishte pranuar (gjë që s’e ka bërë) se ofertat tregojnë me bindje bashkëpunimin ndërmjet dy kompanive, nuk ka prova që tregojnë se kjo mund t’i atribuohet sjelljes së *F.Z.* dhe jo ndonjë punëtori të tij të ngarkuar me përpilimin e ofertës së *Kompania T.-t*. Në këtë aspekt, dëshmia e *Y.Sht* ka sugjeruar se stafi teknik, dhe jo pronari, mund ta kenë përpiluar ofertën. Vërtetë një shpjegim tjetër i shëndosh është se një punëtor i *Kompania E.* i ka dhënë tinëz çmimet *Kompania T.t* pa përfshirjen as dijeninë e *F.Z.*.
261. Për këto arsye, trupi gjykues ka gjetur se prokurori nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari *F.Z.* ka keqpërdorur autorizimet ekonomike që i ka pasur për *Kompania T.-n* duke lidhur kontratë sekrete për rregullimin e çmimeve në përpilimin e ofertës për tenderin 08-006-511 për rajonin e Gjilanit.

iii. Tenderi 009-004-511 – Mirëmbajtja Dimërore dhe Verore për Rrugët Rajonale të Kosovës 2009-2010, Rajoni i Gjilanit, tenderi i fituar nga Kompania T.

262. Prokurori ka pretenduar se në mars të vitit 2009 *F.Z.*, si pronar i *Kompania T.-t*, ka shkelur rregullat e aktivitetit biznesor duke (a) i premtuar *E.SH.* një ryshfet prej

matematikisht do të dilni me çmimin e njëjtë, por nëse përdorni një metodë tjetër, siç e zbatojnë shumica e kompanive [siç], atëherë do të dilni me një çmim qesharak.

⁴³⁷ Procesverbali, 29 shtator 2017, f. 3-4

⁴³⁸ Procesverbali, 29 shtator 2017, f. 5

⁴³⁹ Procesverbali, 29 shtator 2017, f. 4-5

⁴⁴⁰ Trupi gjykues rikujtoi se, për shkak të shqetësimit për moshën e shtyrë dhe pamundësinë për të udhëtuar të z. *L.M.* palët u pajtuan që raportin e tij ekspertizë ta konsiderojnë si të lexuar: shih procesverbalin, 7 nëntor 2017, f. 19-20; 4 tetor 2017, f. 10-11

- 250,000 € për ta fituar Tenderin 009-004-511 për rajonin e Gjilanit; (b) duke negociuar me E.Sh. manipulimin e dokumentacionit të ofertës së *Kompania T.t* për tenderin e njëjtë; dhe (c) duke komunikuar privatisht me Endrit Shalën, një zyrtar i MTPT-së, në kohën gjatë vendosjes së ofertës së *Kompania T.-t* me 25 mars 2009 dhe dhënies së kontratës për të cilën *Kompania T.* ishte njoftuar me 31 mars 2009.⁴⁴¹ Të gjitha këto shkelje përbëjnë veprën, sipas prokurorit, e keqpërdorimit të autorizimeve ekonomike që F.Z. i kishte për *Kompania T.n.*
263. Trupi gjykues ka përsëritur të gjeturat e mëhershme, të diskutuara në detaje në Pjesën V.A.iv (titujt ‘*Arritja e marrëveshjes me F.Z.*’ dhe ‘*A kanë folur E.Sh.dhe F.Z. për një marrëveshje në pjesën e dytë të marsit 2009?*’). Veçanërisht, prokurori nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.Z. ka premtuar ryshfet në shumë prej 250,000€ për dhënien e tenderit 009-004-511 për rajonin e Gjilanit, se ka negociuar me E.Sh. ‘rregullimin’ e dokumentacionit për ofertën e *Kompania T.-t* për këtë tender, apo se ka pasur ndonjë komunikim ndërmjet këtyre dyve gjatë kohës relevante (që bazohet tërësisht në kopjen fizike të papranueshme të SMS-vë të pretenduar që janë konfiskuar gjatë bastisjes së shtëpisë së F.L. në XXX).
264. Për këto arsye, trupi gjykues nuk ka qenë i bindur se F.Z. ka keqpërdorur autorizimet ekonomike që i ka pasur për *Kompania T.-n* në mars të vitit 2009 gjatë procedurës së tenderit 009-004-511, Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore për Rrugët Rajonale të Kosovës 2009-2010 për Rajonin e Gjilanit.

E. Mos-deklarimi i kontributeve të pranuarra të fushatës (Pika 6 e aktakuzës)

265. Në Pikën 6 të Aktakuzës së Konsoliduar, prokurori akuzoi të akuzuarin **F.L.** me dy vepra të ndara në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale. E para ishte ajo e pranimit të një kontributi politik më të madh se 1,000 euro nga një burim i vetëm në një ditë të vetme, në kundërshtim me nenin 5.1 në lidhje me nenin 10.8 të Rregullores së UNMIK-ut. Trupi gjykues konstatoi se kjo vepër nuk ishte tërhequr dhe as nuk ishte zëvendësuar me ndonjë vepër tjetër më të butë me Ligjin nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.⁴⁴² Megjithatë, ai konkludoi se parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër ka skaduar në vitin 2013 dhe prandaj e refuzoi këtë akuzë.⁴⁴³
266. Sidoqoftë, Pika 6 e aktakuzës, e ngarkon gjithashtu F.L. për një vepër tjetër sipas Rregullores së UNMIK-ut: të dhënies së deklaratave të rreme ose mos-shpalosjes së informatave në regjistrimin e kandidaturës politike, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në kundërshtim me nenin 5.6 në lidhje me nenin 10.5 (a) të Rregullores së UNMIK-ut.⁴⁴⁴ Trupi gjykues më herët gjeti se kjo vepër nuk ishte

⁴⁴¹ Aktakuza e Konsoliduar, f. 13; p.43, paragrafi 81; f. 46-49, paragrafët 91-103; p. 50, paragrafi 108

⁴⁴² Shih *supra* Pjesën II.A.i (paragrafët 59-61, 63).

⁴⁴³ Shih *supra* Pjesën III.A dhe C (paragrafët 71-74 dhe 78-80).

⁴⁴⁴ Aktakuza e konsoliduar, faqe. 14.

tërhequr dhe as një dispozitë më e butë nuk ishte hyrë në fuqi më pas.⁴⁴⁵ Më tutje, ai konsideroi se kjo akuzë mbeti e paprekur pasi parashkrimi absolut i ndjekjes penale nuk kishte skaduar ende në kohën e dorëzimit të aktgjykimit në këtë rast.⁴⁴⁶ Thënë thjeshtë: ndërsa F.L. nuk mund të ndiqej penalisht për pranimin e një kontributi politik, ai ende mund të ishte përgjegjës për mos-deklarimin e tij tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

267. Prokurori pretendoi se më 18 tetor 2007, I. M. transferoi 5,000 euro në llogarinë private bankare të F.L. në Kosovë si kontribut për fushatën e tij zgjedhore për t'u bërë kryetar i Prishtinës në vitin 2007.⁴⁴⁷ Mos-paraqitja e këtyre 5,000 euro si kontribut politik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në regjistrimin e tij si kandidatë politikë, F.L. ra në kundërshtim me nenet 5.6 dhe 10.5(a) të Rregullores së UNMIK-ut.⁴⁴⁸
268. Trupi gjykues e shqyrtoi dosjen e lëndës për dëshmi relevante për këtë pretendim dhe theksoi si në vijim:
- Një **pasqyrë e llogarisë bankare të Pro-Credit** që i përket F.L.t tregon pranimin e 5,000 eurove nga një kompani gjermane, *B. G.*, më 22 tetor 2007. Arsyeja e transferimit është specifikuar si “*për fushata*”.⁴⁴⁹
 - Një **formë e shtypur e faqes së internetit të B. G.**, e rendit z. I. M. si drejtor menaxhues të kompanisë.⁴⁵⁰
 - ‘**Formulari për Deklarimin e Gjendjes së Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik**’ i F.L.t, i plotësuar për AKK-në si Ministër i MTPT-së dhe i datës 31 mars 2008,⁴⁵¹ përshkruan përbërjen familjare të të akuzuarit; pronën e luajtshme dhe të paluajtshme; aksionet; paratë e gatshme në institucionet financiare (kjo është lënë bosh); detyrimet financiare; të ardhurat vjetore, etj.⁴⁵² Ky formular shënon se “*Zyrtarët e Lartë Publikë janë të detyruar të deklarojnë pasurinë e tyre ekzistuese në Agjenci deri më 31 mars të çdo viti*” në pajtim me nenin 3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.⁴⁵³
269. Në parashtrësat e tij, prokurori gjithashtu u mbështet në një **deklaratë të dëshmitarit z. I. M.**⁴⁵⁴ Trupi gjykues konstatoi se nuk ka mundur të mbështetet në këtë deklaratë të dëshmitarit si dëshmi e drejtpërdrejt në shqyrtim gjyqësor. I.M. është intervistuar pa praninë e të pandehurve ose avokatit mbrojtës dhe, pasi ai nuk

⁴⁴⁵ Shih *supra* Pjesën II.A.i (paragrafët 62, 64).

⁴⁴⁶ Shih *supra* Pjesën III.A dhe C.

⁴⁴⁷ Aktakuza e Konsoliduar, f. 14; f. 79, paragrafët 190-192.

⁴⁴⁸ Aktakuza e Konsoliduar, f. 14; f. 79, paragrafët 190-192.

⁴⁴⁹ Regjistratori 6, faqe 118-119.

⁴⁵⁰ Regjistratori 6, f. 117.

⁴⁵¹ Regjistratori 21B, f. 245.

⁴⁵² Regjistratori 21B, f 247-255.

⁴⁵³ Regjistratori 21B, f. 247.

⁴⁵⁴ Aktakuza e Konsoliduar, f. 79, paragrafi 190, që citon deklaratën e dëshmitarit I. M., të datës 29 maj 2012. regjistratori 14B, f 174-179.

është thirr nga prokurori për të dhënë dëshmi *viva voce*, mbrojtjes nuk iu dha asnjë mundësi më vonë për ta testuar dëshminë e tij. Në përputhje me diskutimet e mëhershme të trupit gjykues për këtë pikë,⁴⁵⁵ është e pamundur të kualifikohet deklarata e I.M. si ekuivalente me ‘dëshminë në procedurë paraprake’ sipas dispozitave të reja të KPP-së; por ajo duhet të konsiderohet si një ‘intervistë në procedurë paraprake’, përdorimi i të cilave është i kufizuar në marrjen në pyetje të tërthortë të dëshmitarit.

270. Trupi gjykues pranoi që I.M. nëpërmjet kompanisë së tij B. G. i dhuroi 5,000 euro për F.L. për fushatën e tij politike në tetor 2007. Kjo është evidente edhe në pasqyrën e llogarisë bankare të bankës Pro-Credit që vërteton marrjen e këtyre parave, si dhe formën e shtypur të faqes së internetit të kësaj kompanie, që e tregon I.M. si Drejtor të saj Menaxhues.
271. Megjithatë, prokurori nuk e ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L. nuk e ka zbuluar këtë kontribut politik në regjistrimin e kandidaturës së tij të paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Regjistrimi i kandidaturës së F.L. e paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk ishte pjesë e dosjes së lëndës. Formulari i AKK-së të F.L., në të cilin është mbështetur prokurori për të vërtetuar këtë dështim për të deklaruar, nuk kërkoi që ai të deklaronte kontributet e fushatës politike siç detyrohet nga Rregullorja e UNMIK-ut. Përkundrazi, ai kërkoi që ai të deklaronte pasuritë dhe detyrimet e tij në pajtim me Ligjin mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave. Trupi gjykues nuk e pranoi se një kontribut i fushatës politike do të ishte paraqitur në formën e AKK-së dhe kështu të vërtetohet elementi material i kësaj vepre penale.
272. Për më tepër, trupi gjykues rikujtoi se elementi mendor i kësaj vepre kërkon që mosveprimi të bëhet ‘me dashje’. Veprimi me dashje është kuptuar nga trupi gjykues që të jetë një veprim i kryer jo vetëm me dashje, por edhe me qëllim, dhe i cili nuk është kryer pa dashje, nga moskujdesi ose aksidenkompania T.sht.⁴⁵⁶ Prokurori nuk solli dëshmi për gjendjen mendore të F.L. në deklarin e tij, që mund ta vërtetonte dashjen e tillë, dhe nuk kishte prova të tjera që mund t’ia bënin të mundur trupit gjykues të konkludonte këtë.
273. Për këto arsye, trupi gjykues konstatoi se prokurori nuk arriti të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se F.L. ka kryer veprën penale të mosveprimit të zbulimit së informatave materiale në regjistrimin e tij si kandidat, të paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kundërshtim me nenin 5.6 në lidhje me neni 10.5 (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale, duke mos shpalosur një kontribut të fushatës në shumën prej 5,000 euro të pranuar nga I. M. në vitin 2007.

⁴⁵⁵ Shih *supra* Pjesën IV.B.i lidhur me deklaratën e M. Sh. në Polici të EULEX-it.

⁴⁵⁶ Shih Pjesën III.A.i (paragrafët 59-64).

VI. PROPOZIMET E REFUZUARA TË PALËVE

274. Trupi Gjykses e refuzoi propozimin e avokatëve mbrojtës se Aktakuza e Konsoliduar është e vonuar pasi është aktakuzë e re dhe jo e ndryshuar. Trupi Gjykses vendosi që aktakuza e konsoliduar nuk është një aktakuzë e re pasi nuk ka akuzë të reja ose pika të reja të aktakuzës dhe, më tej, prokurori ishte i obliguar t'i paraqesë Gjykatës dhe Mbrojtjes një Aktakuzë të Konsoliduar sipas Vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 23 dhjetor 2014. Prandaj aktakuza e konsoliduar e datës 28 shtator 2015 është aktakuza efektive në këtë rast⁴⁵⁷.
275. Një numër i propozime nga mbrojtja janë parashtruar lidhur me zbulimin e materialit nga prokuroria. F.L. dhe mbrojtësi i tij Tahir Rrecaj, në propozimin e datës 3 nëntor 2015, kërkuan që prokuroria të sigurojë transkriptet e bisedave telefonike të përgjuara. Dy gjëra u kërkuan në propozimin e datës 5 nëntor 2015 të parashtruar nga E.Sh.dhe avokati i tij mbrojtës Arianit Koci: komunikimet e dyshuara tekstuale të sekuestruara gjatë kontrollit të shtëpisë të F.L. më 28 prill 2008 dhe një letër e dërguar Policisë së Kosovës dhe Policisë së EULEX-it. Bajram Tmava, në emër të N.K. paraqiti propozimin e datës 5 nëntor 2015 në të cilin nuk bëri asnjë kërkesë për zbulimin e materialit specifik, por i rezervoi të drejtat e tij në pajtim me nenin 348 të KPP-së lidhur me plotësimin e procedurës së provave. Trupi gjykses vendosi se prokuroria kishte zbuluar të gjitha dokumentet në posedim të saj për avokatët mbrojtës të secilit të pandehur⁴⁵⁸.
276. Në përgjigje të propozimit të paraqitur nga avokati mbrojtës, trupi gjykses vendosi se nuk ka asnjë detyrim të vendosur me nenin 244 dhe 213 të KPP-së, ose me praktikë, që prokuroria të zbulojë materialin në formë fizike. Neni 244 dhe 213 vetëm përcaktojnë një kopje të materialit dhe jo se duhet të jetë një kopje fizike (në letër). Prandaj, duke hedhur poshtë propozimin, trupi gjykses arriti në përfundim se prokuroria kishte përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin e dhënies së informacionit duke ofruar materialin në CD⁴⁵⁹.
277. Për më tepër, në përgjigje të kërkesës së paraqitur nga Bajram Tmava, trupi gjykses gjeti se kërkesa ishte e paqartë, kështu që nuk mund të dalloheshin saktësisht se cilat prova ai kishte planifikuar të paraqiste dhe dëshmitarët që dëshironte t'i ftonte për të dhënë dëshmi. Trupi gjykses e refuzoi kërkesën dhe këshilloi që ajo të ri-dorëzohet me më shumë detaje.⁴⁶⁰
278. Trupi gjykses gjithashtu refuzoi propozimin e paraqitur nga avokati mbrojtës Karim A. Khan lidhur me pranueshmërinë e deklaratës së .M.Sh.. Trupi gjykses deklaroi se do të ndjekë vendimin e marrë nga Gjykata e Apelit më 10 dhjetor 2013 se deklarata e M.Sh. është e papranueshme⁴⁶¹. Çështja u ngrit sërish më 15 shkurt 2017, kur trupi gjykses përsëriti se prova të caktuara janë shpallur të papranueshme

⁴⁵⁷ Procesverbali, 30 tetor 2015, fq. 19.

⁴⁵⁸ Procesverbali, 3 dhjetor 2015, f. 5.

⁴⁵⁹ Procesverbali, 16 dhjetor 2015, f. 9.

⁴⁶⁰ Procesverbali, 16 dhjetor 2015, f. 12.

⁴⁶¹ Procesverbali, 13 shtator 2016, f. 13.

me vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Aktakuza e Konsoliduar është në përputhje me vendimet e Gjykatës së Apelit lidhur me Pjesën E. Prandaj, trupi gjykues e ndaloi prokurorinë nga paraqitja ose referimin në ndonjë nga ato prova të papranueshme. Në përgjigje të propozimit të E.Sh., trupi gjykues theksoi se prokurori nuk ka nevojë të ndryshojë asgjë në Aktakuzën e Konsoliduar ngase është trupi gjykues ai që do të vlerësojë nëse faktet janë vërtetuar apo jo. Aktakuza është një dokument i prokurorisë, thelbi i së cilës është që prokuroria të vërtetojë një dyshim; është e qartë për të gjitha palët se cilat prova pranohen dhe cilat prova nuk pranohen; prandaj nuk ka nevojë që Prokurori të ndryshojë formulimin në aktakuzë lidhur me ‘komunikimet’.⁴⁶²

279. Mbrojtja parashtrori një propozim lidhur me Urdhrat e 6 shkurtit 2008 dhe 9 prill 2008 që autorizonin masa të fshehta. Kjo u refuzua pasi Gjykata e Apelit ka vendosur tashmë këtë çështje në aktvendimin e saj të 23 dhjetorit 2014⁴⁶³.
280. Trupi gjykues e hodhi poshtë propozimin e avokatit mbrojtës Blerim Prestreshi në emër të F. Z., i cili theksoi se afati i parashkrimi ishte arritur për Pikën 4 të aktakuzës. Trupi gjykues vendosi që kjo të jetë pjesë e Aktgjykimit dhe e njëjta është adresuar në tërësi në Pjesën III.A dhe B të këtij Aktgjykimi. Propozimi ngriti gjithashtu çështjet e pranueshmërisë së provave dhe akuzave; Trupi gjykues vendosi që aktakuza duhet të lexohet dhe deklarimet e të pandehurve të merren pa vonesë⁴⁶⁴.
281. Tahir Rrecaj vuri në pyetje bazën ligjore për përbërjen e trupi gjykues me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it në vend të Trupit gjykues me shumicë të gjyqtarëve vendorë. Trupi gjykues konfirmoi se gjyqtarët e EULEX-it ishin caktuar në këtë çështje para 15 prillit 2014 dhe prandaj ishte një ‘rast në vazhdim’ në kuptim të nenit 1A të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve në lidhje me Mandatin Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit, i cili hyri në fuqi më 30 maj 2014. Prandaj, trupi gjykues ishte përbërë me rregull në përputhje me ligjin⁴⁶⁵.
282. Më 13 shtator 2016, prokurori propozoi që Florent Latifaj të lirohet si mbrojtësi i N. K.t për shkak të konfliktit të interesit. Prokurori theksoi se ishte e dukshme që nga fillimi i rastit që prokuroria kishte për qëllim ta ftonte A.G. si dëshmitar. A.G. përfaqësohet nga z. Latifaj në çështje të tjera dhe z. Latifaj nuk mund të përfaqësojë edhe të pandehurin dhe dëshmitarin e prokurorisë pa ekzistuar një konflikt interesi. Prokurori vuri në dukje se ndërsa KPP nuk e mbulon këtë gjendje specifike, neni 5 (2) dhe neni 19 (1) (1.15) KPP janë relevante. Kryetari i trupit gjykues vuri në dukje se trupi gjykues kishte mësuar se z. Latifaj është këshilltar ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, pala e dëmtuar në këtë rast dhe prandaj duhet të konsiderohet përjashtimi; sipas nenit 56 (1) KPP mbrojtësi nuk mund të jetë gjithashtu një palë e dëmtuar. Z. Latifaj e kundërshtoi propozimin e prokurorit,

⁴⁶² Procesverbali, 15 shkurt 2017, f. 22-23.

⁴⁶³ Procesverbali, 18 korrik 2017, f. 2-5.

⁴⁶⁴ Procesverbali, 3 dhjetor 2015, f. 11.

⁴⁶⁵ Procesverbali, 26 nëntor 2015, f. 7.

duke theksuar se neni 56 qartazi dhe kategorikisht përcakton shkaqet në dispozicion për shkarkimin e avokatit mbrojtës dhe nuk përfshin këto rrethana. Ai më tej argumentoi se MTPT është palë e dëmtuar dhe jo Ministria e Drejtësisë. Megjithatë, z. Latifaj hoqi dorë nga ky angazhim dhe me kërkesë të trupit gjykues i ofroi dëshmi me shkrim gjykatës⁴⁶⁶ dhe një letër nga Ministria e Drejtësisë si konfirmim⁴⁶⁷. Sa i përket propozimit të prokurorit, trupi gjykues konstatoi se nuk kishte arsye për të përjashtuar z. Latifaj si mbrojtës. Trupi gjykues konsideron se gjendja e F.L. nuk përfshihet në ato që parashihen me nenin 56 të KPP-së. Trupi gjykues nuk ishte në gjendje të gjejë një situatë analoge në jurisprudencën e GJEDNJ dhe në komentet e përgjithshme të Komitetit të Drejtave të Njeriut të OKB-së, nën QNDKP. Propozimi i Prokurorit u refuzua⁴⁶⁸.

283. Më 16 shtator 2016, avokati mbrojtës Karim A. Khan i propozoi trupit gjykues në pajtim me nenin 39 (3) dhe 41 (2) të KPP-së. Ai argumentoi se meqë gjyqtarja Marie Tuma ishte anëtare e ekipit të prokurorisë në TPNJ dhe kishte vepruar si prokurore në disa raste lidhur me UÇK-në, kjo përbënte fakte dhe rrethana që zgjonin dyshime për paanshmërinë e trupit gjykues ose krijuan një paraqitje të sjelljes së pahijshme⁴⁶⁹. Z. Khan më pas e paraqiti të njëjtën gjë me shkrim dhe më 22 shtator 2016 çështja iu drejtua Kryetarit të Gjykatës Themelore në pajtim me nenin 42 (1) (1.1) të KPP-së. Kryetari i Gjykatës Themelore mori një aktvendim në përgjigje, duke kërkuar që trupi gjykues të këshillohet për përjashtimin e saj. Trupi gjykues e shqyrtoi çështjen më 5 tetor 2016 dhe vendosi me shumicë votash për të hedhur poshtë kërkesën në tërësi, në pajtim me nenin 42 (4) të KPP-së. Kërkesa u paraqit pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor më 30 tetor 2015 dhe prandaj u zbatua neni 41 (2) i KPP-së⁴⁷⁰.
284. Avokati mbrojtës Karim A. Khan i propozoi trupit gjykues që të fshijë nga lista dëshmitarët e prokurorisë, M. K. dhe E.K., duke pohuar se prokuroria nuk ka të drejtë ta përdorë shqyrtimin për të gjetur prova kur nuk ka pasur asnjë përpjekje nga asnjë hetues për të marrë deklaratat e tyre dhe më tej, pa ditur përmbajtjen e dëshmimeve të tyre, të zë mbrojtjen në pritë. Në përgjigjen e tij, prokurori deklaroi se me sa ai dinte nuk kishte asgjë në të dhënat e tij lidhur me këta dy dëshmitarë, por pohoi se ai do të kontrollonte dosjet e lëndëve dhe do t'i jepte një përgjigje të qëndrueshme mbrojtjes para se ata të thirren dhe se çdo material i zbuluar në lidhje me ta do t'i zbulohet trupit gjykues dhe mbrojtjes. Trupi gjykues vendosi se dëshmitarëve t'i lejohej të japin dëshmitë e tyre. M. K. është në listën e dëshmitarëve në aktakuzë. E.K. nuk është në listë. Megjithatë, trupi gjykues e miratoi marrjen në pyetje të dëshmitarëve në përputhje me nenet 329 dhe 348 të KPP-së, dhe më tej theksoi se nëse mbrojtjes i nevojitej më shumë kohë pas

⁴⁶⁶ Procesverbali, 14 shtator 2016, f.2.

⁴⁶⁷ Procesverbali, 15 shtator 2016, f.11.

⁴⁶⁸ Procesverbali, 5 tetor 2016, f.6.

⁴⁶⁹ Procesverbali, 16 shtator 2016, f.5.

⁴⁷⁰ Procesverbali, 5 tetor 2016, f.3.

- marrjes së tyre në pyetje për parashtrimin e pyetjeve të drejtpërdrejta, atëherë kjo do të aprovohej.⁴⁷¹
285. Avokati mbrojtës i F.L.t paraqiti një kërkesë me shkrim të datës 13 prill 2017. Kërkesa i referohet autorizimit nga korriku 2012 dhe raportit të ekspertit i cili është dashur të paraqitet si rezultat i saj dhe se procedura duhet të pezullohet derisa raporti i ekspertit t'i paraqitet mbrojtjes, përveç zbulimit të të gjitha provave dhe informatave tjera në posedim të prokurorisë. Avokati mbrojtës gjithashtu dha propozim për një hetim të pavarur. Prokuroria u përgjigj se raporti ishte gjetur dhe kishte dy shtojca dhe se dokumenti i ishte dorëzuar në mbrojtjes sa më parë që kishte qenë e mundur. Trupi gjykues ishte i kënaqur me shpjegimin e dhënë nga prokurori dhe nuk gjeti asnjë arsye për ta qortuar atë ose për të pezulluar procedurën. Më tej, në zbatimin e nenit 176 dhe 183 të KPPP-së, dokumenti nuk mund të shikohet si një raport i ekspertit pasi nuk i plotëson kërkesat formale. Prandaj kjo kërkesë është refuzuar.⁴⁷²
286. Më 26 shtator 2017, prokurori i propozoi gjykatës që të ftojë L. M., D. H. dhe A. Z. për të dhënë dëshmi. Prokurori deklaroi se propozimi i tij ishte i bazuar në dëshmitë e dhëna nga Y.Sh., pasi ai kishte dëshmuar se stafi i tij teknik ishte drejtpërdrejt përgjegjës për caktimin e çmimit e të gjitha sendeve të linjës për rajonin e Gjilanit në përpilimin e ofertës së tij të tenderit. Të gjithë mbrojtësit e kundërshtuan propozimin. Trupi gjykues e hodhi poshtë propozimin, duke deklaruar se shqyrtimi gjyqësor nuk është një hetim. Informacioni në lidhje me këta persona është dashur të jetë në dispozicion të prokurorisë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, i cili duhet të kishte proceduar në mënyrë të duhur.⁴⁷³
287. Më 9 nëntor 2017, trupi gjykues refuzoi një numër propozimesh për dëshmitarë shtesë. Trupi gjykues e refuzoi propozimin e prokurorit për të dëgjuar H. E. si dëshmitar, pasi dëshmia e tij nuk mund të sigurohej në një të ardhme të afërt dhe rëndësia e saj ishte e paqartë, në pajtim me nenin 258 (2.1), (2.2) dhe (2.4) të KPP-së. Trupi gjykues gjithashtu e refuzoi propozimin në emër të të pandehurve E.SH. dhe F.Z. të paraqitur më 7 nëntor 2017 për të dëgjuar dëshminë e një eksperti të forenzikës së TI-s nga Portugalia duke iu referuar të njëjtit nen. Propozimi i mbrojtësit Florent Latifaj në emër të N. K.t për të dëgjuar dëshminë e një eksperti vendor lidhur me interpretimin e Ligjit mbi Prokurimin, u refuzua duke iu referuar të njëjtit nen si dhe nenit 329 të KPP-së. Trupi gjykues theksoi se është gjykata ajo që e njuh dhe e interpreton ligjin. Propozimet e Blerim Prestreshit dhe Hekuran Haxhimusës për dëshmitë e ekspertëve nga fusha e inxhinierisë civile në lidhje me cilësinë e asfaltit dhe aspekte të tjera të mirëmbajtjes së rrugëve u refuzuan gjithashtu në pajtim me nenet 258 dhe 329, veçanërisht sepse provat plotësuese u konsideruan të panevojshme.⁴⁷⁴

⁴⁷¹ Procesverbali, 26 tetor 2016, f.12.

⁴⁷² Procesverbali, 11 maj 2017, f.11.

⁴⁷³ Procesverbali, 26 shtator 2017, f.23.

⁴⁷⁴ Procesverbali, 9 nëntor 2017, faqe 2-4.

288. Avokati mbrojtës në emër të E.SH. i paraqiti gjykatës një raport të ekspertizës mjeko-ligjore të përpiluar nga F. M. D. R. N. që synon të analizojë kopjen e shtypur në letër të SMS-ve të dyshuara që janë gjetur gjatë kontrollit të shtëpisë së F.L.t më 28 prill 2010. Mbrojtësit e E.SH. dhe F.Z. propozuan që ky raport të pranohej si provë, gjë që u kundërshtua nga prokuroria për një numër arsyesh dhe veçanërisht mbi vonesën e paraqitjes. Trupi gjykues e refuzoi kërkesën. Trupi gjykues e përjashtoi si të papranueshme kopjen e shtypur në letër të SMS-ve të sekuestruara gjatë kontrollit të shtëpisë së F.L. në XXX me arsyen se ato në thelb ishin jo të besueshme (shih *supra* Pjesën IV.C). Rrjedhimisht, trupi gjykues gjithashtu konstatoi se raporti i ekspertit i paraqitur nga E.SH. dhe F.Z. ishte gjithashtu i papranueshëm. Neni 258 (2.2) i KPP-së parasheh që gjykata mund të parandalojë marrjen e provave nëse fakti që vërtetohet është i parëndësishëm për vendimin ose tashmë është vërtetuar. Raporti i ekspertit ofron një analizë të kopjes së shtypur në letër të SMS-ve. Pasi që Trupi gjykues vendosi që kjo është e papranueshme, raporti i ekspertëve nuk ishte më i rëndësishëm për të vërtetuar ndonjë aspekt të këtij rasti.⁴⁷⁵
289. F.L. propozoi që M. S. të thirret si dëshmitar si rezultat i komenteve të tija të botuara në gazetën *Le Monde*. Prokurori kërkoi shtyrjen e vendimit e të trupit gjykues për këtë propozim, e cila u refuzua sipas nenit 258 (2.2).⁴⁷⁶

VII. DISPOZITIVI

290. Për arsyet e paraqitura në Pjesën 1 deri VI më lartë, trupi gjykues unanimisht vendosi si në vijim:
1. Të akuzuarit F.L., E.SH., N.K.dhe SH.T. **LIROHEN** nga Pika 1 e aktakuzës (Krimi i Organizuar në kundërshtim me nenin 274(3) të KPPK-së, siç lexohet me nenin 274(1) të KPPK-së dhe e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri 20 vjet; lexuar në lidhje me nenin 23 të KPPK-së (bashkëkryerje) siç përshkruhet në Aktakuzën e Konsoliduar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015) në pajtim me nenin 364(1)(1.1) të KPP-së, sepse veprat me të cilat ata akuzohen nuk përbëjnë veprën penale të Krimit të Organizuar.

⁴⁷⁵ Procesverbali, 16 nëntor 2017, faqe 6.

⁴⁷⁶ Procesverbali, 16 nëntor 2017, faqe 9.

2. Të akuzuarit F.L., E.SH., N.K.dhe SH.T. **LIROHEN** nga Pika 2 e aktakuzës (Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit në kundërshtim me nenin 339(1) dhe (3) të KPPK-së; e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vjet dhe e lexuar në lidhje me nenin 23 të KPPK-së (bashkëkryerje), për F.L. dhe N.K.dhe e lexuar në lidhje me nenin 25 të KPPK-së (ndihma) për E.SH. dhe SH.T. siç përshkruhet në Aktakuzën e Konsoliduar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015) në pajtim me nenin 364(1)(1.3) të KPP-së, sepse nuk është provuar se ata i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar;

3. Të akuzuarit F.L., E.SH. dhe N.K.**LIROHEN** nga Pika 3 e aktakuzës (Marrja e Ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343(1) të KPPK-së dhe e dënueshme me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet; lexuar në lidhje me nenin 23 të KPPK-së (bashkëkryerje) siç përshkruhet në Aktakuzën e Konsoliduar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015) në pajtim me nenin 364(1)(1.3) të KPP-së, sepse nuk është provuar se ata kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar;

4. Pika 4 e aktakuzës kundër të akuzuarit F.Z. (për Dhënia e Ryshfetit në kundërshtim me nenin 344(1) të KPPK-së dhe e dënueshme me burgim prej tre muaj deri në tre vjet siç përshkruhet në Aktakuzën e Konsoliduar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015) **REFUZOHET** në pajtim me nenin 363(1)(1.3) të KPP-së, sepse ka kaluar afati i parashkrimit.

5. I akuzuari F.Z. **LIROHET** nga Pika 5 e aktakuzës (Keqpërdorimi i Autorizimeve në Ekonomi në kundërshtim me nenin 236(1)(5) dhe 236(2) të KPPK-së, e dënueshme me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet siç përshkruhet në Aktakuzën e Konsoliduar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015) në pajtim me nenin 364(1)(1.3) të KPP-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

6. I akuzuari F.L. **LIROHET** nga Pika 6 e aktakuzës (mos zbulimi i qëllimshëm i informacionit material në deklaratë në kundërshtim me nenet 5.6 dhe 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/02 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale, siç është ndryshuar, siç përshkruhet në Aktakuzën e Konsoliduar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015) në pajtim me nenin 363(1)(1.3) të KPP-së, sepse nuk është provuar se ai ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

dhe Pika 6 e aktakuzës (kundër F.L. për pranimin e një kontributi politik që tejkalon shumën prej 1.000 euro nga një burim i vetëm në një ditë të vetme në kundërshtim me nenet 5.1 dhe 10.8 të Rregullores së UNMIK-ut siç përshkruhet në Aktakuzën e Konsoliduar PPS nr.425/09 e datës 28 shtator 2015) **REFUZOHET** në pajtim me nenin 363(1)(1.3) të KPP-së, sepse ka kaluar afati i parashkrimit.

7. Palët e dëmtuara udhëzohen që ato mund të parashtrojnë kërkesën e tyre pasurore-juridike në proces gjyqësor civil; ne pajtim me nenin 463 të KPP-së;
8. Shpenzimet e procedurës do të paguhen nga burimet buxhetore ne pajtim me nenin 450 dhe 454 të KPP-së;

Kryetarja e trupit gjykues

Marie Tuma

Procesmbajtëse

Alexandra Popova

Mjeti juridik: Në pajtim me nenin 380 të KPP-së, kundër këtij Aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë brenda 15 ditëve nga dita kur kopja e Aktgjykimit iu është dorëzuar palëve. Ankesa duhet t'i adresohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore në Prishtinë.